

RAPORTI VJETOR I GJENDJES SË MJEDISIT 2024



Tetor 2025
Prishtinë

Raporti vjetor për gjendjen e mjedisit

2024



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

AGJENCIONI PËR MBROJTJEN E MJEDISIT TË KOSOVËS
KOSOVSKA AGENCIJA ZA ZAŠTITU SREDINE
KOSOVO ENVIRONMENTAL PROTECTION AGENCY



Raporti vjetor për gjendjen e mjedisit 2024

Prishtinë,
Tetor, 2025

Përmbajtja

1. Hyrje

2. Përmbledhje e të gjeturave kryesore të raportit

3. Gjendja e mjedisit dhe trendi

3.1. Ajri

3.1.1. Cilësia e ajrit

3.1.2. Emisionet në ajër

3.1.3. Emisionet e gazrave serrë (GHG)

3.2. Uji

3.2.1. Cilësia e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore

3.2.2. Sasia e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore (reshjet)

3.2.3. Trajtimi i ujërave të ndotura

3.3. Toka/dheu

3.3.1. Përdorimi i tokës në bujqësi

3.3.2. Monitorimi i tokës

3.3.3. Ndotja e tokës

3.4. Menaxhimi i mbeturinave

3.4.1. Gjenerimi i mbeturinave komunale

3.4.2. Analiza e përbërjes së mbeturinave komunale

3.4.3. Deponimi i mbeturinave komunale në deponi sanitare

3.4.4. Trajtimi i mbeturinave

3.4.5. Deponitë ilegale

3.4.6. Mbeturinat spitalore

3.4.7. Mbeturinat industriale

3.4.7. Importi dhe eksporti i thasëve dhe qeseve të plastikës dhe mbetjeve

3.5. Mbrojtja e natyrës dhe biodiversitetit

3.5.1. Zonat e mbrojtura

3.5.2. Biodiversiteti

4. Ndikimet mjedisore në shëndetin e popullatës

4.1. Shëndeti publik – sëmundjet ambientale

4.2. Cilësia e ujit të pijes

4.3. Ndikimi i cilësisë së ajrit në shëndet

5. Gjendja e mjedisëve të rrezikuara

5.1. Gjendja mjedisore në zonën e veprimit të KEK-ut

5.2. Gjendja mjedisore në zonën e veprimit të Feronikelit

5.3. Gjendja mjedisore në zonën e veprimit të Sharrcem

5.4. Zonat tjera të rrezikuara (Hot Spotet) mjedisore

6. Zbatimi i strategjisë, planit të veprimit dhe planeve sanuese për mjedis

- 6.1. Zbatimi i strategjive mjedisore
- 6.2. Zbatimi i planeve të veprimit
- 6.3. Zbatimi i planeve lokale për mjedis

7. Masat e ndërmarra për mbrojtjen e mjedisit, sukseset nga masat e ndërmarra dhe efektin e tyre në zhvillimin ekonomik

- 7.1. Hartimi i legjislacionit mjedisor shtetëror
- 7.2. Inspektimi dhe kontrolli i zbatimit të ligjit
- 7.3. Lejedhënia

8. Mënyra e menaxhimit të resurseve natyrore dhe mbrojtja e mjedisit

- 8.1. Shfrytëzimi i resurseve ujore
- 8.2. Shfrytëzimi i resurseve pyjore
- 8.3. Shfrytëzimi i resurseve minerare

9. Analiza për funksionimin e institucioneve, autoriteteve dhe subjekteve të tjera për mbrojtjen e mjedisit

- 9.1. Rregullore (ZKM) nr. 08/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës - riorganizimi
- 9.2. Drafti i Rregullores për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës
- 9.3. Bashkëpunimi me Agjencinë e Mjedisit të Europës / EIONET
- 9.4. Zyrtarët për mjedis dhe inspektorët mjedisor në nivel lokal

10. Financimi i sistemit për mbrojtjen e mjedisit

- 10.1. Financimi i mjedisit me projekte kapitale në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
- 10.2. Financimi i mjedisit me projekte kapitale në nivel lokal
- 10.3. Financimi i mjedisit me projekte nga donatorët

11. Rekomandimet

12. Referencat

13. Shtojcat

Lista e shkrutesave

ATO	Azoti total organik
AT	Alkaliteti total
ATI	Azoti total inorganik
Ar	Aroma
AKS1	Aglomeracioni i Kosovës 1
AMMK	Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës
APK	Agjencia e Pyjeve të Kosovës
ARRU	Autoriteti Rregullativ i Shërbimeve të Ujit
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BAT	Best Available Techniques
BPV	Bruto Produkti Vendor
BE	Bashkimi European
Cu ²⁺	Bakri
Cd ²⁺	Kadmiumi
Cr ³⁺	Kromi
C ₆ H ₅ OH	Fenolet
Cl ⁻	Kloruret
Cl ₂	Klori i lirë
Ca ⁺	Jonet e Kalciumit
CNVP	Organizata e Lidhjes së Vlerave Natyrore dhe Individuale
CLC	Corine Land Cover
CO	Monoksidi Karbonit
CO ₂	Dioksidi i karbonit
DET	Detergjentet
DG	Doganat e Kosovës
EIONET	Rrjeti European për Monitorim dhe Vëzhgim
EEA	Agjencia e Mjedisit të Europës
FMg	Fortësia e Magnezit
Fca	Fortësia e Kalciumit
Fp	Fortësia e përgjithshme
Fe ²⁺	Hekuri
GIZ	Bashkëpunimi Teknik Gjerman
GHG	Gazrat serrë
H	Niveli
HCO ₃ ⁻	Bikarbonatet
IKMN	Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës

IPA	Instrumenti i Para anëtarësimit i BE-së
IKSHPK	Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik të Kosovës
IHMK	Instituti Hidrometeorologjikë i Kosovës
IPPC	Kontrolli i Integruar dhe Parandalimi i Ndotjes
IPCC	Paneli Ndërqeveritar për Ndryshime Klimatike
IWRM-K	Menaxhimi i Integruar i Resurseve Ujore në Kosovë
ITUN	Impianti i trajtimit të ujërave të ndotur
JICA	Agjencia Ndërkombëtare Japoneze për Zhvillim
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
KMDK	Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë
KRM	Kompania Regjionale e Mbeturinave
KRU	Kompania e Ujësellsve Rajonal
KEDS	Kompania Kosovare për Distributum të Energjisë Elektrike
KESCO	Kompania Kosovare për Energji Elektrike
MPBZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MMPHI	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
MNRV	Monument i Natyrës me Rëndësi të Veçantë
MSH	Ministria e Shëndetësisë
ME	Ministria e Ekonomisë
Mg+	Jonet e Magnezit
M.tert.	Materiet e tretshme në ujë
Ni ²⁺	Nikeli
Mn ²⁺	Mangani
NO ₂	Dioksidi i azotit
N-NO ₃ -	Azoti i Nitrateve
NO ₃ -	Joni nitratet
N-NH ₄ ⁺	Azoti i amoniumit të pajonizuar
NO ₂ -	Azoti i nitriteve
NgO	Ngopshmëria me oksigjen
OECD	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
O ₃	Ozoni
PM ₁₀	Grimca të ajrit me diametër prej 10 mikron ose më pak

PM2.5	Grimca të ajrit me diametër 2,5 mikron ose më pak
PZHR	Programi i Zhvillimit Rajonal
PCB	Bifenilet e Polikrouara
pH	Përqëndrimi i jonit hidrogjen
PO43-	Ortofosfatet
P - PO43-	Fosfori i ortofosfateve
Ptot.	Fosfori total (poli+orto)
Pb2+	Plumbi
PK	Park Kombëtar
SHKO-Cr	Shpenzimi kimik i oksigjenit me dikromat
SHBO7	Shpenzimi biokimik i oksigjenit
SO42-	Joni sulfat
SiO32-	Silikatet
Si - SiO32-	Silici në Silikate
SIDA	Agjencia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar
SOx	Oksidet e Sulfurit
TCA	Termocentrali A
TCB	Termocentrali B
TSS	Grimcat e ngurta të suspenduara
UNICEF	Fondi i Emergjencës i Kombeve të Bashkuara për Fëmijet
VNM	Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis
VSM	Vlerësimi Strategjik Mjedisor
X	Përçueshmëria elektrike
ZKM	Zyra e Kryeministrit
ZKS1	Zonë Monitoruese Kosova 1
Zn2+	Zinku
ZMN	Zonat e Mbrojtura të Natyrës

Lista e Hartave

- Harta. 1:** Lokacionet e stacioneve monitoruese të cilësisë së ajrit
Harta 2: Rrjeti i ujërave sipërfaqësore në Kosovë
Harta 3: Deponitë regjionale, komunale dhe stacionet e transferit

Lista e tabelave

- Tabela.1:** Indeksi i Cilësisë së ajrit
Tabela 2: Të dhënat për cilësinë e ajrit sipas parametrave dhe stacioneve monitoruese në zonën aglomerate për vitin 2024
Tabela 3: Të dhënat për cilësinë e ajrit sipas parametrave dhe stacioneve monitoruese ZKS1 për vitin 2024
Tabela 4: Emisionet në ajër nga ndotësit kryesor sipas burimeve të emetimeve (ton/vit)
Tabela 5. Emetimet e përgjithshme të gazrave serrë në Kosovë, sipas sektorëve- 2023
Tabela 6. Kategoritë kyçe të emetimeve për vitin 2021 sipas IPCC
Tabela 7. Emetimet sipas gazrave 2023
Tabela 8. Lista e substancave organike proiritare
Tabela 9. Vlerat mesatare vjetore të nivelit H (cm) sipas stacioneve matëse 2023-2024
Tabela 10: Vlerat mesatare vjetore të prurjeve Q (m³/sec) sipas stacioneve matëse 2023-2024
Tabela 11: Vlera mesatare vjetore (m) sipas stacioneve matëse të ujërave nëntokësor për vitin 2024
Tabela 12: Sistemi i monitorimit të lumenjve me anë të sistemit të kamerave
Tabela 13. Sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore 2023- 2024 (ha)
Tabela 14. Përdorimi i plehut mineral sipas grupit të kulturave bujqësore për vitet (2023-2024)
Tabela 15. Përdorimi i plehut organik sipas grupit të kulturave bujqësore për vitin (2023-2024)

- Tabela 16.** Përdorimi i pesticideve në sipërfaqen e shfrytëzuar të tokës bujqësore 2020-2024
- Tabela 17.** Gjenerimi i mbeturinave komunale kg\banor\vit (2023 & 2024)
- Tabela 18.** Përbërja e mbeturinave
- Tabela 19.** Numri i deponive të krijuara në Kosovë gjatë vitit 2024 – sipas raportimeve të komunave
- Tabela 20:** Sasia e mbeturinave spitalore të sterilizuara në 8 qendrat spitalore rajonale
- Tabela 21.** Prodhimi i qeseve plastike nga disa kompani vendore kryesore
- Tabela 22.** Numri dhe sipërfaqja e zonave të mbrojtura 2024
- Tabela 23.** Sëmundjet e shfaqura gjatë vitit 2023-2024
- Tabela 24.** Norma (%) e pajtueshmërisë së testeve bakteriologjike dhe fiziko-kimike me standardet vendore të cilësisë së ujit KRU-ve, 2024
- Tabela 25.** Normat referente nacionale, të BE dhe të OBSH për cilësinë e ajrit
- Tabela 26.** Ndërlidhja e vdekjeve të parakohshme me nivelin e koncentrimin të ndotjes së ajrit
- Tabela 27.** Treguesit kryesor të operimit të KEK-ut, gjatë vitit 2024
- Tabela 28.** Mbeturinat metalike, Aku bateri, vajra, yndyrë, gjatë vitit 2024
- Tabela 29.** Emisionet vjetore në ajër për ndotësit SO₂, NO_x dhe pluhurin total nga `TCA` dhe `TCB` 2023-2024
- Tabela 30.** Ndryshimet e Indikatoreve matës për vitet 2023-2024
- Tabela 31.** Gjenerimi i mbeturinave sipas kategorive nga Sharcem për vitin 2024
- Tabela 32:** Niveli i zbatimit të strategjive dhe planeve të veprimit për sektorin e mjedisit për vitin 2024
- Tabela 33:** Planet mjedisore në nivel lokal 2024
- Tabela 34:** Kuvendi i Kosovës i ka nxjerrë pesë ligje
- Tabela 35:** Udhëzimet administrative të nxjerra nga MMPHI
- Tabela 36:** Udhëzimet Administrative të nxjerra nga Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
- Tabela 37:** Udhëzime administrative - Ministria e Ekonomisë
- Tabela 38:** Inspektimet dhe procedurat tjera ligjore
- Tabela 39:** Kallëzimet penale në prokuroritë themelore për dëmet në resurset natyrore në PK 2023 - 2024

Tabela 40:	Inspektimet dhe procedurat tjera ligjore në nivel lokal 2024
Tabela 41:	Aktivitetet për leje-dhënie gjatë vitit 2023 - 2024
Tabela 42:	Shfrytëzimi i ujit 2023-2024 nga ndërrmarrjet e mëdha industriale
Tabela 43:	Sasia e masës drunore (m ³) e shfrytëzuar sipas Drejtorive Koordinuese Regjionale të APK-se dhe sektorëve për vitin 2024
Tabela 44:	Lëndet minerale industriale dhe ndertimore
Tabela 45:	Buxheti i MMPHI për 2023-2024
Tabela 46:	Projektet kapitale mjedisore të mbështetura nga buxheti për MMPHI 2023-2024
Tabela 47:	Projektet me donatorë në sektorin e mjedisit dhe ujërave 2024

Lista e figurave

Figura 1:	Parametrat e monitoruar në AKS1
Figura 2:	Parametrat e monitoruar në ZKS1
Figura 3:	Trendi i mesatareve vjetore të PM ₁₀ për vitet 2013-2024
Figura 4:	Trendi i mesatareve vjetore të PM _{2.5} për vitet 2013-2024
Figura 5:	Trendi i mesatareve vjetore të O ₃ për vitet 2013-2024
Figura 6:	Trendi i mesatareve vjetore të SO ₂ për vitet 2013-2024
Figura 7:	Trendi i mesatareve vjetore të CO për vitet 2013-2024
Figura 8:	Trendi i mesatareve vjetore të NO ₂ për vitet 2013-2024
Figura 9:	Trendi i emetimeve në ajër 2014-2023 (ton/vit)
Figura 10:	Treguesit e përzgjedhur nga monitorimi i cilësisë së ujërave në lumenj- IHMK 2024 (Pellgu i Drinit të Bardhë)
Figura 11:	Treguesit e përzgjedhur nga monitorimi i cilësisë së ujërave në lumenj- IHMK 2024 (Pellgu i Ibrit)
Figura 12:	Treguesit e përzgjedhur nga monitorimi i cilësisë së ujërave në lumenj- IHMK 2024 (Pellgu i Moravës së Binçës dhe Lepencit)
Figura 13:	Trendi nga monitorimi i cilësisë së ujërave të lumenjëve në Pellgun e Drinit të Bardhë për vitet: 2021- 2024
Figura 14:	Përqendrimet mesatare të materiet e ngurta totale të suspenduara 2023 dhe 2024

- Figura 15:** Shpenzimi Biokimik i Oksigjenit (SHBO) në ujërat e katër qyteteve të Kosovës për vitet 2023 dhe 2024
- Figura 16:** Shpenzimi kimik i O₂ (SHKO) për vitin 2023 dhe 2024
- Figura 17:** Azoti total për vitin 2023 dhe 2024
- Figura 18:** Përbërja e mbeturinave në Kosovë
- Figura 19:** Sasia totale e mbeturinave komunale në deponitë sanitare në Kosovë për vitin 2024
- Figura 20:** Deponimi i mbeturinave komunale në deponitë sanitare në Kosovë, 2018 - 2024
- Figura 21:** Trendi i deponimit të mbeturinave 2018 - 2024
- Figura 22:** Trajtimi i mbeturinave komunale në Kosovë
- Figura 23:** Trendi sasia e mbeturinave spitalore të sterilizuara në 8 qendrat spitalore rajonale
- Figura 24:** Gjenerimi dhe trajtimi i mbeturinave industriale në Kosovë
- Figura 25:** Trendi i gjenerimit të mbeturinave industriale në Kosovë 2018-2023
- Figura 26:** Sasia e thasëve dhe qeseve plastikë të importuara 2018 - 2024
- Figura 27:** Sasia e thasëve dhe qeseve plastikë të eksportuara 2018 - 2024
- Figura 28:** Numri i zonave të mbrojtura të natyrës 1950 - 2024
- Figura 29:** Sipërfaqja e djegur ha/vit
- Figura 30:** Metalet
- Figura 31:** Përformanca e AMMK 2016-2024 në kuadër të EIONET

1. Hyrje

Mjedisi përbën një nga asetet më të çmuara të çdo shoqërie dhe është faktor thelbësor për mirëqenien e popullatës, zhvillimin ekonomik dhe ruajtjen e biodiversitetit. Gjendja aktuale e mjedisit në Republikën e Kosovës paraqet një sfidë të vazhdueshme për institucionet përgjegjëse, shoqërinë civile dhe qytetarët në përgjithësi. Ndikimi i aktiviteteve ekonomike, urbanizimi i shpejtë, mungesa e infrastrukturës së përshtatshme për trajtimin e mbeturinave dhe ujërave të ndotura, si dhe përdorimi i paqëndrueshëm i resurseve natyrore, ka sjellë pasoja serioze në komponentët kryesore të mjedisit.

Ky raport ofron një pasqyrë të gjendjes mjedisore në vend, duke analizuar zhvillimet më të rëndësishme për periudhën e fundit raportuese, me fokus të veçantë në cilësinë e ajrit dhe ujit, tokën, menaxhimin e mbeturinave, mbrojtjen e natyrës dhe ndikimet në shëndetin e popullatës. Gjithashtu, raporti shqyrton edhe funksionimin institucional, zbatimin e strategjive dhe planeve të veprimit mjedisor, si dhe mënyrat e financimit dhe bashkëpunimit ndërinstytucional e ndërkombëtar.

Pjesa më e rëndësishme (**e madhe**) e këtij raporti i kushton vëmendje gjendjes së mjedisit ku fillimisht trajtohet cilësia e ajrit, emisioneve ndotëse në ajër dhe gazrave serrë (GHG), të cilat përbëjnë një ndër shqetësimet më të mëdha në aspektin e shëndetit publik dhe ndikimit klimatik. Përveç kësaj, paraqitet edhe kontributi i projekteve të bashkëpunimit ndërkombëtar. Kapitulli adreson edhe gjendjen e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, duke u fokusuar si në aspektin cilësor ashtu edhe në atë sasior, përfshirë edhe trajtimin e ujërave të ndotura dhe shfrytëzimin e burimeve ujore. Pjesa për tokën shqyrton përdorimin bujqësor të saj, ndotjen dhe proceset e monitorimit të tokës.

Pjesa e dedikuar për menaxhimin e mbeturinave flet me theks në gjenerimin, përbërjen, deponimin dhe trajtimin e mbeturinave

komunale, industriale, spitalore si dhe qeseve dhe mbeturinave plastike. Përveç kësaj, trajtohen edhe fenomenet e deponive ilegale që vazhdojnë të përbëjnë rrezik serioz për mjedisin dhe shëndetin publik.

Për ruajtjen e biodiversitetit dhe natyrës, raporti shqyrton gjendjen e zonave të mbrojtura, florës, faunës dhe resurseve pyjore, të cilat janë në presion të vazhdueshëm nga aktivitetet njerëzore dhe ndryshimet klimatike. Pasqyrimi i ndikimeve mjedisore në shëndetin e popullatës paraqitet në kapitullin e katërt, ku analizohen lidhjet ndërmjet ndotjes së ajrit dhe ujit me sëmundjet ambientale.

Po ashtu, në raport janë trajtuar zonat më të ndjeshme dhe të rrezikuara mjedisore, përfshirë ato përreth zonave industriale si KEK, Feronikel, Sharrcem dhe të ashtuquajturat “Hot Spot”-e mjedisore që kërkojnë masa të menjëhershme rehabilituese.

Raporti analizon edhe ecurinë e zbatimit të strategjive dhe planeve të veprimit mjedisor, në nivel qendror dhe lokal, për të vlerësuar efektivitetin e politikave dhe instrumenteve të ndërmarrja deri më tani. Një vlerësim i rëndësishëm i është kushtuar edhe masave konkrete për mbrojtjen e mjedisit, duke përfshirë legjislacionin, mekanizmat e inspektimit dhe sistemin e lejeve mjedisore.

Kapitujt e fundit përqendrohen në mënyrën e menaxhimit të resurseve natyrore (ujore, pyjore dhe minerare), funksionimin institucional dhe kapacitetet e autoriteteve mjedisore, si dhe aspektin financiar të mbrojtjes së mjedisit – duke shqyrtuar projektet e financuara nga buxheti shtetëror, komunat dhe donatorët ndërkombëtarë.

Qëllimi i këtij raporti është të kontribuoj në vetëdijesimin publik dhe institucional për gjendjen reale të mjedisit, të nxisë përgjegjësi më të madhe në menaxhimin e resurseve natyrore dhe të ofroj rekomandime të bazuara në të dhëna për hartimin e politikave të qëndrueshme për të ardhmen mjedisore të vendit tonë.

2. Përmbledhje e të gjeturave kryesore të raportit

Ajri - Cilësia e ajrit në Kosovë për vitin 2024 ka qenë përgjithësisht nën kufijtë e përcaktuar ligjor sipas standardeve të BE-së për mesataren vjetore të ndotësve kryesorë si: PM10, PM2.5, NO₂, SO₂, O₃ dhe CO. Numri i ditëve me tejkalime për PM10, ndonëse brënda kufirit ligjor prej 35 ditësh në vit, ka qenë i lartë në disa stacione urbane: Prishtinë/Rilindje (33 ditë), Kodra e Trimave (21), dhe Obiliq (20) duke treguar për nevojë të ndërhyrjes në zonat me ngarkesë të lartë urbane dhe industriale. Zonat e tjera monitoruese (ZKS1) kanë treguar rezultate më të mira. Vetëm Gjilani ka pasur 26 ditë me tejkalime, ndërsa Hani i Elezit nuk ka pasur asnjë. Të dhënat për periudhën 2013–2024 tregojnë një përmirësim të dukshëm të cilësisë së ajrit, veçanërisht për PM10 dhe PM2.5, që reflekton masat e ndërmarra për zvogëlimin e ndotjes.

Sa i përket emetimeve në ajër, sipas vlerësimit të bazuar në konsumin e lëndëve djegëse, burimi kryesor i emetimeve për ndotësit NO₂ dhe SO₂ është prodhimi i energjisë dhe ngrohjes, ndërsa sa i përket ndotësve PM2.5, PM10, pluhurit total dhe monoksidit të karbonit (CO), burimi kryesor i ndotjes është ai i djegieve të vogla, ku përfshihen burimet residenciale, institucionale dhe komerciale. Transporti është burimi i dytë i ndotjes për NO₂ pas sektorit të prodhimit të energjisë, ndërsa industria prodhuese dhe e ndërtimit është sektori i dytë për ndotje me CO pas djegieve të vogla. Emetimet vjetore të gazrave serrë në Kosovë për vitin 2023 janë vlerësuar rreth 10266 Gg (Giga gram) CO₂ eq., (ekuivalent) ose rreth 10.6 milion ton CO₂ eq. Burimi kryesor i emetimeve të gazrave serrë është sektori i energjisë, me pjesëmarrje prej 87% të totalit të emetimeve. Sektori i dytë është ai i bujqësisë dhe përdorimit të tokës me 7%. Sektori i mbeturinave përfaqëson 4% të totalit të emisioneve.

Uji - Gjendja e ujërave në Kosovë mbetet sfiduese për shkak të presioneve të mëdha mjedisore nga urbanizimi, industria dhe bujqësia intensive. Ndotja më e madhe vjen nga shkarkimi i ujërave të zeza pa trajtim adekuat, si dhe nga shpëlarja e

substancave kimike nga tokat bujqësore. Kjo ndikon në rritjen e materieve organike dhe inorganike në trupat ujorë, si fosfori, azoti dhe materiet e ngurta të pezulluara.

Monitorimi nga IHMK përmes 54 stacioneve tregon ndotje të lartë në lumenj që përshkojnë zona të populluara dhe industriale (Prishtevka/Bresje dhe Graçanka/Vragoli). Në disa raste, vlerat e SHBO5 dhe SHKO kalojnë normat e pranueshme, duke sinjalizuar ndotje të rëndë organike. Megjithatë, përqendrimi i fosforit total në shumicën e stacioneve nuk e tejkalon pragun për eutrofikim.

Trajtimi i ujërave të ndotura ka shënuar përparim me ndërtimin e impianteve moderne në Pejë, Gjakovë, Prizren dhe Skenderaj. Në vitin 2024, rreth 11% e ujërave të ndotura janë trajtuar, krahasuar me vetëm 1% në 2023. Megjithatë, sfida mbetet në kapacitetin e trajtimit të azotit total dhe në mungesën e të dhënave për disa zona.

Toka / Dheu - Bujqësia ka rritje të lehtë dhe kontribuon ndjeshëm në ekonominë e Kosovës. Pjesëmarrja e sektorit të bujqësisë në Bruto Produktin Vendor (BPV) u rrit në 9% në vitin 2024 nga 7.2% në vitin 2023. Rritja reale e BPV-së së përgjithshme për vitin 2024 ishte 4.41%, ndërsa sektori i bujqësisë, pylltarisë dhe peshkimit pati një rritje prej 2.29%.

Sipërfaqja totale e tokës bujqësore në vitin 2024: 420,228.67 ha, me një rënie prej 456.3 ha krahasuar me vitin 2023. Përdorimi i tokës ka ndryshime të vogla negative në sipërfaqe, por ka përparime në tokën e ujitur dhe tek disa kultura bujqësore.

Sipërfaqja e tokës së ujitur në 2014 u rrit në 34,070.28 ha, një rritje prej 88.75% krahasuar me vitin 2023 (18,050 ha). Toka përballet me presion nga ndotja dhe mungesa e sistemit të monitorimit është sfidë kryesore.

Programet subvencionuese kanë ndikuar pozitivisht në investime dhe zhvillim rural. Nuk ekziston sistem permanent dhe gjithëpërfshirës i monitorimit të tokës në Kosovë. Monitorimi i tokës përmes IHMK-së është kryer vetëm për raste specifike ose projekte të BE-së.

Menaxhimi i mbeturinave - Gjenerimi i mbeturinave komunale në Kosovë paraqet variacione të mëdha mes komunave; në disa zona është rritur gjenerimi për banor, ndërsa totali i grumbulluar ka shënuar rënie, duke treguar dobësi në mbledhje dhe raportim.

Përbërja e mbeturinave është e dominuar nga fraksione që mund të riciklohen (plastikë, letër, metal, organike), por mungesa e ndarjes në burim dhe kapaciteteve të trajtimit bën që shumica të përfundojë në deponi.

Deponitë ekzistuese janë kryesisht të mbingarkuara, jo të menaxhuara sipas standardeve, dhe shpesh pranë zonave të banuara ose lumenjve, duke shkaktuar ndotje të ajrit, ujit dhe tokës.

Mungon infrastruktura për riciklim funksional. Edhe pse disa operatorë privat grumbullojnë materiale të riciklueshme, sistemi nuk është i integruar dhe nuk përfshin qytetarët.

Mbeturinat industriale dhe spitalore nuk menaxhohen siç kërkohet me ligj. Ato shpesh përfundojnë në të njëjtat rrugë si mbeturinat komunale, duke rritur rrezikun për shëndetin publik.

Legjislacioni dhe strategjitë ekzistuese janë të harmonizuara në letër me direktivat e BE-së, por zbatimi është i dobët për shkak të mungesës së financimit, kapaciteteve teknike dhe kontrollit institucional. Ndërgjegjësimi i qytetarëve është shumë i ulët. Ndarja e mbeturinave në burim pothuajse nuk ekziston, dhe praktika e djegies së mbeturinave ende haset. Aktualisht, mbi 90% e mbeturinave në Kosovë deponohen.

Mbrojtja e natyrës dhe biodiversitetit - Në vitin 2024, Kosova ka gjithsej 260 zona të mbrojtura, që përfshijnë një sipërfaqe prej 126,112.2 ha, ose 11.5% të territorit.

Kategoritë kryesore të zonave të mbrojtura përfshijnë: 19 Rezervate Strikte të Natyrës, 2 Parqe Kombëtare (Sharri, Bjeshkët e Nemuna), 230 Monumente të Natyrës, 1 Park të Natyrës, 7 Peizazhe të Mbrojtura dhe 1 Zonë të Veçantë për Zogjtë.

Sipërfaqet më të mëdha i zënë Parqet Kombëtare “Sharri” dhe “Bjeshkët e Nemuna”, të cilat janë baza kryesore e ruajtjes së biodiversitetit malor.

Në vitin 2024 janë shtuar nën mbrojtje zona të reja, si “Guri i Hoxhës me gryken e lumit të Perlepticës” (30 ha), ndërsa është në procedurë finalizimi shpallja e “Malit Mokna dhe Liqenit të Ujmanit” (~25,000 ha) si Park i Natyrës.

Pavarësisht rritjes së zonave të mbrojtura, presionet njerëzore mbeten shumë të larta: ndërtimet e pakontrolluara, shfrytëzimi i pyjeve, gjuetia ilegale, turizmi masiv dhe mungesa e menaxhimit efektiv.

Ndryshimet klimatike përbëjnë një rrezik shtesë, duke sjellë zhdukjen ose zhvendosjen e specieve dhe rritjen e rrezikut nga zjarret pyjore. Në vitin 2024, sipërfaqet e prekura nga zjarret janë rritur dukshëm krahasuar me vitin paraprak.

Degradimi i peizazhit dhe fragmentimi i habitateve nga ndërtimet dhe rrugët në parqet kombëtare rrezikon biodiversitetin dhe funksionet ekologjike.

Biodiversiteti i Kosovës është shumë i pasur – me mbi 2800–3000 lloje të florës vaskulare dhe një faunë të larmishme që përfshin specie të rralla dhe të mbrojtura ndërkombëtarisht si ariu i murrëm, rrëqebulli, shqiponja e artë dhe pulegra.

Megjithatë, mungesa e inventarizimit të plotë dhe të dhënave të sakta mbi popullatat e specieve mbetet një boshllëk i madh shkencor.

Ndikimet mjedisore në shëndetin e popullatës- Ndotja e ajrit është një nga kërcënimet më të mëdha për shëndetin publik në Kosovë. Emisionet e PM2.5, PM10, NO2 dhe SO2 nga transporti, industria dhe djegiet shtëpiake ndikojnë drejtpërdrejt në sëmundjet respiratore dhe kardiovaskulare. Sipas OBSH, ndotja e ajrit shkakton çdo vit mbi 7 milionë vdekje të parakohshme në nivel global. Vetëm në Kosovë, në vitin 2024, ndotja e ajrit lidhet me 2,370 vdekje të parakohshme nga PM2.5 dhe 240 nga NO2. Sëmundjet infektive kanë shfaqur luhatje të ndjeshme ndërmjet viteve 2023–2024.

Rritje të rasteve në vitin 2024: diare akute (+30.4%), rotavirus (+27.4%), pertussis (+10,350%), RSV (+160.3%), HIV/AIDS (+70%), dhe sëmundje të tjera zoonotike si brucelloza (+66.7%). Rënie të dukshme: COVID-19 (-19.4%), SARI (-21%), variçela (-40.6%), tuberkulozi (-20.34%). Totali i rasteve është rritur me 31,658 raste ose +12.9% krahasuar me 2023.

Cilësia e ujit të pijshëm ka treguar përmirësim të vazhdueshëm. Në vitin 2024, përputhshmëria me standardet mikrobiologjike dhe fiziko-kimike arriti 98.84%, krahasuar me 96.6% në vitin 2023. Dy KRU-të (Hidroregjioni Jugor dhe Gjakova) kanë arritur 100% pajtueshmëri, ndërsa mesatarja kombëtare mbetet shumë e lartë.

Gjendja e mjediseve të rrezikuara - Gjendja mjedisore në zonat industriale të Kosovës paraqet sfida të mëdha për shkak të aktiviteteve të KEK-ut, Feronikelit, Sharrcem-it dhe minierave të tjera.

Aktivitetet e KEK-ut mbetet burimi më i madh i presionit mjedisor në vend, duke shkaktuar ndotje nga pluhuri, emetimet e gazrave (SO₂, NO_x, pluhur total), ndotje të ujit dhe tokës, si dhe depozitim të sasive të mëdha të hirit. Të dhënat tregojnë rritje të emisioneve ndotëse nga termocentralet dhe grumbullim të mbetjeve të rrezikshme si vajra teknologjikë dhe bateri, që rrezikojnë mjedisin dhe shëndetin publik.

Në rastin e Feronikelit, ndonëse gjatë vitit 2024 fabrika nuk ka qenë funksionale, mbetet shqetësuese gjendja e deponive të skories dhe minierës së Gllavicës, të cilat paraqesin rrezik të ndotjes së tokës dhe ujit.

Sharrcem ka shënuar progres në përmbushjen e standardeve mjedisore pas rilicensimit me IPPC. Është evidentuar ulje e ndjeshme e konsumit të ujit (rreth 50%) dhe përmirësim i menaxhimit të tij përmes riciklimit dhe trajtimit. Gjithashtu, emetimet e SO_x dhe NO_x kanë qenë brenda kufijve të lejuar. Megjithatë, disa kategori të mbeturinave kanë shënuar rritje, si tullat për murim të furrës.

Në aspektin mineral, minierat e Trepçës dhe deponitë e shumta të mbetjeve metalike dhe të rënda paraqesin rrezik të

vazhdueshëm për ndotjen e tokave, ujërave dhe zonave të banuara.

Zbatimi i strategjisë, planit të veprimit dhe planeve sanuese për mjedis- Zbatimi i strategjive dhe planeve mjedisore në Kosovë gjatë vitit 2024 paraqet një situatë të ndërthurur midis progresit dhe sfidave të vazhdueshme. Nga të dhënat rezultojnë se disa dokumente strategjike kyçe si Strategjia për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Zhvillimin e Qëndrueshëm dhe Plani Nacional për Energji dhe Klimë ende gjenden në fazën e hartimit ose rishikimit, duke vonuar zbatimin praktik. Strategjitë e tjera, si Strategjia për Menaxhimin e Integruar të Mbeturisë, Strategjia për Ndryshimet Klimatike, dhe Rishikimi i Strategjisë Shtetërore për Ujërat, janë aprovuar dhe zbatohen në vazhdimësi, megjithëse niveli i zbatimit mbetet i pjesshëm për shkak të mungesës së burimeve financiare, kapaciteteve institucionale dhe koordinimit ndër-institucional.

Në fushën e planifikimit hapësinor, Plani Hapësinor i Kosovës dhe planet menaxhuese për parqet kombëtare janë në fazë fillestare ose të pjesshme, çka tregon për vonesa në implementimin e masave konkrete për mbrojtjen e natyrës dhe përdorimin e qëndrueshëm të hapësirës.

Në nivel lokal, situata paraqet mospërputhje të theksuar mes komunave. Nga 38 komunat e Kosovës, vetëm një pjesë e kanë hartuar dhe po e zbatojnë planet e veprimit për mjedisin, mbeturinat, biodiversitetin dhe cilësinë e ajrit. Disa komuna kanë dokumente në fazë drafti, ndërsa disa të tjera nuk kanë aspak plane. Komunat më aktive (si Rahoveci, Drenasi, Gjakova dhe Prishtina) kanë hartuar disa plane sektoriale, ndërsa komuna të tjera si Juniku dhe Leposaviqi nuk kanë asnjë plan funksional.

Në përgjithësi, gjetjet tregojnë se: Ekziston një kuadër strategjik dhe planifikues i ndërtuar, por niveli i zbatimit mbetet i ulët; Dokumentet shpesh mbeten në fazë hartimi/rishikimi dhe nuk shoqërohen me plane konkrete financiare; Ekzistojnë dallime të mëdha mes komunave në nivel të planeve lokale mjedisore; dhe

monitorimi dhe raportimi mbi zbatimin e strategjive është i kufizuar dhe shpesh jo i standardizuar.

Masat e ndërmarra për mbrojtjen e mjedisit, sukseset nga masat e ndërmarra dhe efekti i tyre në zhvillim ekonomik -

Gjatë vitit 2024 është bërë përparim i rëndësishëm në forcimin e kuadrit ligjor dhe institucional për mbrojtjen e mjedisit në Kosovë. Kuvendi i Kosovës ka miratuar pesë ligje kryesore që adresojnë fusha me rëndësi strategjike si ndryshimet klimatike, promovimi i burimeve të ripërtëritshme të energjisë, performanca energetike e ndërtesave dhe harmonizimi i legjislacionit për kundërvajtjet. Këto ligje kanë krijuar bazën ligjore për reduktimin e ndotjes, rritjen e efikasitetit energjetik dhe përafrimin me standardet e Bashkimit Europian.

Përveç ligjeve, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI) ka nxjerrë gjashtë udhëzime administrative që rregullojnë aspekte praktike të mbrojtjes së mjedisit, duke filluar nga lejet mjedisore të integruara deri te përcaktimi i standardeve të cilësisë së ajrit dhe menaxhimi i deponive. Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) ka miratuar pesë udhëzime administrative që lidhen me ruajtjen e pyjeve, përdorimin e plehrave artificiale dhe menaxhimin e kafshëve, duke kontribuar në menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore. Nga ana tjetër, Ministria e Ekonomisë ka miratuar një udhëzim administrativ që mbështet investimet në energjinë e ripërtëritshme.

Sa i përket inspektimit, gjatë vitit 2024 janë realizuar mbi 649 mbikëqyrje me procesverbal në nivel qendror, 164 vendime dhe 247 gjopa kundërvajtëse. Në nivel lokal, nga 38 komuna vetëm 15 kanë raportuar, duke realizuar gjithsej 1512 inspektime, 988 asistime dhe 102 vendime. Gjithashtu, Drejtoritë e Parqeve Kombëtare kanë iniciuar 87 lëndë në prokurori për dëmet e shkaktuara në resurset natyrore, me një dëm të pretenduar mbi 183,000 euro.

Në fushën e leje-dhënies, gjatë vitit 2024 janë lëshuar 110 pëlqime mjedisore për VNM, 7 pëlqime për VSM, 82 leje mjedisore, 5 leje të integruara, 22 pëlqime ujore, 21 leje ujore për

shfrytëzim dhe 20 për shkarkim. Këto tregojnë një rritje të aktivitetit administrativ dhe zbatimit të legjislacionit, megjithëse ende mbetet nevoja për përmirësim në kohëzgjatjen dhe efikasitetin e procedurave.

Mënyra e menaxhimit të resurseve natyrore dhe mbrojtjen e mjedisit- Operatorët industrialë si KEK-u, NewCo Ferronikeli dhe Sharrcepi përbëjnë shpenzuesit më të mëdhenj të ujit. KEK-u mbetet konsumatori kryesor, me mbi 18 milionë m³ ujë të shpenzuar, kryesisht për procesin e ftohjes. Ndërkohë, NewCo Ferronikeli ka pasur aktivitet minimal për shkak të ndalimit të prodhimit. Në aspektin e ujit të pijshëm dhe amvisërisë, shtatë kompanitë regjionale të ujit kanë shpërndarë rreth 198 milionë m³ ujë, një rritje krahasuar me vitin 2023, përfshirë edhe pjesën veriore të vendit.

Pyjet e Kosovës mbulojnë rreth 44.7% të territorit, me një ndarje në pyje shtetërore (295,200 ha) dhe private (180,800 ha). Në vitin 2024 janë shënuar dëme të mëdha nga zjarret, që kanë prekur mbi 3,469 ha. Pavarësisht kësaj, nuk janë realizuar projekte të reja të pyllëzimit nga buxheti shtetëror, por vetëm ndërhyrje minimale përmes organizatave partnere. Shfrytëzimi i masës drusore ka qenë mbi 91,759 m³, ndërsa prerjet ilegale mbeten problem serioz, duke rezultuar në konfiskimin e rreth 1,194 m³ drush.

Aktiviteti minerar gjatë vitit 2024 ka qenë i gjerë dhe me ndikim të madh ekonomik. Në kategorinë e mineraleve metalike, dominon xeheja e plumbit dhe zinkut me mbi 170,000 tonë, ndërsa shfrytëzimi i nikelit e kobaltit ka qenë minimal. Sa i përket mineraleve energjetike, ligniti vazhdon të mbetet baza kryesore e energjisë vendore, me mbi 8 milionë tonë të nxjerrë në vit. Ndërkaq, në kategorinë e mineraleve industriale e ndërtimore, gëlqerorja ka qenë materiali më i shfrytëzuar (mbi 6.5 milionë m³), e ndjekur nga argjila dhe materialet e tjera për ndërtim.

Financimi i sistemit për mbrojtjen e mjedisit - Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI)

ka shënuar një rritje të ndjeshme të buxhetit total nga 213.48 milion € në vitin 2023 në 265.44 milion € në vitin 2024 (rritje prej rreth 24%). Rritja më e madhe është regjistruar te shpenzimet kapitale (nga 177.86 milion € në 223.16 milion €).

Për vitin 2024, investimet janë përqendruar kryesisht në sektorin e ujërave (digat, shtrati i lumenjve, ujësjellësit dhe sistemet e alarmit), ndërkohë që fondet për menaxhimin e mbeturinave dhe infrastrukturën komunale janë reduktuar ndjeshëm.

Ulja e buxhetit për projektet kapitale mjedisore, nga 9.88 milion € në vitin 2023, buxheti për projektet kapitale të mjedisit ka rënë në vetëm 4.54 milion € në vitin 2024, një ulje prej rreth 54%.

Komunat kanë pasur një buxhet të kombinuar prej 22.73 milion €, me shpërndarje të pabarabartë. Komuna si Prizreni (5.21 milion €), Dragashi (2.68 milion €) dhe Prishtina (2.33 milion €) kanë marrë mbështetje të konsiderueshme, ndërsa komunat e vogla si Ranillugu (14,525 €) dhe Klllokoti (62,992 €) kanë marrë shumë më pak.

Donatorët ndërkombëtarë (BE, SIDA, JICA, Qeveria Zvicerane, WIF, GIZ etj.) kanë qenë burim i rëndësishëm financimi, duke financuar projekte madhore në ujë, ajër, menaxhim mbeturinash, digat dhe ndërtimin e kapaciteteve institucionale. Projektet si EU4Green (11 milion €), Menaxhimi i integruar i resurseve ujore (24 milion €) dhe kontrolli i ndotjes së ajrit nga JICA (3 milion €) tregojnë se mbështetja ndërkombëtare është një shtyllë kyçe e zhvillimit mjedisor.

Është vërejtur fokus në digjitalizim, përmirësim të laboratorëve mjedisorë, krijimin e regjistrave për mbeturina të rrezikshme dhe shenjëzimin e zonave të mbrojtura, gjë që sinjalizon kalimin nga projektet e mëdha infrastrukturore drejt forcimit të kapaciteteve teknike dhe monitoruese.

3. Gjendja e mjedisit dhe trendi

3.1. Ajri

3.1.1. Cilësia e ajrit

Procesi i monitorimit të cilësisë së ajrit paraqet një aktivitet të domosdoshëm që përfshin mbledhjen sistematike dhe analizimin e të dhënave për ndotësit atmosferikë në një territor të caktuar. Ky aktivitet mundëson identifikimin e burimeve ndotëse, vlerësimin e ndikimeve të tyre mbi shëndetin e popullsisë dhe mjedisin, si dhe krijimin e politikave të duhura për përmirësimin e cilësisë së ajrit. Monitorimi realizohet në lokacione të përcaktuara strategjikisht, të cilat përfaqësojnë profile të ndryshme mjedisore si zona urbane, industriale periferike dhe rurale. Në këto zona janë të vendosura stacione të pajisura me teknologji për matjen e ndotësve ajrit. Infrastruktura mbështetëse përbëhet nga një rrjet i integruar prej 12 stacioneve statike dhe një stacioni mobil, që së bashku sigurojnë mbulim të gjerë dhe të qëndrueshëm për mbledhjen e të dhënave. Parametrat e matshëm përfshijnë grimcat e imta (PM10 dhe PM2.5), ozonin (O₃), dioksidin e squfurit (SO₂), dioksidin e azotit (NO₂) dhe monoksidin e karbonit (CO). Në **shtojcën 1** te raportit janë prezantuar **lokacionet e stacioneve te monitorimit të cilësisë së ajrit** dhe karakteristikat e tyre.


Standardet për cilësinë e ajrit në Republikën e Kosovës janë të harmonizuara me direktivat përkatëse të Bashkimit Europian, përkatësisht Direktivën 2008/50/EC, e cila përcakton vlerat kufitare të përqendrimit për ndotësit në periudha të caktuara kohore që nuk duhet të tejkalohen. Legjislacioni mjedisor vendor është përafuar me këto standarde, duke përcaktuar kufij të pranueshëm për ekspozimin afatshkurtër (në baza ditore apo orë) dhe afatgjatë (vjetore). Ekspozimi afatgjatë konsiderohet më i rrezikshëm dhe për këtë arsye standardet përkatëse janë më strikte, duke marrë parasysh efektet e mundshme të dëmshme për shëndetin e njeriut nga ndotësit e vazhdueshëm. Në **shtojcën 2** janë prezantuar **Normat e Cilësisë së Ajrit** sipas Udhëzimit Administrativ Nr.02/2011.

Indeksi i cilësisë së ajrit (ICA) është një tregues që mat nivelin e ndotjes së ajrit dhe ndihmon qytetarët të kuptojnë se sa i pastër ose i ndotur është ajri që thithin. Ky indeks përfshin ndotësit kryesorë si PM2.5, PM10, ozoni në sipërfaqe, dyoksidi i azotit, dyoksidi i squfurit dhe monoksidi i karbonit. Vlerat e indeksit ndryshojnë nga 0 deri në 500, ku vlerat më të ulëta tregojnë cilësi të mirë të ajrit dhe ato më të larta tregojnë ndotje të dëmshme për shëndetin. Indeksi i cilësisë së ajrit është një mjet i rëndësishëm për ndërgjegjësimin publik dhe marrjen e masave për mbrojtjen e shëndetit, sidomos për fëmijët, të moshuarit dhe personat me probleme respiratorë. Monitorimi i përditshëm i tij ndihmon gjithashtu në hartimin e politikave për mjedisin dhe zhvillimin urban të qëndrueshëm.

Tabela.1. Indeksi i cilësisë së ajri

Ndotësit	E mirë	E pranueshme	Mesatare	E dobët	Shumë e dobët	Jashtëzakonisht e dobët
PM2.5	0-10	10-20	20-25	25-50	50-75	75-800
PM10	0-20	20-40	40-50	50-100	100-150	150-1200
NO2	0-40	40-90	90-120	120-230	230-340	340-1000
O3	0-50	50-100	100-130	130-240	240-380	380-800
SO2	0-100	100-200	200-350	350-500	500-750	750-1250

Zonat e monitoruara: Monitorimi i cilësisë së ajrit është i ndarë në dy zona, në atë Aglomerate (AKS1) të cilët janë të vendosur 3 në kryeqytet (IHMK, Rilindje, Kodra Trimave) dhe 3 Obiliq (Qendra Obiliq, Dardhishtë dhe Palaj), dhe Zonën ZKS1 në Gjilan, Hani Elezit, Brezovicë, Prizren, Pejë, Drenas dhe Mitrovicë (harta 1).



Harta. 1. Lokacionet e stacioneve monitoruese të cilësisë së ajrit

Të dhënat për cilësinë e ajrit për vitin 2024 në mesatare vjetore dhe numrin e ditëve me tejkalime për parametrin PM₁₀, PM_{2.5}, O₃, SO₂, NO₂ dhe CO në stacionet monitoruese, tregojnë se mesatarja vjetore për parametrin PM₁₀ në të gjitha stacionet e monitorimit ka qenë nën vlerën kufitare prej 40 µg/m³, duke mos shënuar asnjë tejkalim të kufirit të përcaktuar për këtë ndotës në aspektin e mesatares vjetore.

Edhe tek parametrat e tjerë të monitoruar si PM_{2.5}, O₃, SO₂, NO₂ dhe CO, nuk janë regjistruar tejkalime të kufijve të mesatares vjetore, çka tregon një përmbushje të standardeve të cilësisë së ajrit në këtë aspekt. Megjithatë, në lidhje me numrin e ditëve me tejkalime për PM₁₀, që sipas standardeve nuk duhet të kalojë 35 ditë në vit, rezulton se vetëm një stacion monitorues, konkretisht Prishtinë/Rilindje, ka regjistruar 33 ditë me tejkalime, pra shumë afër kufirit maksimal të lejuar.

Krahasuar me stacionet tjera, si Palaj (1 ditë), Dardhishtë (8 ditë), Prishtinë/IHMK (15 ditë), Obiliq (20 ditë) dhe Kodra e Trimave

(21 ditë), vërehet se ndonëse asnjë prej tyre nuk e ka tejkalar kufirin prej 35 ditësh, prapëseprapë, disa stacione tregojnë ngarkesë të konsiderueshme të ndotjes për periudha të caktuara të vitit.

Kjo situatë reflekton nevojën për masa të qëndrueshme dhe të vazhdueshme për reduktimin e ndotjes, sidomos në zonat urbane të ngarkuara me trafik dhe aktivitete industriale, me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së ajrit dhe ruajtjen e shëndetit publik.

Në tabelën 2 janë të paraqitura të dhënat e cilësisë së ajrit në mesatare vjetore si dhe numri i ditëve me tejkalime për shtatë stacionet monitoruese jashtë zonës aglomerate. Sipas këtyre të dhënave, nuk janë regjistruar tejkalime të standardeve për mesataret vjetore të parametrave të monitoruar, përfshirë PM10, PM2.5, O₃, SO₂, NO₂ dhe CO.

Megjithatë, për parametrin PM10, sipas standardit prej 35 ditë brenda vitit, nuk ka pasur tejkalime të këtij kufiri në asnjë prej stacioneve. Stacioni me numrin më të lartë të ditëve me tejkalime është Gjilani, me 26 ditë, i ndjekur nga Peja -18 ditë dhe Mitrovica -16 ditë. Stacionet Drenasi dhe Brezovica kanë shënuar nga vetëm 2 ditë, ndërsa Hani i Elezit nuk ka regjistruar asnjë ditë me tejkalim.

Këto të dhëna sugjerojnë një situatë relativisht të mirë të cilësisë së ajrit në këto zona për vitin 2024, megjithatë prania e ditëve me tejkalime në disa stacione tregon nevojën për vazhdim të monitorimit dhe zbatimin e masave parandaluese për të parandaluar përkeqësimin e mëtejshëm të cilësisë së ajrit në periudha të caktuara të vitit.

Tabela 2: Të dhënat për cilësinë e ajrit sipas parametrave dhe stacioneve monitoruese në zonën aglomerate për vitin 2024

Stacionet	PM 10 µg/m ³	PM 2.5 µg/m ³	O ₃ µg/m ³	SO ₂ µg/m ³	NO ₂ µg/m ³	CO mg/m ³	Nr. ditëve me tejkalime për PM10
Prishtinë / IHMK	18.5	13.08	39.2	15.6	28.1	0.7	15
Prishtinë / Rilindje	26.83	18.17	47.8	12.3	14.8	0.5	33
Palaj	15.17	9.92	47.3	10.4	8.8	0.4	1
Obiliq	20.75	15.42	45.3	11.7	9.3	1.0	20
Dardhishtë	17.08	11.92	45.3	6.9	5.4	1.1	8
Kodra Trimave	22.08	15.92	58.4	8.3	17.3	0.3	21




Figura 1: parametrat e monitoruar në AKS1




Figura 2: Parametrat e monitoruar në ZKS1

Tabela 3: Të dhënat për cilësinë e ajrit sipas parametrave dhe stacioneve monitoruese ZKS1 për vitin 2024

Stacionet	PM 10 µg/m3	PM 2.5 µg/m3	O3 µg/m3	SO2 µg/m3	NO2 µg/m3	CO mg/m3	Nr. Ditëve me tejkalime për PM10
Drenas	15.2	10.6	7.5	6.42	13.3	0.6	2
Mitrovicë	20.5	14.5	9.2	22.42	15.3	0.6	16
Pejë	20.6	13.7	4.8	6.08	15.3	0.9	18
Prizren	14.5	10.3	6.7	8.92	18.5	0.8	7
Brezovicë	9.6	7.3	2.4	4.67	1.1	0.3	2
Hani Elezit	15.3	11.1	10.0	6.25	14.3	0.5	0
Gjilan	20.8	16.8	6.4	6.92	16.6	0.4	26

Trendi i cilësisë së ajrit: Bazuar në të dhënat e monitorimit për periudhën 2013–2024, është analizuar edhe trendi i cilësisë së ajrit, nga i cili konstatohet një përmirësim i dukshëm i cilësisë së

ajrit në gjithë territorin e Republikës së Kosovës. Analiza është zhvilluar në bazë të koncentrimeve vjetore të parametrave të monitoruar. Viti 2024 shënon një rënie të ndjeshme sidomos për grimcat PM₁₀ dhe PM_{2.5}, krahasuar me vitet paraprake. Në grafikët e mëposhtëm paraqitet trendi i cilësisë së ajrit për parametrat PM₁₀, PM_{2.5}, O₃, SO₂, NO₂ dhe CO përgjatë viteve 2013–2024.




Figura 3: Trendi i mesatareve vjetore të PM₁₀ për vitet 2013–2024




Figura 4: Trendi i mesatareve vjetore të PM_{2.5} për vitet 2013–2024




Figura 5: Trendi i mesatareve vjetore të O₃ për vitet 2013-2024




Figura 6: Trendi i mesatareve vjetore të SO₂ për vitet 2013-2024




Figura 7: Trendi i mesatareve vjetore të CO për vitet 2013-2024




Figura 8: Trendi i mesatareve vjetore të NO₂ për vitet 2013-2024

3.1.2. Emisionet në ajër

Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, në baza vjetore bën vlerësimin e emisioneve në ajër, bazuar në konsumin e lëndëve djegëse. Gjatë vitit 2025 është bërë vlerësimi për emetimet në ajër, bazuar në konsumin e lëndëve djegëse për vitin 2023. Të dhënat janë bazuar në bilancin energjetik të Kosovës për vitin 2023.

Sikurse shihet edhe nga të dhënat e prezantuara në tabelë, burimi kryesor i emetimeve për ndotësit NO₂ dhe SO₂ është prodhimi i energjisë dhe ngrohja, ndërsa sa i përket ndotësve PM_{2.5}, PM₁₀, Pluhurit total dhe Monoksidit të Karbonit (CO) burimi kryesor i tyre është ai i djegieve të vogla, ku përfshihen burimet residenciale, institucionale dhe komerciale. Transporti është burimi i dytë i ndotjes për NO₂ pas sektorit të prodhimit të energjisë, ndërsa industria prodhuese është sektori i dytë për ndotje me CO pas djegieve të vogla.

Tabela 4. Emisionet në ajër nga ndotësit kryesor sipas burimeve të emetimeve (ton/vit)

Burimet e emetimeve	NO ₂	SO ₂	PM _{2.5}	PM ₁₀	PT	NMVOC	CO
Industria energjetike (prodhimi i energjisë dhe ngrohjes)	13,370	90,870	180	430	640	80	470
Industria prodhuese dhe e ndërtimit	6,120	1,460	420	440	450	560	2,050
Transport (aviacioni, automjetet dhe hekurudhat)	9,890	910	390	390	390	480	1,270
Djegiet e vogla (komerciale, rezidenciale dhe nga bujqësia)	1,600	6,100	7,320	7,520	7,920	6,090	39,820
Gjithsej (ton/vit)	30,980	99,340	8,310	8,780	9,400	7,210	43,610




Figura 9. Trendi i emetimeve në ajër 2014-2023 (ton/vit)

3.1.3. Emetimet e Gazrave Serrë (GHG)

Në kuadër të aktiviteteve, AMMK ka bërë edhe vlerësimin e emetimeve të gazrave serrë për vitin 2023. Emetimet vjetore të gazrave serrë në Kosovë për vitin 2023 janë vlerësuar rreth 10080 Gg (Giga gram) CO₂ eq., (ekuivalent) ose rreth 10 milion ton CO₂ eq. Burimi kryesor i emetimeve të gazrave serrë është sektori i energjisë, me pjesëmarrje prej 83% të totalit të emetimeve. Sektori i dytë është ai i bujqësisë dhe përdorimit të tokës me 7%. Sektori i mbeturinave përfaqëson 6% të totalit të emisioneve, kurse sektori i proceseve industriale me rreth 3% (tabela 5).

Tabela 5. emetimet e përgjithshme të gazrave serrë në Kosovë, sipas sektorëve 2023

Kategoria (sektori)	Gg CO ₂ eq.	%
Energjia	8376	83
Proceset industriale	372	3
Bujqësia dhe përdorimi i tokave	750	7
Mbeturinat	582	6
Totali i emetimeve	10080	100%

Krahasuar me vitin paraprak, në vitin 2023 është shënuar rënie e emetimeve të përgjithshme për rreth 724 Gg CO₂ eq. Rënie të emetimeve ka pasur në kategorinë e emetimeve nga sektori i

energjisë dhe bujqësisë, ndërsa që në kategoritë e emetimeve nga sektori i mbeturinave dhe proceseve industriale ka pasur rritje të emetimeve. Totali i emetimeve të gazrave serrë në Kosovë është i varur shumë nga sasia e energjisë së prodhuar nga thëngjilli që është burimi kryesor i emetimeve të gazrave serrë në vendin tonë. Në bazë të vlerësimeve të emetimeve në këtë sektor gjatë vitit 2023 ka pasur rënie për rreth 5% të emetimeve.

Kategoritë kyçe të emetimeve të gazrave të serrës sipas IPCC tek sektori i energjisë janë industria e energjisë, transporti rrugor, industria prodhuese dhe ndërtimit, tek sektori i bujqësisë është fermentimi enterik, tek sektori i mbeturinave është deponimi i mbeturinave të ngurta, ndërsa tek proceset industriale është prodhimi i çimentos.

Tabela 6. kategoritë kyçe të emetimeve për vitin 2021 sipas IPCC

kategoritë sipas IPCC	Kategoria sipas IPCC	Gazi serrë i emetuar
1.A.1	Industria e Energjisë	CO ₂
1.A.3	Transporti Rrugor	CO ₂
1.A.2	Industria Prodhuese dhe e Ndërtimit	CO ₂
3.A.1	Fermentimi Enterik	CH ₄
4.A	Deponimi i Mbeturinave të Ngurta	CH ₄
2.A.1	Prodhimi i Çimentos	CO ₂

Gazi kryesor i emetuar është CO₂ me 86%, Metani (CH₄) merr pjesë me rreth 12% të emetimeve totale, ndërsa N₂O dhe HFC marrin pjesë me rreth 2% të emetimeve (tabela 7).

Tabela 7. Emetimet sipas gazrave (2023)

Gazrat e emetuara	CO ₂ eq. (Gg)	%
CO ₂	8660	86
CH ₄	1202	12
N ₂ O	218	2

3.2. Uji

Burimet e përgjithshme të ujit në Kosovë përdoren kryesisht për qëllime urbane, industriale dhe bujqësore, andaj edhe zhvillimi industrial, urbanizimi, bujqësia intensive janë vetëm disa prej faktorëve që ndikojnë në ndotjen e ujërave. Përkundër angazhimit të vazhdueshëm, shfrytëzimi i pakontrolluar i resurseve ujore dhe dëmtimi i shtretërve të lumenjve, ende mbetet një nga format e degradimit të resurseve tona ujore.

Problemi më kritik aktual është ndotja e ujërave sipërfaqësor që shkaktohet nga shkarkimi i ujërave, presionet e tilla vijnë kryesisht si pasojë e rritjes së vëllimit të ujërave të shkarkuara pa trajtimin adekuat fizik, kimik e biologjik. E gjithë kjo ndikon në rritjen e vlerave të parametrave fizikë, kimik dhe mikrobiologjik në trupat ujqor.

Presione të tjera nga reshjet janë shpëlarja e tokave bujqësore dhe sipërfaqeve të tjera ndotëse me ç'rast vije deri te rritja e materieve të suspenduara, materive inorganike (fertilizerët-N, P, K, NH_4^+ etj.) dhe atyre organike (PCB, Herbicide etj). Ndër presionet më të mëdha në trupat ujqor janë shkarkimet industriale të veprimtarive të ndryshme.

Gjatë viteve të fundit janë hartuar politika për një menaxhim më të mirë të burimeve ujore nëpërmjet vendosjes së një kuadri monitorimi dhe kontrolli, për të reduktuar ndotjen e ujërave nëntokësore dhe sipërfaqësore nga aktivitetet e veprimtarive industriale, bujqësore dhe aktiviteteve të popullsisë në zonat rurale dhe urbane, që shkaktojnë dëmtim të ekosistemeve ujore, si dhe të lumenjve nga shfrytëzimi pa kriter, menaxhimi i ujërave ndërkuftare, zvogelimi i efekteve nga përmbytja dhe thatësira.

3.2.1. Cilësia e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore

Monitorimin e ujërave të lumenjve në territorin e Republikës së Kosovës e bën Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës. Cilësia e këtyre lumenjëve përcaktohet në bazë të analizave fizike, kimike dhe metaleve të rënda. Rrjeti i monitorimit ka gjithsej 54 vendmostrime (stacion monitoruese). Parametrat fizik që aktualisht monitorohen janë 10 parametra fizikë (maten 11 herë në vit), 39 parametra kimik (maten 11 herë në vit) dhe 8 metale të rënda (2 herë në vit).

Në këtë raport gjendjen e ujërave është pasqyruar përmes treguesve (parametrave): Oksigjeni i tretur (mg/l O_2); Shpenzimi biokimik i oksigjenit- SHBO_5 (mg/l O_2), Shpenzimi kimik i oksigjenit- SHKO (mg/l O_2); Karboni organik total-C (mg/l); Fosfori total - P (mg/l), Materiet totale të suspenduara-MTS (mg/L). Vlerat e prezentuara në grafikun janë si vlera mesatare për vitin 2024.

Në **shtojcën 3** të raportit, janë prezantuar parametrat që monitorohen dhe frekuenca e matjeve, kurse në **shtojcën 4** është prezantuar tabela me kodet e stacioneve të monitorimit të kualitetit fiziko-kimik të ujërave sipërfaqësore - lumenjtë.

Parametrat si: oksigjeni i tretur (O_2), oksigjeni biokimik i shpenzuar për 5 ditë (SHBO_5), shpenzimi kimik i oksigjenit (SHKO), tregojnë nivelin e ndotjes organike dhe bakteriologjike të ujit i cili hynë në grupin e parametrave të cilët pritet të kenë presione nga ato dukuri që u cekën më lartë. Derisa, prezenca e fosforit (P_{tot}) shkakton eutrofikimin në ujëra.

Pellgu i Drinit të Bardhë - Në këtë pellg përzgjedhja e pikave monitoruese është bërë për dy lumenjtë: lumi Drini i Bardhë dhe lumi Ereniku, ku si vlera mesatare vjetore të ngritura paraqiten Shpenzimi Kimik i Oksigjenit (SHKO) dhe atë në stacionet monitoruese përgjatë rrjedhjes së lumenjëve duke përjashtuar stacionet referente (vendburimet).




Figura 10: Treguesit e përzgjedhur nga monitorimi i cilësisë së ujit në lumenjëve-IHMK 2024 (Pellgu i Drinit të Bardhë)

Pellgu i Ibrit – Në këtë pellg përzgjedhja e pikave monitoruese është bërë për këta lumenjë: Ibrit, Sitnica, Prishtevka, Graçanka dhe Drenica, nga ku vërehet se lumi Prishtevka/Bresje dhe Graçanka/Vragoli pothuajse me të gjithë parametrat e paraqitur tregon vlera më të ngritura, ngase vetë shtrirja e lumit është përgjatë zonës më të populluar dhe që përfshinë edhe zona industriale.




Figura 11: Treguesit e përzgjedhur nga monitorimi i cilësisë së ujit në lumenj- IHMK 2024 (Pellgu i Ibrit)

Pellgu i Moravës së Binçës dhe Lepencit - Në pellgun Morava e Binçës është përzgjedhur lumi Morava e Binçës me gjithsej katër stacione monitoruese, ku ngritje e theksuar është parametri shpenzimi kimik i oksigjenit. Ndërsa në Pellgun e Lepencit, janë përzgjedhur dy lumenj: ai i Lepencit dhe Nerodimja, ku edhe këtu shpenzimi kimik i oksigjenit tregon ngritje përgjatë rrjedhjes së lumit.




Figura 12: Treguesit e përzgjedhur nga monitorimi i cilësisë së ujërave në lumenj- IHMK 2024 (Pellgu i Moravës së Binçës dhe Lepencit)

Bazuar në këto tri grafikone (shtrirjen territoriale në të gjitha pellgjet) ku prezenca e sasisë së fosfori total/ mg/l P nga analizat e bëra tregojnë se sasia e fosforit në ujërat e lumenjëve nuk paraqet ndikim të shprehur në ujërat sipërfaqësore, sepse vlerat e tij të paraqitura në diagramet për vitin 2024 gjendet në mes 0.10 mg/l P (Ibër/Kushtovë) dhe 2.69 mg/l P (Prishtevka/Bresje). Nga konstatojmë se ujërat sipërfaqësore në Kosovës nuk janë të rrezikuar me eutrofikim.

Po ashtu, edhe treguesi Shpenzimi Biokimik i Oksigjenit (SHBO₅), gjatë periudhës së monitorimit për vitin 2024, tregon se vlerat e përlogaritura gjenden në mes të 0.65 mg O₂/l Ibër/Kushtovë dhe 40.51 mg O₂/l, në lumin Prishtevka/Bresje, ku për këtë vit, lumenjtë Prishtevka/Bresje dhe Graçanka/Vragoli tregojnë për ndotje me vlerën më të lartë mesatare vjetore. Edhe pse në kushte natyrore ujërat e pastra nuk posedojnë fare sasi të SHBO₅, kjo ndotje arsyetohet me faktin që ujërat sipërfaqësore i ekspozohen gjithnjë shkarkimeve të ujërave të ndotura përmes të cilave dhe krijohen kushte optimale për rritjen e vlerës së SHBO₅.

Programi i Qeverisë për investime në menaxhimin e ujërave të ndotura, në kuadër të investimeve të planifikuara 2017-2024, së bashku me donatorët kanë kryer investime në impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura në vlerë mbi 60 milion EUR (ITUN për Prizrenin, Pejën dhe Gjakovën). Investimet e tilla të ITUN në Pellgun e Drinit të Bardhë, edhe pse në fazat fillestare, ka rezultuar me përmirësim të cilësisë së ujit në lumenj.





Figura 13: Trendi nga monitorimi i cilësisë së ujërave së lumenjëve në Pellgun e Drinit të Bardhë për vitet: 2021- 2024

Trendi i cilësisë së ujërave sipërfaqësore (lumënjëve) për vitet 2023-2024 është prezantuar në **shtojcën 5**.



Harta 2: Rrjeti i ujërave sipërfaqësore në Kosovë

Substancat Prioritare Organike në Ujërat Sipërfaqësore dhe Nëntokësore

Në kuadër të programit pilot të monitorimit të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore të projektit MIRU-K, programi i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Qeverisë së

Kosovës (QK), gjatë vitit 2024 për herë të parë është realizuar monitorimi i substancave prioritare organike, me karakter hulumtues dhe në përputhje të plotë me kërkesat e Direktivës Kornizë të Ujit 2000/60/EC si dhe legjislacionit përkatës në fuqi në Republikën e Kosovës.

Fokusi kryesor i këtij aktiviteti ka qenë identifikimi dhe vlerësimi i pranisë së pesticideve klor-organike dhe hidrokarbureve aromatike poliaromatike (PAH), të cilat përbëjnë substanca me potencial të lartë ndikimi mbi cilësinë e ujit dhe ekosistemet ujore. Përzgjedhja e këtyre parametrave është bazuar në vlerësimin e presioneve dhe ndikimeve potenciale që vijnë nga sektori bujqësor dhe industrial.

Monitorimi është kryer në kater pellgjet lumore: Ibër, Morava e Binçës, Lepenc dhe Drini i Bardhë.

Matjet janë zhvilluar në stacione ekzistuese të rrjetit të Institutit Hidrometeorologjik të Kosovës (IHMK), me qëllim të zgjerimit të fushës së monitorimit dhe vlerësimit gjithëpërfshirës të gjendjes së ujërave.

Mostrat e ujit janë mbledhur dhe analizuar dy herë gjatë vitit, duke siguruar mbulueshmëri të ndryshimeve sezonale. Analizat laboratorike janë kryer sipas metodologjive të standardizuara, me pajisje të avancuara analitike për zbulimin dhe kuantifikimin e përbërjeve organike në gjurmë.

Ky aktivitet ka rëndësi të veçantë pasi përbën hapin e parë drejt krijimit të një sistemi të qëndrueshëm të monitorimit të substancave prioritare në Kosovë, duke mundësuar që në të ardhmen të realizohen analiza trendesh afatgjata dhe të ndërmerren masa parandaluese apo rehabilituese në rast të detektimit të ndotjeve.

Tabela 8: Lista e substancave organike proiritare

1. Pesticidet klor-organike	2. Hidrokarburet Policiklike Aromatike (PAH)
Aldrin, Dieldrin, Endosulfan, Endrin, Lindan, Heksaklorobenzen, Isodrin, Pentaklorobenzen, DDT Total, Para DDT	Antraceni, Naftalinë, Fluoranten, Benzo (a) Piren, Benzo (b) fluorescent, Benzo (g, h, i) perilen, Indeno (1,2,3-cd) pirene, Acenafteni, Fenantrene, Fluoren, Piren, Benzo (a) antraceni, Kriseni, Benzo (a, h) antraceni.

3.2.2. Sasisa e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore

Përveç cilësisë së ujërave, IHMK bën edhe monitorimin e sasisë së ujërave. Monitorimi i sasisë së ujërave bëhet përmes rrjetit hidrometrik i cili përbëhet nga një numër i stacioneve matëse nëpër lumenj, ku kryhen matje për sasinë e ujit. Në këto stacione matet Nivelin (H) dhe Prurja (Q). Në tabelat vijuese janë prezantuar të dhënat për nivelin e ujit H (cm) dhe Prurja (Q) në stacionet hidrometrike të realizuara për vitin 2023-2024.

Tabela 9. Vlerat mesatare vjetore të nivelit H (cm) sipas stacioneve matëse 2023-2024

Stacioni	Mes./Vjetore 2023 H (cm)	Mes./Vjetore 2024 H (cm)
Gjonaj	236	-
Këpuz	150	141
Gjakovë	-	140
Deçan	-	39
Grykë Rugoves	93	81
Drelaj	68	57
Vlashnjë	-	55
Prizren	44	47
Mirushë	-	54
Klinë	48	39
Berkovë	123	85
Leposaviq	235	-
Vragoli	66	51
Drenas	-	34
Milloshëvë	-	138
Lluzhan	-	56
Mitrovicë	122	95
Orllan	31	25
Mramorë	16	13
Lupç i Epërm	54	-
Konçul	263	234
Viti	39	31
Hani i Elezit	81	-
Domorovc	-	116

Brod	32	32
Kaçanik	-	44
Mlikë	70	68
Orqushë	-	45

Në tabelën 10 janë prezantuar të dhënat për prurjet Q (m³/sec), për stacionet monituese hidrometrike të ujërave sipërfaqësore të realizuara për vitin 2023-2024, ndërsa në tabelën 11 janë prezantuar të dhënat për prurjet Q (m³/sec), për stacionet monituese hidrometrike të ujërave nëntokësore.

Tabela 10: Vlerat mesatare vjetore të prurjeve Q (m³/sec) sipas stacioneve matëse 2023-2024

Stacioni	Mes./Vjetore_2023 Q (m ³ /s)	Mes./Vjetore_2024 Q (m ³ /s)
Gjonaj	81.75	-
Deçan	-	0.907
Grykë	8.488	4.442
Prizren	1.934	2.034
Viti	-	0.508
Brod	0.928	0.918
Mlikë	1.469	1.347

Tabela 11: Vlera mesatare vjetore (m) sipas disa stacioneve matëse të ujërave nëntokësor për vitin 2024

Stacioni	Vlera mesatare vjetore (m)	Stacioni	Vlera mesatare vjetore (m)
B.Curr	14.239	Moglice	1.874
Buqan	2.108	NerodimeF1	1.278
Buroje	2.297	NerodimeF2	2.405
Gerlic	1.132	Obiliq	1.261
Gjinoc	3.117	Prapaqan	5.544
Jelloc	1.901	Qitak	9.211
Jezerc	3.447	Qyshk	5.665
Kamenice	3.508	Serbovc	25.033
KEK-Azotik	2.081	Shkugez	2.978
Konjuh	7.218	Talinoc	6.888

Kovrage	12.464	Terstenik	0.768
Kozmin	2.995	Varosh	9.341
Lismir	2.232	Vragoli	2.784
Lladove	2.802	Zoqisht	10.44

Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës nga viti 2024, në 7 profilet kryesore hidrometrike të lumenjëve kryesorë, ka instaluar “Sistemin e Kamerave” (DischargeKeeper), të cilat paraqesin teknologji të avancuara për monitorimit të Lumenjve. Në këto profilet hidrometrike (tabela 12) përmes imazheve apo fotogrametrisë, në të njëjtën kohë regjistrohen parametrat kryesore hidrologjik siç janë, shpejtësia (v), thellësia (h) dhe sasia (prurja m³/s apo l/s).

Përmes këtij sistemi, mundësohet përcjellja dhe transferimi në kohë reale i niveleve kritike gjatë situatave të rënduara hidrometeorologjike për paralajmërim të hershëm. Fotogrametria, realizohet pa ndërpre gjatë ditës dhe natës.

Tabela 12: Sistemi i monitorimit të lumenjve me anë të sistemit të kamerave

Nr.	PELLGU	LUMI	VENDI	N	E	L.m.n.d	Intervale
1	Drini	Drini Bardhë	Gjonaj	42°15'15.39"	20°38'57.83"	306	30 min.
2	Drini Bardhë	Bistrica Pejës	Grykë R.	42°39'41.91"	20°15'00.84"	581	30 min.
3	Drini Bardhë	Klinës	Klinë	42°36'54.60"	20°34'38.48"	380	15 min.
4	Ibri	Ibri	Leposaviç	43°05'50.75"	20°47'58.13"	456	30 min.
5	Ibri	Sitnicë	Nedakoc	42°47'52.97"	20°59'24.77"	517	30 min.
6	Morava Binçës	Morava Binçës	Viti	42°19'04.16"	21°21'34.12"	506	15 min.
7	Lepenci	Lepenc	Hani Elezit	42° 09'22.95	21°17'32.36"	376	15 min.

3.2.3. Trajtimi i ujërva të ndotura

Në Kosovë, ka filluar një proces i rëndësishëm raportimi i parametrave të cilësisë së ujërave të ndotura që lidhet me

operimin e impianteve të trajtimit të ujërave të zeza në qytetet Skenderaj, Prizren, Pejë dhe Gjakovë. Këto impiante, të cilat kanë filluar së funksionuari viteve të fundit, ne përjashtim të atij në Skenderaj përfaqësojnë një hap të madh përpara në përmirësimin e menaxhimit të ujërave të zeza dhe mbrojtjen e mjedisit në Kosovë, duke synuar reduktimin e ndotjes së lumenjve dhe burimeve ujore.

Impianti i parë i ndërtuar në Kosovë është ai i Skenderajt, me një kapacitet prej afërsisht 10,000 banorë ekuivalentë (b.e.). Ky projekt, i financuar nga Bashkimi Europian, ofron trajtim mekaniko-biologjik të ujërave të zeza, duke ndihmuar në mbrojtjen e lumenjëve dhe burimeve të ujërave natyrore nga ndotja.¹ Në fakt, ky është një nga projektet pilot të BE-së në Kosovë, me qëllim provimin dhe demonstrimin e teknologjive të trajtimit të ujërave të zeza në nivel lokal.

Në Prizren, impianti për trajtimin e ujërave të zeza urbane është një nga projektet më të mëdha dhe më të avancuara në vend i cili është mbështetur nga shteti gjerman, Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Komuna e Prizrenit. Ky impiant ka kapacitet për 50,000 banorë ekuivalentë (b.e.), që përbën rreth 35% të popullsisë së qytetit.

Në Gjakovë, impianti për trajtimin e ujërave të zeza është një projekt i madh urban për trajtimin e ujërave të zeza i cili për momentin do t'i shërbejë rreth 30,000 banorëve ekuivalentë (b.e.).²

Në Pejë, impianti për trajtimin e ujërave të zeza është një nga të parët e llojit të tij në Kosovë, me kapacitet fillestar për 81,000 banorë ekuivalentë (b.e.), me mundësi zgjerimi deri në 98,000 (b.e.). Ky impiant trajton ujërat e zeza të qytetit dhe fshatrave

¹ European Union Office in Kosovo (2016) 'Construction of first wastewater treatment plant in Kosovo: an EU pilot project.

² Swiss State Secretariat for Economic Affairs (SECO) (2013) Wastewater Treatment Plant Project Gjakova Kosovo: Institutional Feasibility Study.

përreth, duke kontribuar në përmirësimin e cilësisë së ujërave dhe të kushteve të jetesës së banorëve.³

Falë impianteve të reja në Pejë, Gjakovë dhe Prizren, Kosova ka arritur të trajtojë rreth 11% të ujërave të zeza në nivel vendi, nga vetëm 1% që ishte deri në vitin 2023. Ky progres është rezultat i studimeve të fizibilitetit, financimit ndërkombëtar dhe bashkëpunimit me partnerët e jashtëm dhe autoritetet lokale.

Ky kapitull paraqet vlerat mesatare mujore të parametrave kryesorë të matur të raportuar, duke përfshirë grimcat e ngurta të suspenduara (TSS), shpenzimin biokimik të oksigjenit (SHBO), shpenzimin kimik të oksigjenit (SHKO) dhe azotin total për secilin nga këto impiante. Vlen të theksohet se parametri i fosforit total nuk është monitoruar nga impiantet. Krahasimi i këtyre vlerave me kufijtë e lejuar sipas udhëzimeve administrative ofron një pasqyrë të qartë të zbulimit të tejkalimeve të ndotjes, duke ndihmuar në identifikimin e zonave ku kërkohet ndërhyrje dhe përmirësim.

Ky proces i ri i raportimit dhe monitorimit është një hap thelbësor drejt zbatimit të standardeve mjedisore dhe përmbushjes së kërkesave ligjore, duke kontribuar në përmirësimin e gjendjes së ujërave në Kosovë dhe duke u harmonizuar gradualisht me praktikat dhe kërkesat e vendeve evropiane për trajtimin e ujërave të zeza.

Materiet e ngurta totale të suspenduara janë grimcat e ngurta, organike dhe inorganike, që mbeten të pezulluara në ujë ose ujërat e zeza pas vendosjes së gravitetit. Kjo matje është parametër kyç në monitorimin mjedisor dhe vlerësimin e cilësisë së ujit, duke ndikuar në cilësinë e ujit, ekologjinë dhe shëndetin e njerëzve.⁴ Nivelet e larta të TSS reduktojnë transparencën, ulin nivelin e oksigjenit të tretur dhe mund të shkaktojnë vdekje të

³ State Secretariat for Economic Affairs (SECO) (2014) *Wastewater Treatment Project Peja, Kosovo: Complementary Feasibility Study*. 17 September 2014. Bern: SECO.

⁴ US Environmental Protection Agency (EPA), 2022. *Total Suspended Solids (TSS) in Water Samples*.

organizmave akuatikë. Gjithashtu, TSS mund të bartë patogjenë dhe metale të rënda, duke rritur rrezikun për shëndet.⁵




Figura 14. Përqendrimit mesatare të materiet e ngurta totale të suspenduara 2023 dhe 2024

Të dhënat e paraqitura në figurën 14 përfaqësojnë përqendrimit mesatare të materiet e ngurta totale të suspenduara në katër impiantet të cilat operojnë si në (Skënderaj, Prizren, Gjakovë dhe Pejë) për vitet 2023 dhe 2024. Të gjitha vlerat janë shumë larg kufirit maksimal të lejuar, duke treguar menaxhim të mirë të cilësisë së ujit në aspektin e materieve të ngurta totale të suspenduara.

Kërkesa Biokimike e Oksigjenit (KBO_5) është një tregues i ndotjes organike në ujë, sasia e oksigjenit të shpenzuar nga mikroorganizmat aerobe për të dekompozuar materialin organik në ujë, në një temperaturë të caktuar (zakonisht 20°C) dhe për një periudhë të caktuar (zakonisht 5 ditë). Vlera më të larta të KBO_5 -së nënkuptojnë prani më të madhe të materieve

⁵ Smith, J. and Brown, K., 2019. 'Monitoring of suspended solids in wastewater treatment plants.' *Journal of Environmental Engineering*,

organike që konsumojnë oksigjen gjatë dekompozimit.⁶ Matja e KBO₅ është një tregues kryesor për vlerësimin e cilësisë së ujit dhe efektivitetin e trajtimit të ujërave të zeza.⁷

Sipas standardeve ndërkombëtare, lumenjtë më të pastër kanë vlera të KBO₅ më të ulëta se 1 mg O₂/L, ndërsa lumenjtë mesatarisht dhe rëndë të ndotur tregojnë vlera nga 2 deri në 8 mg O₂/L.⁸




Figura 15: Shpenzimi Biokimik i Oksigjenit (SHBO) në ujërat e katër qyteteve të Kosovës për vitet 2023 dhe 2024

Asnjë nga vlerat e SHBO-së nuk tejkalon kufirin e lejuar prej 25 mg/L, që tregon se uji është brenda standardeve për këtë parametër. Gjakova ka përmirësim të dukshëm në vitin 2024, ndërsa Prizreni dhe Peja kanë rritje të SHBO-së, që kërkon kujdes të shtuar në të ardhmen.

⁶ APHA, AWWA, WEF, 2017. *Standard Methods for the Examination of Water and Wastewater*. 23rd ed. Washington, DC: American Public Health Association.

⁷ Metcalf & Eddy, Inc., 2014. *Wastewater Engineering: Treatment and Resource Recovery*. 5th ed. New York: McGraw-Hill.

⁸ European Commission - Environment, Urban Wastewater / Direktivën e Përpunimit të Ujërave të Ndotura Urbane (Urban Wastewater Treatment Directive - UWWTD).

Kërkesa Kimike e Oksigjenit (KKO) është sasia e oksigjenit të nevojshëm për të oksiduar kimikisht të gjithë materialin organik dhe inorganik në ujë, duke përdorur agjentë të fortë oksidues.⁹ KKO përdoret për të vlerësuar shpejt nivelin e ndotjes organike dhe inorganike në ujëra.¹⁰ KKO është gjithmonë më i lartë se KBO, pasi përfshin edhe substanca që nuk shpërbehen biologjikisht.¹¹ Vlerat e KKO janë zakonisht 1.5–2 herë më të larta se KBO, por kjo varion sipas burimit të ujit.¹² KKO është një indikator i rëndësishëm për praninë e ndotësve organik që konsumojnë oksigjen gjatë dekompozimit. Sa më e lartë vlера, аq më i ndotur është uji.




Figura 16: Shpenzimi kimik i O₂ (SHKO) për vitin 2023 dhe 2024

⁹ APHA, AWWA, WEF, 2017. Standard Methods for the Examination of Water and Wastewater. 23rd ed. Washington, DC: American Public Health Association.

¹⁰ Metcalf & Eddy, Inc., 2014. *Wastewater Engineering: Treatment and Resource Recovery*. 5th ed. New York: McGraw-Hill.

¹¹ Tchobanoglous, G., Burton, F.L. and Stensel, H.D., 2014. *Wastewater Engineering: Treatment and Resource Recovery*. 5th ed. New York: McGraw-Hill.

¹² Metcalf & Eddy, Inc., 2014. *Wastewater Engineering: Treatment and Resource Recovery*. 5th ed. New York: McGraw-Hill.

Bazuar nga rezultatet në figuren 16 të gjitha vlerat janë brenda kufirit të lejuar (125 mg/l) për parametrin KKO, por vërehen dallime ndër vite të cilat tregojnë tendenca që meritojnë vëmendje. Skënderaj ka vlerën më të lartë në vitin 2023 (60.6 mg/l), por mungojnë të dhënat për 2024 për të vlerësuar trendin. Peja dhe Prizreni shfaqin rritje të ndjeshme në 2024 krahasuar me 2023. Gjakova, ndonëse me rritje në 2024, mbetet në nivelin më të ulët të KKO-së ndër katër qytete.

Rritja në Prizren dhe Pejë gjatë vitit 2024 sinjalizon presion në cilësinë e ujit, që mund të vijë nga shkarkime të pa trajtuara, ndotje urbane ose bujqësore.

Sa i përket impiantit në qytetin e Skënderajt, sipas rezultatetve vërehet një ndotje e lartë në 2023 ndërsa mungesa e të dhënave për 2024 lë një hapësirë në vlerësim të mëtejshëm.

Azoti total përfshin të gjitha format e azotit në ujë, përfshirë azotin organik, ammoniakun, nitratat dhe nitritet.¹³ Azoti total është një tregues i rëndësishëm për vlerësimin e eutrofikimit dhe cilësinë e ujërave.¹⁴ Sipas Direktivës së BE-së për Trajtimin e Ujërave të Ndotura Urbane (91/271/EEC, e përditësuar në 2024/3019), vlera e lejuar për azotin total në shkarkimet nga impiantet e trajtimit është 15 mg/L për impiantet që shërbejnë mbi 10.000 banorë në zona të ndjeshme.^{15,16}

¹³ **APHA, AWWA, WEF, 2017.** *Standard Methods for the Examination of Water and Wastewater*. 23rd ed. Washington, DC: American Public Health Association.

¹⁴ **Wetzel, R.G., 2001.** *Limnology: Lake and River Ecosystems*. 3rd ed. San Diego: Academic Press.

¹⁵ European Commission. "Urban Wastewater Treatment Directive 91/271/EEC." [Link](#)

¹⁶ European Environment Agency. "Urban Wastewater Treatment Directive." [Link](#)




Figura 17: Azoti total për vitin 2023 dhe 2024

Bazuar në rezultatet në figuren 17 vërejmë se impianti në Gjakovë ka pasur përqendrime mbi vlerën e lejuar në të dy vitet. Megjithëse vlera ka rënë nga 18.1 në 15.8 mg/L, ajo ende e kalon kufirin duke treguar për një situatë potencialisht të rrezikshme për cilësinë e ujit. Skenderaj dhe Peja të dy qytetet kanë vlera shumë më të ulëta se limiti i lejuar dhe nuk paraqesin shqetësim, ndërsa në Prizren nuk ka të dhëna të raportuara për vitin 2023 apo 2024, çka e bën të vështirë vlerësimin për këtë komunë.

3.3. Toka/Dheu

Kosova ka potencial optimal për zhvillimin bujqësor duke i vlerësuar kushtet meteorologjike, popullatën në të cilën jetojnë në viset rurale, resurseve ujore dhe grandët e ndara për këtë sektor.

Për vitin 2024, pjesëmarrja e sektorit të bujqësisë në Bruto Produktin Vendor (BPV) të Kosovës është rritur në rreth 9% krahasuar me 7.2% në vitin 2023¹⁷. Raporti i Odës Ekonomike të Kosovës vlerëson sektorin e bujqësisë si një nga sektorët kryesorë me pjesëmarrje në BPV në vitin 2024.

Për vitin 2024, Bruto Produkti Vendor (BPV) i Kosovës ka shënuar një rritje reale prej rreth 4.41% krahasuar me vitin 2023, ku sektori i bujqësisë, pylltarisë dhe peshkimit pati një rritje prej 2.29% në të njëjtën periudhë. Kjo rritje është një reflektim i zhvillimit ekonomik të vendit gjate këtij viti. Në tremujorin e katërt të vitit 2024, rritja reale e BPV-së ishte 4.08%, në krahasim me tremujorin e njëjtë të vitit 2023 dhe vlerësimi paraprak i rritjes së përgjithshme vjetore është 4.41% sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës.

Megjithatë, ekonomia bujqësore mbetet akoma larg zhvillimit të duhur nëse krahasohet me vendet e BE-së, me faktin se kemi akoma mungesë të infrastrukturës bujqësore dhe mjeteve financiare në krahasim me kërkesat që nevojiten për këtë sektor. Pra, bujqësia në Kosovë përballet me një sfidë sa i përket mbështetjes dhe adaptimit të teknologjive që nevojiten për të arritur standardet dhe rregullat e BE. Zhvillimi i qëndrueshëm i këtij sektori kërkon një qasje të integruar që përfshinë mbështetje financiare, edukim dhe përmirësim të infrastrukturës, ku bashkëpunimi ndërinstitutional dhe angazhimi i komunitetit janë thelbësore për suksesin.

¹⁷ Oda Ekonomike e Kosovës, Sektorët Kryesorë në Zhvillim Ekonomik të Kosovës, Një Perspektivë nga Rritja Reale e BPV

3.3.1. Përdorimi i tokës në bujqësi

Rreth 80% e sipërfaqes së tokës së Evropës përdoret për nevojat e aktiviteteve njerëzore sikurse janë zonat me ndërtesa, rrugët, infrastruktura industriale ose përdorimi për bujqësi. Mënyra se si ne përdorim tokën përbën një nga nxitësit kryesorë të degradimit të mjedisit dhe ndryshimeve klimatike.¹⁸

Sot, përdorimi i tokës ka marrë dimensione më të gjera. Andaj, menaxhimi i qëndrueshëm i tokave është bazë për zhvillimin e qëndrueshëm. Për një zhvillim të qëndrueshëm të tokave vazhdimisht duhet të monitorohen dhe vlerësohen qoftë për trendin pozitiv apo negativ të shfrytëzimit.

Indikator me rendësi për shfrytëzimin e tokave është përdorimi i tyre për nevoja bujqësore me të dhënat e fundit të publikuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës tregojnë se në vitin 2024 përdorimi i tokës për qëllime bujqësore ka përfshirë një sipërfaqe më të vogël në krahasim me vitin 2023. Konkretisht, sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore në vitin 2024 ishte 420,228.67 hektarë, ndërsa në vitin 2023 ajo ishte 420,688.21 hektarë, që përbën një rënie prej 456.3 hektarësh¹⁹.

Tabela 13. Sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore 2023- 2024 (ha)

Sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore	2023 ha	2024 ha	Ndryshimi 2023/2024 në %	Pjesëmarrja në 2024 (%)
Tokë e punueshme - ara	188,435.41	188,795.00	0.19%	44.93%
Kopshte	1,062.39	912.75	-14.07%	0.22%

¹⁸ <https://www.eea.europa.eu/en/topics/in-depth/land-use>

¹⁹ Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) rezultatet e Anketës së Ekonomive Bujqësore (AEB) për vitin 2024

Plantacione të pemëve	10,617.85	10,408.21	-1.96%	2.48%
Plantacione të vreshtave	3,432.49	3,405.54	-0.78%	0.81%
Fidanishte	160.52	172.86	7.67%	0.041%
Livadhe dhe kullosa (përfshirë tokën e përbashkët)	216,979.55	216,534.33	-0.21%	51.53%
Gjithsej sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore	420,688.21	420,228.67	-0.11%	100%

Nga gjithsej sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore në vitin 2024, pjesa më e madhe u përket livadheve dhe kullosave (përfshirë tokën e përbashkët) që ishte 216 534,33 ha (51,53%), krahasuar me vitin paraprak 2023 (që ishte 216 979,55 ha) ose 51,58%. Rënia sipërfaqes së shfrytëzuar të toka e përbashkët ishte si rezultat i rënies së numrit të blegtorisë.

Toka e punueshme - arat marrin pjesë me 44,93% dhe kopshtet me 0,22% në gjithsej sipërfaqen e shfrytëzuar të tokës bujqësore. Gjatë vitit 2024, gjithsej toka e punueshme - arat ishte 188 795.00 ha. Pjesa më e madhe ishte me: drithëra (125 274,35 ha, ose 66,4%); bimë foragjere (37 117.13 ha, ose 19,7%); perime në fushë të hapur, në serra dhe në kopshte (9 827.39 ha), prej të cilave perime në fushë të hapur dhe serra ishin 8 914,65 ha ose 4,7%; patate (3 806.07 ha ose 2,0%); bishtajore (2 929.40 ha ose 1,6%); bimë industriale (1 689.82 ha ose 0,9%); kultura të tjera (2 633.81 ha ose 1,4%) dhe tokë djerrinë ishte 6429.78 ha ose 3,4%.

Rritje e lehtë vërehet te drithërat dhe kulturat industriale, toka e punueshme - arat marrin pjesë me 44,93% dhe kopshtet me 0,22% në gjithsej sipërfaqen e shfrytëzuar të tokës bujqësore.

Gjatë vitit 2024, gjithsej toka e punueshme – arat ishte 188 795.00 ha.

Kategoritë e sipërfaqes së shfrytëzuar të tokës bujqësore që kanë shënuar ndryshime pozitive janë: toka e punueshme – ara, perimet në serra, plantacionet e pemëve dhe fidanishtet, ndërsa kategoritë që pësuan ulje janë: perimet në fushë të hapur, kopshtet, vreshtat dhe livadhet e kullosat.

Kultura më e rëndësishme është gruri me sipërfaqe 80 063,69 ha ose (63,9%), pasuar nga misri 40 647,78 ha ose (32,4 %) të sipërfaqes së tokës së punueshme me drithëra. Gjithsej sipërfaqja e perimeve në fushë të hapur, serra dhe kopshte ishte 9 827,39 ha.

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në vitin 2024, ka vazhduar të mbështes sektorin e bujqësisë përmes Programit për Zhvillim Rural dhe Programit të Pagesave Direkte. Këto programe subvencionuese kanë ndikuar në ngritjen e investimeve në bujqësi; investimeve në fermat bujqësore; investimeve në përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore dhe të peshkimit; dhe diversifikimin e fermave dhe zhvillim biznesit.

Gjatë vitit 2024, sipas raportimeve të Drejtorive Komunale të Bujqësisë dhe Ndërmarrjeve Publike të Ujitjes në Kosovë, janë ujitur gjithsej 34,070.28 hektarë tokë bujqësore. Kjo përfaqëson një rritje prej rreth 88.75% në sipërfaqen e tokës së ujitur krahasuar me vitin 2023, kur ishin ujitur afro 18,050 hektarë tokë bujqësore. Kjo rritje tregon një përmirësim domethënës në shfrytëzimin e tokës bujqësore në vend përmes ujitjes gjatë vitit 2024 krahasuar me vitin 2023. Ky përparim në sipërfaqen e tokës së ujitur është një faktor i rëndësishëm për rritjen e prodhimit dhe zhvillimin bujqësor të Kosovës.

3.3.2. Monitorimi i tokave

Monitorimi i tokave mundëson formën e shfrytëzimit të tyre, vlerësimi i ndryshimeve në tokë, ndryshimin e destinimit, degradimin, mbingarkesën e tokës nga ndotja dhe kontaminimi, siguron informacion për zhvillimin rural, modelet parashikuese, rreziqet dhe analiza e trajtimit.

Dy institucione kryesore përgjegjëse për monitorimin e tokës siç janë: MBPZHR përmes Institutit Bujqësore dhe MMPHI përmes Institutit Hidrometeorologjik, akoma nuk e kanë krijuar një sistem të monitorimit të tokave. Monitorimi i tokave është bërë vetëm sipas projekteve dhe rast për rast sipas kërkesave për vlerësim të ndikimit në mjedis.

3.3.3. Ndotja e tokave

Shëndeti i tokës është një komponent thelbësor i qëndrueshmërisë mjedisore dhe produktivitetit bujqësor. Monitorimi efektiv i tokës siguron që nivelet e ndotjes të ndiqen dhe ndërhyrjet e nevojshme të zbatohen për të mbrojtur këtë burim jetik. Në të gjithë Ballkanin Perëndimor, përpjekjet për të monitoruar tokën, veçanërisht në tokat bujqësore kanë qenë të ndryshme, duke reflektuar nivele të ndryshme të infrastrukturës dhe mbështetjes legislative.

Projekti EU4Green vazhdon të mbështesë procesin e monitorimit të tokës në Ballkanin Perëndimor dhe në mesin e tyre edhe Kosovës. Qëllimet kryesore të kësaj janë: identifikimi i ndotjes së përhapur të tokës dhe vendeve të kontaminuar, udhëzime për krijimin e një inventari dhe regjistri të këtyre vendeve, dhe përcaktimi i rehabilitimit të atyre që paraqesin një rrezik të konsiderueshëm për shëndetin e njeriut dhe mjedisin.

Vizioni përfundimtar është që deri në vitin 2050, të gjitha tokat në Ballkanin Perëndimor të jenë në 'gjendje të mirë', një qëllim që është në përputhje me Ligjin e propozuar të BE-së për monitorimin e tokës nga korriku 2023.

Kosova ende nuk e ka në zbatim sistemin gjithëpërfshirës të monitorimit të tokës. Kjo është e vetmja rrugë për identifikimin e shkallës së ndotjes së tokave, megjithatë disa operator industrial ekonomik bëjnë monitorim të ndotjes së tokave për pjesën e tokës që është në shfrytëzim nga vet ata.²⁰

Sipas referimeve të Doganës së Kosovës gjatë vitit 2024 janë importuar produkte me origjinë nga kemikatet me rreth 8,982,3598,59 kg. Edhe pse pa ndonjë vlerësim paraprak, një pjesë e këtyre preparateve kimike përdorën në bujqësi apo shkarkohen në mjedise të ndryshme.

Sipas të dhënave të fundit nga ASK për vitet 2023-2024 kemi këtë gjendje sa i përket përdorimit të plehrave mineral, plehut organik dhe pesticideve, shih tabelat 14, 15, 16²¹.

Tabela 14. Përdorimi i plehut mineral sipas grupit të kulturave bujqësore për vitet (2023-2024)

Kulturat	NPK	NAG	URE	Të tjera	Gjithsej (NPK, NAG, URE, të tjerë)
Sasia	Kg	Kg	kg	kg	kg
2023	42.600,121	9.207,643	26.561,919	2.512,598	80.882,281
2024	42 977 542	9 463 040	26 913 321	2 762 961	82 116 863

²⁰ <https://eu4green.eu/sq/advancing-soil-monitoring-in-the-western-balkans-key-achievements-and-future-steps-sq/>

²¹ Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) rezultatet e Anketës së Ekonomive Bujqësore (AEB) për vitin 2024

Tabela 15. Përdorimi i plehut organik sipas grupit të kulturave bujqësore për vitin (2023-2024)

Kulturat	Sipërfaqja e tokës së plehëruar		Sipërfaqja e tokës së plehëruar	
	Ha	Ton	Ha	Ton
Viti	2023		2024	
Gjithsej	63.94	900.201	63.970	887.240

Në këto tabela prezantohet sipërfaqja e plehëruar, sasia, përdorimi mesatar i plehrave minerale dhe plehut organik për hektar. Është me rëndësi të theksohet se sasi të janë dhënë në bruto vlera. Kjo do të thotë se nuk ka informata të drejtpërdrejta rreth përdorimit neto të substancave aktive në plehurat minerale të ndryshme. Sasia mesatare e plehut mineral e përdorur është 471 kg/ha. Ndërsa, sasia mesatare e plehut organik e përdorur është 13,9 ton /ha. Tabela 16 paraqet të dhëna për sipërfaqen e shfrytëzuar të tokës bujqësore, në të cilën janë përdorur pesticidet: (herbicide, fungicide, insekticide, pesticide të tjera: rodenticide - kundër brejtësve, akaricide - kundër merimangave, etj.)

Tabela 16. Përdorimi i Pesticideve në sipërfaqen e shfrytëzuar të tokës bujqësore 2020-2024

Viti	2020	2021	2022	2023	2024
Pesticide	Sipërfaqja (ha)				
Sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore e trajtuar me pesticide	122.090.00	122.138.02	122.501,30	122.752,16	122 570.50

Presioni i ndotjes së tokave në vendin tonë vije nga një seri tani të njohur të ndotëseve si: ndotësit bujqësore (preparatet kimike që përdoren në bujqësi); deponitë minerale dhe urbane; ujërat e ndotura urban dhe ndër urban të shkarkuar në ujërat

sipërfaqësor; transporti; mbeturinat e rrezikshme nga ndotësit industrial; degradimi fizik e sipërfaqeve tokësore, infrastruktura urbane, rrugore etj.

3.4. Menaxhimi i mbeturinave

Sot, më shumë se kurrë më parë, problemi i menaxhimit të mbeturinave në Kosovë është bërë një faktor i rëndësishëm i ndotjes mjedisore. Kjo situatë jo vetëm që kërcënon ekuilibrin ekologjik, por ka pasoja të drejtpërdrejta në cilësinë e jetës së banorëve dhe në shëndetin publik. Menaxhimi i mbeturinave në Kosovë është një nga sfidat kryesore si për nivelin qendror ashtu edhe për nivelin lokal të qeverisjes. Kur flasim për menaxhimin e mbeturinave komunale bazuar në legjislacionin në fuqi përgjegjësia bie direkt mbi komunat. Ky proces përfshin mbledhjen, transportimin dhe trajtimin e integruar të mbeturinave. Këto mbeturina prodhohen nga aktiviteti i përditshëm i qytetarëve dhe bizneseve. Menaxhimin i mbeturinave është i rregulluar me legjislacion e gjithashtu me dokumente strategjike si “Strategjia dhe Plani i Veprimit” për menaxhimin e integruar të mbeturinave në Kosovë.

Në nivel lokal, të gjitha komunat në Kosovë janë të pajisura me plane komunale pesëvjeçare për menaxhimin e mbeturinave, si dhe me rregullore të brendshme për këtë fushë. Këto dokumente planifikuese përmbajnë një gamë të gjerë objektivash dhe aktivitetsesh që synojnë të përmirësojnë menaxhimin e mbeturinave dhe të zbatohen në terren. Megjithatë, pavarësisht nga ky angazhim dhe përpjekje, Kosova vazhdon të përballet me sfida të ndryshme dhe vështirësi në menaxhimin e mbeturinave, të cilat pengojnë arritjen e rezultateve të pritshme sipas planeve dhe standardeve të përcaktuara.

Bazuar në rezultatet e raportuara në vazhdimësi dhe mbi bazën e të gjeturave, AMMK vlerëson se ka një përmirësim të gjendjes së menaxhimit të mbeturinave, pothuajse në të gjitha komunat.

Shqetësim ka vetëm për komunat veriore të cilat nuk shprehin gatishmëri për bashkëpunim dhe rregullim të kësaj situatë.

Bazuar në të dhënat e raportimeve nga komunat në sistem online dhe monitorimet në terren, vërehet një rritje e numrit të deponive të vogla, ndërsa deponitë e mëdha dhe të mesme janë zvogëluar në nivelin rajonal të vendit duke treguar një progres të matshëm drejt një menaxhimi më të përqendruar dhe të kontrolluar të mbeturinave. Në disa komuna, grumbullimi total i mbeturinave ka pasur rënie, por gjenerimi i mbeturinave për banor është rritur – kjo tregon se numri i banorëve të rinj (nga regjistrimi në vitin 2024) është më i ulët se vlerësimi i mëparshëm, çka mund të shpjegohet me migrime të brendshme ose përmirësime në regjistrim. Në shumicën e komunave, është vërejtur një rritje e përgjithshme e gjenerimit të mbeturinave për banor, gjë që sugjeron një rritje të konsumit ose përmirësim të sistemit të raportimit dhe grumbullimit. Në disa komuna, grumbullimi total ka rënë, por gjenerimi për banor është rritur – që tregon se numri i banorëve të rinj (nga regjistrimi me i fundit) është më i ulët se vlerësimi i mëparshëm.

Nga niveli qendror ka iniciativa për zbatim e projekteve të parapara me strategji dhe plan të veprimit, siç janë studimet e fizibilitetit për deponitë sanitare, përveç kësaj, është në fazën fillestare zbatimi i sistemit të rikthimit të depozitave për shishet dhe kanaçet, me synimin për të nxitur riciklimin dhe reduktimin e mbeturinave plastike. Ky hap na bën optimistë për arritjen e këtij objekti dhe për përparimin e ekonomisë qarkore në Kosovë, duke ndikuar pozitivisht në mjedis dhe në menaxhimin e mbeturinave. Sipas të dhënave zyrtare nga Dogana e Kosovës është vërejtur një rënie të importimit dhe eksportit të qeseve dhe thasëve plastike, e cila mund të lidhet drejtpërdrejtë me zbatimin e Udhëzimit Administrativ nr. 04/2025 për Ambalazhin dhe Mbeturinat e Ambalazhit, si dhe me vendimin për tarifën e qeseve plastike.²²

²² *Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, (2025).*

Shumë biznese kanë zbatuar me përpikëri këtë masë parandaluese, ndërsa qytetarët kanë treguar një vetëdije të rritur në përdorimin e qeseve të biodegradueshme.

Mbështetja e vazhdueshme nga donatorët ndërkombëtarë ka luajtur një rol kyç në përparimin e menaxhimit të mbeturinave në Kosovë. Këta donatorë kanë kontribuar jo vetëm në fuqizimin e kapaciteteve njerëzore të AMMK-së, por edhe në financimin e investimeve direkte në pajisje teknike, softuer dhe infrastrukturë, si dhe në mbështetjen e projekteve dhe aktiviteteve të tjera në këtë sektor. Kjo mbështetje ka mundësuar përmirësime të dukshme në menaxhimin e mbeturinave dhe ka kontribuar në afrimin e Kosovës ndaj standardeve europiane në këtë fushë.

AMMK këshillon që të gjithë akterët përgjegjës për menaxhimin e mbeturinave komunale të nisin dhe të përkrahin iniciativat që promovojnë menaxhimin e integruar të mbeturinave, duke u fokusuar kryesisht në zbatimin e modelit 3R (reduktimi i gjenerimit të mbeturinave, ripërdorimi dhe riciklimi). Ky model është i njohur si një nga mënyrat më efektive për të arritur qëndrueshmëri në trajtimin e mbeturinave, duke sjellë përfitime jo vetëm mjedisore, por edhe ekonomike dhe sociale.

Një sugjerim tjetër është që shkollat në të gjithë Kosovën të marrin pjesë aktivisht në iniciativat për riciklimin, duke shkruar propozime projektesh që synojnë rritjen e vetëdijes së nxënësve për rëndësinë e ndarjes dhe riciklimit të mbeturinave. Përveç kësaj, përmes mbështetjes së donatorëve dhe projekteve, duhet të sigurohet infrastruktura e nevojshme për ndarjen e mbeturinave në shkolla, duke lehtësuar kështu edukimin praktik dhe kontributin e brezit të ri në mbrojtjen e mjedisit.

Një spektër tjetër i mbeturinave për të cilat ende nuk është zhvilluar menaxhim i përshtatshëm përfshin mbeturinat e rrezikshme, një pjesë të mbeturinave spitalore, mbeturinat shtazore, mbeturinat nga ndërtimi dhe demolimi, gomat e përdorura, vajrat e përdorura, etj. Gjendja e menaxhimit të

këtyre llojeve të mbeturinave vazhdon të paraqes sfida të konsiderueshme për mirëqenien e mjedisit dhe shëndetin publik.

Për të përmirësuar këtë situatë, është e domosdoshme të kryhen analiza dhe hulumtime të thelluara, duke ofruar një pasqyrë më të qartë të gjendjes aktuale. Po ashtu, është e nevojshme të bëhen investime specifike në teknologji dhe infrastrukturë, në mënyrë që menaxhimi i këtyre mbeturinave të futet nën kontroll të plotë. Vetëm në këtë mënyrë mund të përmirësohet gjendja e tyre dhe të eliminohet ndikimi negativ që ato kanë në shëndetin e njeriut dhe mjedis.

Bazuar në monitorimet e rregullta të Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK), vlerësohet se deponitë sanitare në Kosovë përballen me një sërë problemesh operacionale dhe mjedisore që kërkojnë vëmendje urgjente. Gjendja aktuale e këtyre deponive është jashtëzakonisht larg standardeve evropiane për menaxhimin e mbeturinave. Ndër problemet më të rëndësishme përmenden mungesa e sistemit të trajtimit të ujërave të zeza, ventilimi i pamjaftueshëm i gazrave, mbulimi jo i përditshëm i mbeturinave, mungesa e sistemit të ndarjes së tyre, si dhe mungesa e rrethimit dhe shenjave të rrezikshmërisë. Në hapësirat e deponive vërehen gjithashtu prezenca e qenve endacakë, insekteve dhe personave të paautorizuar.

Këto kushte jo vetëm që rrezikojnë shëndetin e banorëve dhe të punonjësve, por ndikojnë negativisht edhe në cilësinë e mjedisit. Prandaj, është e domosdoshme të merren masa të menjëhershme për përmirësimin e menaxhimit të deponive, në mënyrë që të sigurohet mbrojtja e shëndetit publik dhe mjedisit, duke u përpjekur të afrohen standardet evropiane të menaxhimit të mbeturinave.

Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës gjatë vitit 2024 ka identifikuar se 8 komuna në Kosovë nuk kanë raportuar fare të dhënat e tyre për menaxhimin e mbeturinave. Kjo situatë bën që sistemi aktual i menaxhimit të mbeturinave në Kosovë të mos

ofrojë të dhëna të plota për gjenerimin, mbledhjen, trajtimin, eliminimin e mbeturinave, si dhe për numrin e deponive ilegale, duke paraqitur një sfidë të rëndësishme për vlerësimin e gjendjes reale në këtë sektor.

Prandaj, AMMK sugjeron që akterët përgjegjës për menaxhimin e mbeturinave të ndërtojnë sisteme të avancuara të mbajtjes së të dhënave dhe të raportojnë në mënyrë të rregullt mbi gjendjen e menaxhimit të mbeturinave.

Po ashtu, është e domosdoshme të investohet në ngritjen e kapaciteteve njerëzore të komunave, pasi mungesa e zyrtarëve të përkushtuar specifikisht për mbeturinat shkakton vështirësi në mbledhjen e të dhënave dhe raportimin e tyre të rregullt.


Raportimi i rregullt dhe i verifikuar mbi menaxhimin e mbeturinave është rruga më e sigurtë për të njohur dhe vlerësuar me saktësi gjendjen në këtë sektor. Vetëm në bazë të gjetjeve të sakta mund të ndërmerren masa dhe veprime konkrete për përmirësimin e gjendjes në sektorin e menaxhimit të mbeturinave, duke intervenuar aty ku ka nevojë, në mënyrë që së bashku të kontribuojmë për një mjedis më të pastër dhe pa mbeturina.

Europa ende gjeneron një sasi të madhe mbeturinash, megjithëse trendet në gjenerimin e mbeturinave janë mjaftë të qëndrueshme dhe tendenca është që gjenerimi i mbeturinave të shkëputet nga zhvillimi ekonomik. Në të njëjtën kohë, mbeturinat perceptohen gjithnjë e më shumë si një burim i vlefshëm për ekonominë evropiane. Pjesa e mbeturinave që riciklohet po rritet ngadalë, ndërsa sasia e mbeturinave që shkojnë në deponi po zvogëlohet. Dallimet në performancë midis vendeve janë, megjithatë, ende të larta.²³

Edhe pse në vendet perëndimore mbeturinat shihen si resurse, në Kosovë edhe sot ato vazhdojnë të perceptohen si hedhurina

²³ *European Environment Agency, (Resource efficiency and waste),*

dhe burim ndotjeje.²⁴ Mbeturinat e ndërtimit dhe plastika janë shembuj të mirë të mbeturinave që shihen si resurs në botën moderne, me aplikime të ndryshme në ndërtim, industri dhe bujqësi, duke kontribuar në ekonomi qarkore dhe qëndrueshmëri mjedisore.²⁵ Parandalimi i mbeturinave dhe menaxhimi i mbeturinave tani është një aspekt kyç i ekonomisë qarkore. Mbeturinat ushqimore dhe bimore (mbeturinat organike) mund të përdoren për prodhimin e kompostit, i cili përmirëson cilësinë e tokës dhe zvogëlon nevojën për përdorimin e plehrave kimike.



Harta 3: Deponitë regionale, komunale dhe stacionet e transferit²⁵

²⁴ European Environment Agency, (2019)

3.4.1. Gjenerimi i mbeturinave komunale

Gjenerimi i mbeturinave komunale ka shënuar një rritje të vazhdueshme në dekadat e fundit si pasojë e rritjes së popullsisë urbane, zhvillimit ekonomik dhe modeleve të konsumit. Sipas të dhënave të Eurostat, në nivel të Bashkimit Evropian, sasia mesatare e mbeturinave komunale të gjeneruara për banor është rritur gradualisht, duke reflektuar ndikimin e jetesës urbane dhe industrializimit.²⁶

Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK) realizon mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave për sasinë e mbeturinave komunale të gjeneruara në nivel vendi, në bashkëpunim me komunat përkatëse. Të dhënat mblidhen përmes raportimit zyrtar të komunave drejt AMMK-së, duke mundësuar një pasqyrë të qartë të gjendjes së menaxhimit të mbeturinave komunale në secilën njësi administrative.

Pavarësisht se raportimi nga komunat nuk ka qenë i plotë dhe disa prej tyre nuk kanë dorëzuar fare të dhëna për periudhën përkatëse raportuese, Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK) ka kryer një vlerësim të kujdesshëm të të dhënave të pranuar. Ky vlerësim ka për qëllim ofrimin e një pasqyre sa më të qëndrueshme dhe të afërt me realitetin mbi sasinë e mbeturinave komunale të gjeneruara në nivel vendi.

Në tabelën 17 janë paraqitur të dhënat për sasinë e mbeturinave komunale të gjeneruara në nivel komunal për vitet 2023 dhe 2024.

²⁶ Eurostat. (2023). *Municipal waste statistics*. Retrieved from: <https://ec.europa.eu/eurostat>.

Tabela 17. Gjenerimi i mbeturinave komunale kg\banor\vit (2023 & 2024)

Komuna ²⁷	Grumbullimi i mbeturinave ton/vit	²⁸ Gjenerimi kg/banorë/vit	Grumbullimi i mbeturinave ton/vit	²⁹ Gjenerimi kg/banorë/vit
	2023	2023	2024	2024
Prishtinë	89,840.00	243.94	81,797.00	291.28
Drenas	10,685.00	220.86	9,125.00	254.82
Fushë-Kosovë	18,913	236.88	20,438.00	317.31
Graçanicë	5,022.00	318.32	8,216.00	412.59
Lipjan	13,213.00	251.08	13,216.00	392.83
Obiliq	7,217.00	382.93	7,026.00	436.28
Podujevë	16,106.00	293.95	0.00	0.00
Mitrovicë	25,924.00	291.91	25,729.00	464.28
Skënderaj	8,683.00	203.22	8,268.00	256.21
Vushtri	20,593.00	293.27	17,170.93	325.83
Mitrovica V.	0.00	0.00	0.00	0.00
Zveçan	0.00	0.00	0.00	0.00
Zubin-Potok	0.00	0.00	0.00	0.00
Leposaviq	0.00	0.00	0.00	0.00
Pejë ³⁰	33,077.00	327.78	33,854.00	389.25
Istog	11,569.00	240.60	7,256.00	181.78
Klinë	7,738.00	171.81	6,431.00	184.63
Prizren	49,166.00	243.02	52,072.00	342.98
Suharekë	13,484.00	174.12	11,354.00	209.97
Malishevë	9,968.00	155.12	10,100.00	230.05
Rahovec	14,051.00	190.99	14,065.00	290.27
Dragash	7,479.00	236.75	6,210.00	247.82
Mamushë	1,200.00	252.22	0.00	0.00

²⁷ Disa komuna nuk kanë raportuar në AMMK (Mitrovica V. Zveçan, Zubin-Potok, Leposaviq, Mamushë, Partesh, Klllokot dhe Ranillug) dhe rrjedhimisht nuk janë pasqyruar të dhënat në tabelë.

²⁸ Të dhënat e prezantuara në këtë tabelë i referohen sasisë së mbeturinave të grumbulluara për vitin raportues 2024 për komuna në platformën online.

²⁹ Gjatë vitit 2024 janë publikuar të dhënat preliminare të regjistrimit të popullsisë në Kosovë, të cilat mund të kenë ndikuar në përllogaritjen e treguesve për vitin 2024. Si pasojë, dallimet ndërmjet vitit 2023 dhe 2024 mund të jenë të theksuara, veçanërisht për shkak të ndryshimeve në bazën e popullsisë së përdorur për llogaritje.

³⁰ Nga të dhënat e raportuara për komunën e Pejës, është realizuar zbritja e vlerës së përgjithshme të grumbullimit, pasi të dhënat përfshijnë gjithashtu kontributet nga komunat e Deçanit, Klinës dhe Istogut. Kjo është bërë meqë raportimi është bërë në mënyrë të përbashkët për këto katër komuna.

Ferizaj	24,427.00	195.48	35,138.00	341.26
Kaçanik	4,770.00	124.9	6,123.00	208.14
Shtime	4,691.00	204.19	4,422.00	241.06
Hani i Elezit	2,016.00	208.93	1,173.00	178.99
Shtërpca	1,720.00	133.66	2,880.00	291.40
Gjilan	25,557.00	374.41	26,425.00	483.82
Kamenicë	5,061.00	181.69	5,544.00	280.58
Viti	6,451.00	252.37	7,241.00	385.25
Novoberdë	1,076.00	393.05	1,893.00	279.98
Partesh	0.00	0.00	0.00	0.00
Kllokot	0.00	0.00	0.00	0.00
Ranillug	0.00	0.00	0.00	0.00
Gjakovë	22,544.00	237.97	20,267.00	189.42
Deçan	7,211.00	137.21	5,474.00	147.51
Junik	938.00	120.28	800.00	185.29
Nivel vendi	470,390.00	235.25	449,707.93	293.60

Raportet e menaxhimit të mbeturinave komunale në Kosovë për vitet 2023 dhe 2024 tregojnë ndryshime të konsiderueshme në sasinë e mbeturinave të grumbulluara dhe të gjeneruara për banor në disa komuna.

Bazuar në të dhënat e paraqitura në tabelën 18, vërehet se grumbullimi total i mbeturinave ka rënë nga 470,390 ton në vitin 2023 në 449,707.93 ton në 2024 (ulje prej 20,682 ton) ndërsa gjenerimi mesatar për banor është rritur ndjeshëm nga 235.25 kg/banor/vit në 293.60 kg/banor/vit.

Duhet të theksohet se për vitin 2023 vlerësimi i gjenerimit të mbeturinave për banor është bërë duke përdorur numrin e popullsisë sipas regjistrimit të vitit 2011 ndërsa për vitin 2024 është përdorur regjistrimi i ri i popullsisë, i cili reflekton ndryshimet demografike më të fundit dhe pritjet të jetë më i saktë.

Popullsia e Kosovës në vitin 2024 vlerësohet të jetë rreth 1.6 deri në 1.7 milionë banorë³¹. Kjo do të thotë që nuk ka pasur rritje të madhe, përkundrazi, në disa raste vlerësohet edhe rënie, për shkak të emigrimit të lartë dhe normave të ulëta të lindshmërisë, migrimin e brendshëm drejt zonave urbane ose mungesën e mundësive ekonomike. Rritjet janë të përqendruara kryesisht në zonat afër Prishtinës ndërsa rënit ndodhin në pjesët perëndimore, veriore dhe rurale të Kosovës – reflektim i drejtpërdrejtë i migrimit ekonomik.

Popullsia është në rënie në shumë komuna, ndërsa numri i ekonomive familjare po shënon një rritje të vazhdueshme. Në raportimin e vitit 2024, përveç të dhënave për popullsinë, në përllogaritjen e sasisë së mbeturinave të gjeneruara janë përfshirë edhe mbeturinat që burojnë nga aktivitetet ekonomike dhe komerciale, përmes bizneseve të shërbyera në territorin e komunave. Kjo nënkupton se totali i mbeturinave të grumbulluara nuk pasqyron vetëm mbeturinat shtëpiake të krijuara nga banorët, por edhe ato nga sektori ekonomik.

Sipas të dhënave të fundit të publikuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), numri i ekonomive familjare është rritur nga rreth 299 mijë në afërsisht 348 mijë.³² Kjo rritje është veçanërisht e theksuar në Komunën e Prishtinës, ku ekonomitë familjare janë rritur nga 40 mijë në 72 mijë. Edhe pse një numër më i madh i ekonomive familjare mund të ndikojë në rritjen e përgjithshme të mbeturinave të krijuara, kjo mund të balancohet me një ulje të sasisë së mbeturinave për kokë banori.

Në shumicën e komunave, vlera e gjenerimit të mbeturinave në kg për banor është rritur ndjeshëm në vitin 2024 krahasuar me 2023. Rritja e ndjeshme e gjenerimit për banor në shumë komuna mund të jetë rezultat i ndryshimeve në popullsi të raportuar, ose rritje të vërtetë të konsumit dhe prodhimit të mbeturinave.

³¹ Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) Raporti mbi Regjistrimin e Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave në Kosovë, 2024

³² Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) Raporti mbi Regjistrimin e Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave në Kosovë, 2024

Faktorë si rritja ekonomike, migrimi dhe urbanizimi kanë çuar në një rritje të konsumit dhe, rrjedhimisht, në një sasi më të madhe të mbeturinave të prodhuara.

Në disa komuna, si Prishtina, Drenasi, dhe Podujeva, Istogu, Klina, Gjakova, Deçani, Juniku shihet një ulje e grumbullimit total të mbeturinave në vitin 2024, ndonëse gjenerimi për banor është rritur. Kjo mund të jetë për shkak të ndryshimeve në popullsi sipas regjistrimit të ri ose efikasitetit të grumbullimit.

Në komunën e Prishtinës grumbullimi total i mbeturinave ka rënë nga 89,840 ton në 81,797 ton, por gjenerimi në kg/banor është rritur nga 243.94 në 291.28, duke reflektuar popullsinë më të ulët sipas regjistrimit të ri mirëpo ka numër më të madh të ekonomive të shërbyera dhe përfshirjen e bizneseve. Në Drenas, gjithashtu ka rënie të mbeturinave dhe popullsisë.

Klinë, Deçan, Junik – kanë rënie të grumbullimit, edhe pse numri i ekonomive familjare është rritur, që tregon ndryshim në praktikat e mbledhjes apo raportimit.

Në komunën e Graçanicës kemi rritje të ndjeshme në grumbullim nga 5,022 në 8,216-ton dhe në kg/banor nga 318.32 në 412.59, që tregon ndikimin e bizneseve të shërbyera, në Ferizaj nga 24,427-ton në 35,138 ton, shoqëruar edhe me rritje të ekonomive familjare.

Komunat veriore (Mitrovica V., Zveçan, Zubin Potok, Leposaviq), Partesh, Klllokot, Ranillug kanë të njëjtën situatë në të dy vitet – nuk figuron ndonjë grumbullim mbeturinash për asnjërën periudhë. Mungesa e të dhënave mund të jetë rezultat i sfidave në mbledhjen e të dhënave ose mungesës së kapaciteteve profesionale për raportim.

Ndër kontribuesit më të mëdhenj të mbeturinave në Kosovë gjatë dy viteve të fundit janë komunat e mëdha si Prishtina, Ferizaj, Peja, Prizreni, Gjiçani, Gjakova dhe Fushë Kosova. Kjo

lidhet drejtpërdrejt me madhësinë e popullsisë dhe nivelin e urbanizimit në këto zona.

Edhe pse raportimi nga komunat nuk ka qenë i plotë, kjo ka ndikuar që të dhënat e prezantuara të mos ofrojnë një përfaqësim të plotë të grumbullimit dhe gjenerimit të mbeturinave komunale në nivel vendi. Megjithatë, Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK) ka bërë përpjekje për të vlerësuar situatën aktuale në Kosovë mbi bazën e të dhënave ekzistuese, me qëllim të sigurimit të një pasqyre sa më të afërt me realitetin.

3.4.2 Analiza e përbërjes së mbeturinave komunale

Kompozicioni i mbeturinave komunale i referohet shpërndarjes sasiore dhe përqindjes së materialeve të ndryshme që përbëjnë mbeturinat e gjeneruara në një zonë të caktuar, si p.sh. mbeturina organike, plastike, letër/karton, qelq, metale, tekstil etj.

Hulumtimi dhe analiza e përbërjes së mbeturinave komunale në Kosovë është mundësuar për herë të parë nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, në kuadër të projektit "Shërbime të Qëndrueshme Komunale – SMS" dhe është zbatuar nga Environmental Sustainable Solution (ESS L.L.C.), në bashkëpunim me drejtoritë përkatëse të Shërbimeve Publike të komunave dhe gjashtë kompanitë regjionale të mbledhjes dhe transportit të mbeturinave komunale. Ky bashkëpunim shumëpalësh ka mundësuar grumbullimin e të dhënave të besueshme dhe ndërtimin e bazave për përmirësimin afatgjatë të sistemit të menaxhimit të mbeturinave në vend. Procesi i grumbullimit të mbeturinave është realizuar nga operatorët rajonalë të shërbimeve komunale të mbeturinave (KRM), të cilët veprojnë në shtatë regjionet e Kosovës. Konkretisht, në këtë proces kanë marrë pjesë operatorët: KRM "Pastrimi, Çabрати, Uniteti, Ambienti, Ecohigjiena, Pastërtia dhe Eko Regjioni".

Të dhënat e grumbulluara janë raportuar nga komunat përkatëse përmes platformës online të Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK). Tabela 18, paraqet përbërjen mesatare të mbeturinave komunale për vitin 2024, e cila është rezultat i analizës së të dhënave të mbledhura në tri faza të veçanta të monitorimit.

Në përfundim, është realizuar një vlerësim i përgjithshëm për secilën kategori të mbeturinave, duke ofruar një pasqyrë të qartë dhe gjithëpërfshirëse mbi strukturën e mbetjeve të gjeneruara në nivel komunal në Kosovë.

Mbeturinat organike përbëjnë përqindjen më të lartë në total, me një mesatare prej 30.4%, duke qenë prezentë në mënyrë të qëndrueshme në të gjitha fazat. Kjo nënvizon potencialin e lartë për zbatim të metodave të kompostimit dhe menaxhimit të mbeturinave organike.

Plastika përbën kategorinë e dytë më të përfaqësuar me **19.6%**, duke treguar një tendencë në rritje nga Faza I në Faza III. Pas saj vjen **letra dhe kartoni**, me **15.1%**, megjithëse me një tendencë të lehtë në rënie gjatë fazave të analizës.

Ndër kategoritë tjera me përqindje të konsiderueshme janë:

- Mbeturina të imëta (6.9%) – me një ulje të dukshme nga Faza I në Faza III, që mund të reflektojë përmirësim në procesin e selektimit apo ndikime sezonale,
- Qelqi (5.5%) dhe tekstili (4.8%) – tregojnë prezencë të qëndrueshme në të gjitha fazat,
- Pampersat përbëjnë 4.0% të totalit, duke paraqitur një sfidë të veçantë për menaxhimin për shkak të natyrës jo të riciklueshme të tyre,
- Materialet si tetrapaku (2.6%), MKD – materiale të kombinuara dhe të përziera (3.1%), metalet (1.8%) dhe druri

(1.5%) paraqiten me përqindje më të ulëta, por të rëndësishme për sektorin e riciklimit dhe për planifikimin strategjik të trajtimit të mbeturinave,

- Mbeturinat e rrezikshme, megjithëse me prezencë minimale (0.2%), kërkojnë trajtim dhe mbikëqyrje të veçantë për shkak të ndikimit potencial në shëndetin publik dhe mjedis.

Tabela 18. Përbërja e mbeturinave³³

Përbërja e mbeturinave	Faza I	Faza II	Faza III	Totali
Mbeturina organike	29.2%	32.9%	29.3%	30.4%
Mbeturina të gjelbëra	5.0%	4.4%	4.2%	4.5%
Tetrapak	2.1%	2.5%	3.2%	2.6%
Plastikë	18.7%	19.7%	20.3%	19.6%
Letër / karton	16.3%	15.4%	13.6%	15.1%
Tekstil	4.9%	4.4%	5.0%	4.8%
Metale	1.3%	1.5%	2.7%	1.8%
Qelq	4.5%	5.8%	6.2%	5.5%
Dru	0.9%	1.0%	2.5%	1.5%
MKD	2.0%	2.9%	4.3%	3.1%
Mbeturina të rrezikshme	0.2%	0.2%	0.3%	0.2%
Pampersa	4.6%	3.5%	3.7%	4.0%
Mbeturina të imëta	10.3%	5.7%	4.7%	6.9%

Aktualisht, mbeturinat e gjeneruara në këto regjione deponohen kryesisht në deponi të kontrolluara, të cilat përfshijnë si ato regjionale ashtu edhe ato komunale. Ky fakt tregon për një shkallë të lartë të organizimit dhe funksionalizimit të sistemit të menaxhimit të mbeturinave në vend, por gjithashtu nënvizon nevojën për avancim të mëtejshëm në drejtim të ndarjes në burim dhe riciklimit.

³³ Raporti i analizës së përbërjes së mbeturinave në 7 regjionet e Kosovës, ESS L.L.C, 2022




Figura 18: Përbërja e mbeturinave në Kosovë

Të dhënat tregojnë për nevojën e përforcimit të sistemit të ndarjes në burim dhe rritjes së ndërgjegjësimit qytetar. Mbeturinat organike dhe ato plastike mbeten sfidat kryesore, ndërsa trendet si rritja e mbetjeve të përziera dhe metaleve, nënvizojnë mungesën e selektimit efektiv.

Këto të dhëna nga terreni janë shumë të vlefshme për planifikimin e strategjive të riciklimit dhe menaxhimit të qëndrueshëm të mbeturinave në nivel komunal dhe kombëtar.

3.4.3. Deponimi i mbeturinave komunale në deponi sanitare

Deponitë e mbeturinave komunale sipas standardeve evropiane janë të rregulluara me kërkesa strikte për kufizimin e sasisë së

mbeturinave të depozituara, trajtimin paraprak, monitorimin, sigurinë dhe mbrojtjen e mjedisit. Sipas direktivës së Bashkimit Evropian mbi depozitimin e mbeturinave, deri në vitin 2035, sasia e mbeturinave komunale të depozituara në deponi nuk duhet të kalojë 10% të sasisë totale të këtyre mbeturinave. Kjo synon të reduktoj ndikimin negativ në mjedis dhe të nxisë riciklimin dhe rikuperimin e mbeturinave.³⁴

Për më tepër, nga viti 2030, nuk lejohet depozitimi i mbeturinave që janë të përshtatshme për riciklim ose për rikuperim energjik, me përjashtime të kufizuara vetëm për rastet kur depozitimi sjell rezultatin më të mirë mjedisor.³⁵ Këto masa janë krijuar për të përmbushur objektivat e hierarkisë së mbeturinave, ku depozitimi është alternativa e fundit.

Ndërsa, deponitë duhet të jenë të pajisura me sisteme monitorimi të ujërave nëntokësore dhe të respektojnë kërkesat e sigurisë për punëtorët, shtetet anëtare dhe ato të cilat pretendojnë të bëhen anëtarë se shpejti, duhet të zbatojnë strategji kombëtare për uljen e depozitimit të mbeturinave të biodegradueshme dhe të përshtatshme për riciklim.³⁶

Vetëm mbeturinat që janë trajtuar paraprakisht mund të depozitohen në deponi, dhe deponitë janë të detyruara të përdorin instrumente ekonomike për të nxitur përmbushjen e kërkesave mjedisore.³⁷

³⁴ **European Parliament.** 2018. Directive (EU) 2018/850 of the European Parliament and of the Council of 30 May 2018 amending Directive 1999/31/EC on the landfill of waste. Official Journal of the European Union, L 150, 14.6.2018, pp. 100–108.

³⁵ **European Commission.** 2020. *Waste Framework Directive: Landfill Directive.* Available at: https://ec.europa.eu/environment/topics/waste-and-recycling/waste-framework-directive_en.

³⁶ **European Environment Agency.** 2019. *Landfilling of waste in Europe.* Available at: <https://www.eea.europa.eu/publications/landfill-of-waste-in-europe>.

³⁷ **European Parliament.** 2018. Directive (EU) 2018/850 of the European Parliament and of the Council of 30 May 2018 amending Directive 1999/31/EC on the landfill of waste. Official Journal of the European Union, L 150, 14.6.2018, pp. 100–108.

Mbeturinat komunale të cilat gjenerohen nga popullata në Kosovë, grumbullohen nga operatorët e mbledhjes dhe të transportit të mbetjeve dhe deponohen rregullisht në shtatë deponitë ekzistuese në: Prishtinë (Mirash), Prizren (Landovicë), Mitovicë (Gërmovë), Pejë (Sferk), Gjilan (Velekincë), dhe Dragash (Sharr). Nga këto deponi, pesë janë të nivelit regional, ndërsa dy të tjera janë komunale.

Kushtet mjedisore të deponive sanitare në Kosovë janë kritike dhe jashtëzakonisht të varfëra në krahasim me standardet evropiane të menaxhimit të mbeturinave. Këto deponi, edhe pse janë në menaxhim dhe mbikëqyrje të vazhdueshme, pothuajse asnjëra nuk i plotëson standardet evropiane.

Në vijim, paraqitet një përshkrim i detajuar i kushteve mjedisore dhe problematikave që hasen në këto deponi, bazuar në të dhënat dhe vëzhgimet në terren të AMMK-së. Vërshimi i deponive nga përzierja e ujërave të shiut dhe ujërave nëntokësore është problem kryesor. Sistemi i riqarkullimit të kullimit dhe drenazhi sipërfaqësor nuk funksionojnë siç duhet, duke përkeqësuar gjendjen mjedisore, mungon sistemi i trajtimit të ujërave të zeza, gjë që rrit rrezikun e ndotjes së mjedisit dhe të burimeve të ujit, deponitë janë pjesërisht të rrethuara dhe nuk kanë sisteme të përshtatshme ventilimi për gazrat që krijohen gjatë procesit të deponimit, ka një rritje të nivelit të gazrave të dëmshëm, të cilat mund të ndikojnë në sigurinë dhe shëndetin e punonjësve dhe të komunitetit përreth, ka një prezencë të konsiderueshme të qenve endacak, shpezëve dhe insekteve në dhe rreth deponive, të cilat ndikojnë në përhapjen e infeksioneve dhe ndotjen mjedisore, zjarret vetëndezëse shpesh shpërthejnë në deponi, duke krijuar tym të dendur që ndot ajrin dhe rrezikon shëndetin e popullsisë përreth, mbeturinat shpërndahen larg për shkak të mungesës së mbulimit të përditshëm, gjë që rrit erën e keqe dhe ndotjen ajrore, mungon sistemi i degazifikimit të duhur, deponitë nuk kanë rrethim të duhur (brez i gjelbër) dhe mungojnë shenjat e rrezikshmërisë në

afërsi të zonës, gjë që rrit rrezikun e kontaminimit nga bashkimi i mbeturinave të llojeve të ndryshme.

Afërsisht mbi 90% e mbeturinave të gjeneruara në Kosovë deponohen në këto deponi, ndërsa pjesa tjetër përfundojnë në deponi ilegale. Një pjesë e vogël mblidhet dhe shfrytëzohet nga sektori jo formal për qëllime tregtimi.

Vlerësimi i të dhënave nga raportimi

Gjatë vitit 2024, sasi të mbeturinave të depozituara në deponitë sanitare në Kosovë kanë pasur ndryshime, duke pësuar rënie në disa rajone dhe rritje në të tjera. Gjendja e mbeturinave në të shtatë deponitë sanitare kryesore të vendit, duke treguar dinamikën dhe ndikimet e ndryshme rajonale është paraqitur grafikisht në (figurën 1). Grafikoni tregon qartë se menaxhimi i mbeturinave është një sfidë më e madhe për Prishtinën dhe Prizrenin, ndërsa rajonet më të vogla kanë nevoja më të kufizuara.

Në vitin 2024 sasia më e madhe e mbeturinave është deponuar në deponinë sanitare në Mirash (Prishtinë) 193,698.74 ton (figura 19). Kjo tregon se Prishtina, si kryeqytet dhe qendër më e madhe urbane, gjeneron më shumë mbeturina se çdo rajon tjetër.

Prizren renditet e dyta për nga sasia e mbeturinave me 101,770.28-ton mbeturina, është një nga qytetet më të mëdha dhe më të populluara, prandaj edhe shifrat janë të larta.

Rajonet si Peja, Gjilani dhe Mitrovica kanë një nivel të qëndrueshëm të mbeturinave, që tregon për një menaxhim të ngjashëm të mbeturinave komunale dhe reflekton me madhësinë dhe aktivitetin urban të tyre.

Sasinë më të vogël të mbeturinave të deponuara e kanë Podujeva me 18,103.20-ton dhe Dragashi me 10,504.00 ton, kjo tregon se këto dy rajone kanë popullsinë më të vogël dhe aktivitetin ekonomik më të ulët.




Figura 19: Sasia totale e mbeturinave komunale në deponit sanitare në Kosovë për vitin 2024




Figura 20: Deponimi i mbeturinave komunale në deponitë sanitare në Kosovë, 2018 – 2024

Për dallim nga viti 2023, kur sasia totale e mbeturinave të depozituara në deponitë sanitare ishte 493,117.40 tonë, në vitin 2024 kjo sasi është ulur në 469,111.50 tonë. Kjo përbën një ulje prej 24,005.90 tonësh, ose afërsisht 4.9%. Ky trend pozitiv tregon përpjekje dhe rezultate në drejtim të reduktimit të mbeturinave në deponitë sanitare.




Figura 21: Trendi i deponimit të mbeturinave 2018 – 2024

Trendi tregon se, edhe pse disa deponi kanë pasur rritje të lehtë (Prishtinë, Pejë, Podujevë dhe Dragash), disa deponi të tjera kanë pasur ulje të ndjeshme (Prizren, Mitrovicë, Gjilan), duke rezultuar në një ulje të përgjithshme të mbeturinave të deponuara në nivel vendi për vitin 2024. Kjo mund të jetë rezultat i masave për menaxhimin më të mirë të mbeturinave, faktorëve socio-ekonomikë, politikave dhe përpjekjeve të reja të implementuara në drejtim të reduktimit të prodhimit të mbeturinave dhe përmirësimit të menaxhimit të tyre, në përputhje me strategjinë kombëtare për menaxhimin e integruar të mbeturinave dhe planeve lokale.

Në deponitë sanitare të menaxhuara nga KDMK – siç janë Mirashi (Prishtinë), Velekincë (Gjilan) dhe Landovicë (Prizren) – deponimi i mbeturinave në vitin 2024 ka shënuar ndryshime të dukshme në sasi. Në deponinë e Mirashit (Prishtinë), ka pasur një rritje të lehtë prej 2,054.00-ton, duke shkuar nga 191,644.74 ton në 193,698.74 ton. Kjo tregon një vëllim të qëndrueshëm dhe pak më të madh të mbeturinave të depozituara në këtë deponi, gjë që mund të jetë rezultat i rritjes së popullsisë ose të aktivitetit ekonomik.

Në deponitë e Velekincës (Gjilan) dhe Landovicës (Prizren), është vënë re një ulje e konsiderueshme e deponimit të mbeturinave gjatë vitit 2024. Në Velekincë, ka pasur një ulje prej 4,597.08 ton (rreth 8.61%), nga 53,343.76-ton në 48,746.68 ton, që tregon përpjekje të dukshme për reduktimin e mbeturinave në këtë zonë. Në Landovicë, ulja ka qenë edhe më e madhe me 15,693.74 ton (rreth 13.36%), duke shkuar nga 117,464.02-ton në 101,770.28-ton. Kjo është një tregues i qartë i përmirësimit në menaxhimin ose reduktimin e mbeturinave në rajonin e Prizrenit.

Në deponinë sanitare rajonale të Mitrovicës (Gërmovë), ka pasur një ulje të konsiderueshme prej 10,790.15 ton (rreth 19.96%), nga 54,063.48-ton në 43,273.33 ton. Kjo mund të jetë rezultat i zbatimit të politikave më të mira për menaxhimin e mbeturinave. Nga ana tjetër, në deponinë sanitare të Pejës, vërehet një rritje e vogël prej 1,132.77 ton (rreth 2.18%), duke shkuar nga 51,882.50-ton në 53,015.27 ton, që tregon stabilitet në sasinë e mbeturinave të depozituara dhe mund të jetë tregues i një gjendjeje të qëndrueshme të menaxhimit të mbeturinave në këtë zonë.

Në deponitë sanitare të Dragashit dhe të Podujevës, deponohen mbeturinat e gjeneruara vetëm në komunat gjegjëse dhe gjatë vitit 2024 janë deponuar respektivisht, 10,504.0 ton në deponinë e Dragashit dhe 18,103.2 ton në deponinë e Podujevës.

3.4.4. Trajtimi i mbeturinave

Trajtimi i mbeturinave përfshin të gjitha proceset fizike, kimike, biologjike dhe termike që synojnë të reduktojnë sasinë dhe ndikimin e mbeturinave në mjedis, duke lehtësuar manipulimin, riciklimin apo asgjësimin e tyre. Sipas Direktivës së BE-së për Mbeturinat (Direktiva 2008/98/EC), "trajtim" nënkupton çdo operim që nuk është parandalim dhe që ka për qëllim përgatitjen e mbeturinave për riciklim ose asgjësim, përfshirë edhe fazat e ndarjes dhe përpunimit të tyre.³⁸

Riciklimi dhe ndarja në burim - një nga praktikat më të suksesshme të trajtimit në Evropë është ndarja në burim, që lehtëson procesin e riciklimit dhe ul ndjeshëm nevojën për deponim. Ajo mund të realizohet në burim (në vendin e krijimit të mbeturinës) apo në impiante të specializuara.³⁹

Riciklimi përfshin përpunimin e materialeve mbeturinë për t'i kthyer ato në produkte, materiale ose substanca, qoftë për qëllimin e tyre origjinal apo për qëllime të tjera. Sipas Udhëzimit për Menaxhimin e Mbeturinave të Komisionit Evropian, riciklimi nuk përfshin proceset që rezultojnë në prodhimin e energjisë ose përdorimin e mbeturinave si karburant.⁴⁰

Trajtimi biologjik- Kjo përfshin proceset si kompostimi dhe digestimi anaerobik, ku mbeturinat organike dekompozohen përmes mikroorganizmave. Produktet përfundimtare janë të përdorshme si pleh organik ose si burim energjie (biogaz).⁴¹

Incenerimi (djegia e mbeturinave) - një nga teknologjitë më të përhapura për reduktimin e vëllimit të mbeturinave, incenerimi përfshin djegien e tyre në temperatura të larta, zakonisht me rikuperimin e energjisë (waste-to-energy). Sipas OECD,

³⁸ European Parliament (2008). Directive 2008/98/EC on waste and repealing certain Directives. Official Journal of the European Union.

³⁹ BMUV (2023). Waste separation and recycling in Germany. Federal Ministry for the Environment, Nature Conservation, Nuclear Safety and Consumer Protection.

⁴⁰ European Commission, 2016.

⁴¹ European Commission (2008). Green Paper on the management of bio-waste in the European Union.

incenerimi është efektiv për mbeturinat që nuk mund të riciklohen dhe për mbeturinat e rrezikshme.⁴²

Trajtimi i mbeturinave të rrezikshme - Këto mbetje kërkojnë trajtime të specializuara që sigurojnë izolimin e substancave të dëmshme, siç janë metalet e rënda, kimikatet toksike apo materialet radioaktive. Trajtimi mund të përfshijë neutralizimin kimik, stabilizimin, ose inkapsulimin. Kjo siguron që substancat toksike të mos ndikojnë në ujin, tokën apo ajrin.⁴³

Deponimi - Kur mbeturinat nuk mund të trajtohen ndryshe, ato përfundojnë në deponi të kontrolluara. Deponitë moderne janë të pajisura me sistem të mbylljes dhe mbrojtjes nga infiltrimi në ujërat nëntokësore dhe përfshijnë monitorimin e gazrave dhe lëngjeve që rrjedhin nga mbeturinat.⁴⁴

Implantet e trajtimit të mbeturinave - Implantet janë objekte të ndërtuara dhe të pajisura posaçërisht për kryerjen e një ose më shumë proceseve të trajtimit. Ato mund të jenë të dedikuara për ndarjen, riciklimin, trajtimin termik ose trajtimin e mbeturinave të rrezikshme. Në përpunje me standardet e BE-së, implantet duhet të funksionojnë me teknologji të avancuara për të minimizuar ndotjen dhe për të rritur efikasitetin e rikuperimit të burimeve.⁴⁵

Trajtimi i mbeturinave është një sfidë dhe një mundësi njëkohësisht. Përmes teknologjive moderne dhe politikave të qëndrueshme, shtetet evropiane kanë arritur të zvogëlojnë varësinë nga deponitë dhe të rrisin nivelin e riciklimit dhe rikuperimit të energjisë. Për vendet në zhvillim, këto praktika ofrojnë shembuj të mirë të përshtatshëm për adaptim sipas kontekstit lokal.

⁴² OECD (2022). *Global Plastics Outlook: Economic Drivers, Environmental Impacts and Policy Options*.

⁴³ European Commission (2021). *EU Taxonomy: Environmental Objectives – Waste management including hazardous waste*.

⁴⁴ European Commission (2020). *Landfill of Waste – Directive 1999/31/EC*

⁴⁵ European Commission (2017). *Best Available Techniques (BAT) Reference Document for Waste Treatment Industries*. Retrieved from: <https://eippcb.jrc.ec.europa.eu/reference/waste-treatment>

Grafiku i paraqitur ilustron sasinë e mbeturinave të trajtuara sipas kategorive të ndryshme për vitin e raportuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)⁴⁶. Të dhënat janë rezultat i anketimeve të rregullta dhe grumbullimit të informacionit nga operatorët dhe institucionet që merren me menaxhimin e mbeturinave komunale.

Kategoritë kryesore të mbeturinave dhe sasi të përkatëse të trajtuara janë si më poshtë:

- Mbeturina nga ekonomitë familjare dhe të ngjashme përbëjnë pjesën dërrmuese të mbeturinave të trajtuara, me një sasi prej 490,316 ton. Kjo kategori përfshin mbeturinat komunale të gjeneruara në shtëpi, biznese të vogla dhe institucione publike, i cili reflekton nivelin më të lartë të gjenerimit të mbeturinave urbane.
- Mbeturina të letrës dhe kartonit përbëjnë 16,869 ton, duke treguar një prani domethënëse të këtij lloji materiali në rrjedhat e mbeturinave që potencialisht mund të riciklohen.
- Mbeturina nga metali dhe mbeturina nga plastika përfaqësojnë përkatësisht 4,646 ton dhe 4,221 ton, duke qenë fraksione me rëndësi për rikuperim material dhe ekonomi qarkore.
- Mbeturina spitalore, që konsiderohen mbetje të rrezikshme për shkak të përmbajtjes së tyre biologjike dhe kimike, përbëjnë një sasi më të ulët, me gjithsej 2,540 ton, por që kërkojnë trajtim të veçantë.

⁴⁶ ASK, *Anketa e Mbeturinave të Trajtuara, 2023*




Figura 22: Trajtimi i mbeturinave komunale në Kosovë

3.4.5. Deponitë ilegale

Gjatë vitit 2024, 30 komuna kanë realizuar regjistrimin e deponive ilegale dhe i kanë raportuar të dhënat përkatëse në Agjencinë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK) në platformen online. Ka pasur ndryshim në totalin e deponive ilegale mes viteve 2023 dhe 2024, me një rritje të përgjithshme nga 403 në 458 deponi (pra një shtim prej 55 deponish).

Kjo rritje është ndikuar kryesisht nga shtimi i deponive të vogla, ndërsa ka pasur ulje në numrin e deponive të mëdha dhe të mesme të cilat janë kategorizuar sipas madhësisë si vijon:

- 162 deponi të vogla (1–5 thasë mbeturinash prej 200 litra),
- 150 deponi të mesme (6–20 thasë),
- 146 deponi të mëdha (mbi 20 thasë).

Të dhënat tregojnë se gjendja në terren vazhdon të ndryshojë nga një komunë në tjetrën. Në disa komuna është evidentuar një

rritje e ndjeshme e numrit të deponive ilegale, si në rastin e Podujevës dhe Ranilluges, të cilat për herë të parë kanë përfshirë të dhëna në këtë raport dhe njëherësh kanë raportuar numër të lartë të deponive (40 dhe 22 përkatësisht).

Nga ana tjetër, disa komuna kanë shënuar ulje të lehtë të numrit të deponive ilegale krahasuar me vitin paraprak, si Lipjani me një ulje nga 80 në 76 deponi, Prishtina nga 3 në 1 deponi, Peja me një ulje nga 21 në 14 deponi, Prizreni nga 14 në 11 dhe Deçani nga 10 në 8 deponi, ndërsa disa të tjera kanë mbajtur një gjendje të qëndrueshme si Fushë-Kosova, Graçanica, Istogu, Klina, Skenderaj, Kamenica, Shtime, Kaçaniku, Gjakova, Shtërpca – pa ndryshim në totalin e deponive nga një vit në tjetrin.

Gjithashtu, gjatë vitit 2024 janë përfshirë në procesin e raportimit edhe komuna si Gjilani, Vitia, Ranilluga dhe Podujeva duke dëshmuar për një përfshirje më të gjerë institucionale në procesin e monitorimit të deponive ilegale dhe rëndësinë në rritje që i kushtohet kësaj problematike mjedisore në nivel lokal (shih tabela 22).

Komunat të cilat nuk kanë raportuar në vitet 2023 dhe 2024 janë Mitrovica e Veriut, Zveçani, Zubin Potoku, Parteshi, Klllokoti, Leposaviqi dhe Malisheva nuk kanë dorëzuar të dhëna për asnjërin prej dy viteve të fundit, duke lënë një boshllëk të konsiderueshëm në pasqyrimin e situatës mjedisore për këto zona.

Të dhënat e detajuara për secilën komunë dhe shpërndarjen e deponive sipas madhësisë janë paraqitur në tabelën në vijim:

Tabela 19. Numri i deponive të krijuara në Kosovë gjatë vitit 2024 – sipas raportimeve të komunave

2023					2024				
Komunat	Deponitë ilegale sipas madhësisë			Total 2023	Komunat	Deponitë ilegale sipas madhësisë			Total 2024
	Deponi të vogla (1-5 thasë mbeturi nash 200 l)	Deponi të mesme (6-20 thasë mbeturi nash 200 l)	Deponi të mëdha (>20 thasë mbeturi nash 200 l)			Deponi të vogla (1-5 thasë mbeturi nash 200 l)	Deponi të mesme (6-20 thasë mbeturi nash 200 l)	Deponi të mëdha (>20 thasë mbeturi nash 200 l)	
Prishtinë	0	0	3	3	Prishtinë	0	0	1	1
Glllogoc	5	9	3	17	Glllogoc	8	9	4	21
Fushë-Kosovë	1	3	5	9	Fushë-Kosovë	1	3	5	9
Graçanicë	2	4	1	7	Graçanicë	2	4	1	7
Lipjan	15	35	30	80	Lipjan	15	35	26	76
Obiliq				0	Obiliq	0	0	0	0
Podujevë					Podujevë	30	7	3	40
Mitrovicë	6	6	4	16	Mitrovicë	6	6	4	16
Skenderaj	3	13	10	26	Skenderaj	3	13	10	26
Vushtrri	1	1	1	3	Vushtrri	1	1	1	3
Mitrovicë e V.					Mitrovicë e V.				
Zveçan					Zveçan				
Zubin-Potok					Zubin-Potok				
Leposaviq					Leposaviq				
Pejë	7	9	5	21	Pejë	3	5	6	14
Istog	1	5	1	7	Istog	1	5	1	7
Klinë	3	7	8	18	Klinë	3	7	8	18
Prizren	12	2	0	14	Prizren	11	0	0	11
Suharekë	5	4	0	9	Suharekë	4	4	0	8
Malishevë					Malishevë				

Rahovec	2	3	2	7	Rahovec	22	0	0	22
Dragash	0	11	27	38	Dragash	2	12	23	37
Mamushë	2	2	2	6	Mamushë				
Ferizaj	0	5	1	6	Ferizaj	0	4	1	5
Kaçanik	8	3	4	15	Kaçanik	8	3	4	15
Shtime	0	6	5	11	Shtime	0	6	5	11
Hani Elezit	3	4	1	8	Hani Elezit	2	4	1	7
Shtërpçë	10	7	5	22	Shtërpçë	10	7	5	22
Gjilan					Gjilan	1	1	1	3
Kamenicë	0	3	6	9	Kamenicë	0	3	6	9
Viti					Viti	0	0	0	0
Novobërdë	0	3	1	4	Novobërdë	0	3	1	4
Partesh					Partesh				
Kllokot					Kllokot				
Ranillug					Ranillug	22	0	0	22
Gjakovë	2	6	28	36	Gjakovë	2	6	28	36
Deçan	5	4	1	10	Deçan	5	2	1	8
Junik	1	0	0	1	Junik	0	0	0	0
Totali	94	155	154	403	Totali	162	150	146	458

3.4.6. Mbeturinat spitalore

Mbeturinat spitalore trajtohen përmes procesit të sterilizimit në 7 sterilizatorë të vendosur në 7 spitale regjionale. Përmes sterilizimit trajtohen kryesisht: shiringat, infuzionet, fashat dhe pajisje të ndryshme të përdorura në trajtime shëndetësore. Këto mbeturina, pas trajtimit përmes sterilizimit dhe imtësimit, vendosen në kontejnerë të mbeturinave të ngurta urbane dhe deponohen në deponi.

Një spektër tjetër i mbeturinave (kryesisht barnat me afat të skaduar, suplemente të ndryshme etj.) asgjësohen në furra për shkrirjen e metaleve në disa kompani të pajisura me leje përkatëse mjedisore.

Një spektër tjetër i mbeturinave janë ato patologjike (placenta, embrione, amputime, lëngje trupore etj.), të cilat qendrat spitalore përmes kompanive të kontraktuara i groposin në varreza dhe i gëlqerosin për t'i dezinfektuar.

Mbeturinat kimike, të përdorura në kujdesin shëndetësor, nuk ndahen dhe nuk trajtohen në mënyrë të veçantë sipas legjislacionit dhe supozohet se hidhen apo menaxhohen në mënyrë jo të duhur.

Mbeturinat farmaceutike (medikamente citostatike) të përdorura në kujdesin shëndetësor, në sasi të mëdha janë të deponuara në deponinë qendrore në Prishtinë, ndërsa një pjesë ruhen edhe në spitalet rajonale.

Tabela 20 tregon sasinë e mbeturinave të ricikluara, të sterilizuara (në impiantet adekuate për sterilizim), të deponuara dhe gjithsej sasinë e mbeturinave të trajtuara në vitin 2024.

Tabela 20: sasia e mbeturinave spitalore të sterilizuara në 8 qendrat spitalore rajonale

Impianti	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024
Sasia	kg	kg	kg	kg	kg	kg	kg
1.Prishtinë	360,819.10	487,169.60	766,347.40	465,335.00	610,564.20	756,882.00	838359
2.Prizren	100,175.70	97,195.20	96,227.50	96,290.80	106,782.70	74,262.00	57010.7
3.Pejë	49,215.00	45,720.00	50,480.00	47,560.00	44,678.00	44,488.00	59,317.0
4.Ferizaj	35,465.90	39,215.00	37,664.40	39,934.30	38,914.80	30,014.50	34,818.00
5.Gjilan	26,460.40	29,859.80	40,748.00	42,046.00	39,689.00	47,687.00	42425
6.Gjakovë ⁴⁷	2,951.00	3,357.00	3,159.00	3,284.00	1,288.00	0.00 ⁴⁸	689.0
7.Mitrovicë	72,323.00	85,149.00	68,214.00	67,174.00	76,250.00	73,798.00	77320.3
8.Vushtrri	2,504.00	2,580.35	632.61	1,185.74	2,613.55	2,541.21	1622.36
Totali	649,914	790,245	1,063,472	762,809	920,780	1,029,672	1,111,561

⁴⁷ Në kuadër të menaxhimit të mbeturinave, në Gjakovë janë trajtuar gjithsej 1,658 kg mbeturina nga to në spitalet e Pejës dhe Ferizajit janë trajtuar 969 kg mbeturina.




Figura 23: Trendi sasia e mbeturinave spitalore të sterilizuara në 8 qendrat spitalore rajonale

Prej të dhënave të raportuara dhe të vlerësuara nga këto qendra të trajtimit të mbeturinave spitalore, shohim një rritje prej 81,889 kg më shumë mbeturina në vitin 2024 krahasuar me vitin 2023 që tregon një përmirësim të përgjithshëm të performancës së impianteve. Sasia më e madhe e këtyre mbeturinave gjatë vitit 2024 sikurse edhe në vitet paraprake është trajtuar në impiantin i cili operon në QKUK- Prishtinë në sasi prej 838,359 kg e pasuar nga impianti në spitalin në Mitrovicë me një sasi prej 77320.3 kg, kurse sasia më e vogël është trajtuar në impiantin në Gjakovë me 689 kg.

3.4.7. Mbeturinat industriale

Sipas të dhënave të Anketës mbi Mbeturinat Industriale për vitin 2023⁴⁹, sasia totale e mbeturinave industriale të gjeneruara arrin në 3,390,647-ton, duke shënuar një rritje të lehtë prej 0.02% krahasuar me vitin 2022.

⁴⁹ ASK, Anketa e Mbeturinave Industriale, për vitin 2023

Gjatë të njëjtit vit janë përpunuar gjithsej 3,390,687.00-ton mbeturina industriale. Format e përpunimit kanë qenë: deponimi, djegia dhe riciklimi.

Të dhënat e vitit 2023 tregojnë se sasia më madhe e mbeturinave të gjeneruara sipas sektorëve të industrisë ishin tek: Sektori D (*Furnizimi me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar*) kontribuoi me sasinë më të madhe të mbeturinave, duke gjeneruar 2,797,996 ton, që përfaqëson një rritje prej 0.08% krahasuar me një vit më parë dhe Sektori C (*Industria përpunuese*) gjeneroi gjithsej 334,258-ton mbeturina industriale.

Vlen të theksohet se sasia totale e mbeturinave të përpunuara në vitin 2023 ishte 3,390,687-ton, duke përfshirë mbeturinat e trajtuara dhe ato të destinuara për depozitimin përfundimtar.




Figura 24: Gjenerimi dhe trajtimi i mbeturinave industriale në Kosovë




Figura 25: Trendi i gjenerimit të mbeturinave industriale në Kosovë 2018-2023

Sipas të dhënave vërejmë se trendi i gjenerimit të mbeturinave industriale në periudhën 2018–2023 paraqet disa luhatje në vitet e para, me një ulje nga viti 2018 deri në 2019, dhe një rritje të lehtë graduale nga 2020 deri në 2021.

Megjithatë, nga viti 2022 vërehet një rritje e ndjeshme, duke arritur vlerën më të lartë në vitin 2023 me 3,390,647 ton. Kjo rritje në dy vitet e fundit mund të jetë rezultat i intensifikimit të aktiviteteve industriale, pas pandemisë, ose përmirësimeve në raportimin dhe monitorimin e mbeturinave industriale.

3.4.8. Importi dhe eksporti i thasëve dhe qeseve të plastikës si dhe i mbetjeve

Ndotja nga plastika përbën një ndër sfidat më serioze për mjedisin në nivel global dhe lokal. Në vendin tonë, prania e lartë e mbetjeve plastike, sidomos nga produktet njëpërdorimshme si qeset plastike, është bërë një problem i vazhdueshëm që ndikon

negativisht në ekosistemet tokësore dhe ujore.⁵⁰ Mungesa e menaxhimit të duhur të mbeturinave, vetëdijes qytetare dhe alternativave të qëndrueshme ka përkeqësuar këtë situatë, duke e kthyer ndotjen plastike në një kërcënim të përhershëm për mjedisin dhe shëndetin publik.⁵¹

Qeset plastike janë bërë një ndër ndotësit më të zakonshëm dhe më të dukshëm në mjedisin tonë, duke u hasur shpesh në rrugë, lumenj, fusha dhe hapësira publike. Kjo dukuri është rezultat i një kombinimi faktorësh, përfshirë përdorimin e madh të qeseve njëpërdorimshme, mungesën e alternativave të qëndrueshme, nivelin e ulët të vetëdijes mjedisore, si dhe mungesën e zbatimit të masave kufizuese për përdorimin dhe shpërndarjen e tyre.⁵² Qeset plastike, të cilat zakonisht përdoren për një kohë shumë të shkurtër, mbesin në mjedis për dekada, duke ndikuar në ndotjen e tokës dhe ujërave, si dhe në dëmtimin e biodiversitetit.⁵³

Një ndër faktorët kryesorë që kontribuon në ndotjen e mjedisit në Kosovë me mbetje plastike, si dhe në praninë e lartë të qeseve në mjedisin tonë rrethues, është importi dhe përdorimi i madh e i vazhdueshëm i qeseve plastike. Një pjesë e konsiderueshme e mbeturinave komunale, të gjeneruara nga amvisëritë, si dhe nga aktivitetet ekonomike dhe industriale, përbëhet nga qese dhe thasë plastike. Për shkak të natyrës së tyre jo të biodegradueshme, këto mbetje kontribuojnë ndjeshëm në ndotjen afatgjatë të mjedisit.

Në vitin 2024, sipas të dhënave zyrtare nga Dogana e Kosovës, janë importuar 258,936 kg thasë dhe qese plastike, duke shënuar një rënie të konsiderueshme prej 68.4% krahasuar me vitin 2023. Nga ana tjetër, në vitin 2024 janë eksportuar 3,091,778 kg thasë

⁵⁰ Jambeck, J. R. et al. 2015. Plastic waste inputs from land into the ocean. *Science*.

⁵¹ Thompson, R. C. et al. 2009. Our plastic age. *Philosophical Transactions of the Royal Society B: Biological Sciences*.

⁵² European Environment Agency. 2019. *Plastic in the environment*.

Available at: <https://www.eea.europa.eu/publications/plastic-in-the-environment>

⁵³ Geyer, R., Jambeck, J. R. & Law, K. L. 2017. Production, use, and fate of all plastics ever made. *Science Advances*.

dhe qese plastike, duke shënuar një ulje prej 3.4% krahasuar me vitin 2023, kur eksporti ishte 3,200,686 kg.

Këto të dhëna tregojnë një rënie të madhe të importit dhe një ulje të lehtë të eksportit, në vitin 2024 krahasuar me vitin 2023.

Kjo rënie e importimit dhe eksportit të qeseve dhe thasëve plastike mund të jetë edhe si rezultat i ndikimit pozitiv që ka pasur zbatimi i Udhëzimi Administrativ (QRK) nr. 04/2025 për Ambalazhin dhe Mbeturinat e Ambalazhit, nga i cili ka rrjedhur edhe vendimi i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës i datës 5 tetor 2023, për vendosjen e tarifës prej 5 centësh për çdo qese plastike të përdorur.




Figura 26: Sasia e thasëve dhe qeseve plastike të importuara 2018 – 2024 kg/vit

Të dhënat mbi importin e thasëve dhe qeseve të plastikës në Kosovë për periudhën 2018-2024 tregojnë një trend të përgjithshëm të rënies së ndjeshme, me përjashtim të një rritjeje të jashtëzakonshme e cila shihet gjatë vitit 2021. Ky trend pasqyron përpjekje të vazhdueshme për uljen e përdorimit të plastikës njëpërdorimshme, me një përjashtim të pazakontë në

vitin 2021, dhe sugjerojnë një orientim drejt politikave më të qëndrueshme mjedisore në vitet e fundit.




Figura 27: Sasia e thasëve dhe qeseve plastike të eksportuara 2018 – 2024

Eksporti i thasëve dhe qeseve të plastikës nga Kosova gjatë periudhës 2018-2024 ka shënuar një rritje të vazhdueshme dhe të ndjeshme. Ky trend reflekton një zhvillim të konsiderueshëm të kapaciteteve prodhuese dhe të pranisë së produkteve vendore në tregjet ndërkombëtare, ndërkohë që rënia e lehtë në vitin 2024 sugjeron një stabilizim të eksportit pas një rritjeje të shpejtë në vitet e mëparshme.

Raportimi i prodhimit të qeseve plastike nga prodhuesit vendor

Sipas Udhëzimit Administrativ për qeset plastike, neni 42, pika 1, prodhuesit e qeseve plastike janë të obliguar të raportojnë në Agjencinë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës numrin e qeseve të prodhuara gjatë vitit paraprak.

Ky raportim është në përputhje me kërkesat ligjore dhe administrative që synojnë mbrojtjen e mjedisit dhe menaxhimin e qëndrueshëm të përdorimit të plastikës në Kosovë. Për më tepër, këto masa kontribuojnë në zbatimin e politikave për reduktimin e përdorimit të qeseve plastike dhe promovimin e alternativave më ekologjike, në përputhje me praktikatat e vendeve të Bashkimit Evropian⁵⁴.

Tabela 21. Prodhimi i qeseve plastike nga disa kompani vendore kryesore

Prodhimi 2024	Qese ambalazh/ Qese plastike mbajtëse 25-50	Qese 50 mikron/ Qese plastike mbajtëse mbi 50	Sasia /Copë
Prodhimi i qeseve plastike nga katër kompani vendore.	4,407,474	3,848,317	Copë
	557,200	31,958,636	Copë
	12,242,312.00	19,906,591.78	Copë
	-	323.421	Copë
Totali:	17,206,986.00	55,713,868.20	Copë

Tabela paraqet të dhëna të pjesshme mbi prodhimin vendor të qeseve plastike në Kosovë për vitin 2024, duke reflektuar kryesisht aktivitetin e disa kompanive dominuese në treg. Të dhënat nuk përfshijnë të gjitha kompanitë që merren me këtë aktivitet prodhues në Kosovë.

Megjithatë, kjo industri po përballet me sfida dhe ndryshime të rëndësishme mjedisore dhe ligjore që pritet të ndikojnë në të ardhmen e prodhimit dhe konsumit të qeseve plastike në Kosovë. Nga ana tjetër, në Kosovë ka një përpjekje në rritje për reduktimin e përdorimit të qeseve plastike njëpërdorimshme dhe për promovimin e riciklimit. Kjo mund të ndikojë në trendët e prodhimit dhe konsumit në vitet e ardhshme. Gjithashtu, importi i qeseve plastike në Kosovë ka rënë ndjeshëm në vitin e fundit për shkak të politikave fiskale si vendosja e çmimit prej 5

⁵⁴ Udhëzim Administrativ (Mea) Nr.11/2020 Për Përcaktimin e kërkesave teknike dhe kërkesave tjera për qeset e plastikës

centë për qeset plastike, që ka sjellë kursime ekonomike dhe një ulje të ndotjes mjedisore.

Në total, prodhimi i qeseve plastike për vitin 2024 në dy kategori madhësie (25-50 mikron dhe mbi 50 mikron) arrin në rreth 17.2 milionë copë për qeset më të vogla dhe mbi 55.7 milionë copë për qeset më të mëdha, duke treguar një volum të konsiderueshëm prodhimi vendor.

3.5. Mbrojtja e natyrës dhe biodiversitetit

3.5.1. Zonat e mbrojtura

Vlerat e trashëgimisë natyrore në Kosovë janë të shumta. Këto vlera (zonat e mbrojtura dhe biodiversiteti), mjedisi jetësor dhe trashëgimia kombëtare, janë përgjegjësi e secilit⁵⁵. Lista me numrin e Zonave të Mbrojtura të Natyrës (ZMN) në territorin e Kosovës ka treguar tendenca të rritjes vit pas vitit.

Në kronologjinë e shpalljes së zonave të mbrojtura të natyrës mund të veçohen katër periudha kohore të cilat lidhen me zhvillimet e përgjithshme në Kosovë. Pas luftës së vitit 1999 janë shënuar rezultate të konsiderueshme në rritjen e numrit të përgjithshëm të zonave të mbrojtura si dhe në zgjerimin e sipërfaqeve të mbrojtura të natyrës të të gjitha kategorive.

Periudha 1950 - 1970, paraqet fazën fillestare të mbrojtjes së natyrës dhe shpalljes së zonave të mbrojtura të natyrës në Kosovë, e cila fillon me shpalljen e zonës së parë në vitin 1950, që ishte "Gazimestani". Deri në fillimin e viteve të 70-ta, numri i zonave të mbrojtura kishte arritur në 19 (nëntëmbdhjetë). Në këtë periudhë janë venë nën mbrojtje: Shpella e Gadimes dhe disa monumente të tjera me rëndësi botanike si: Rrapi në Marash, Trungjet në Isniq, etj.

Periudha në mes viteve 1970-1988, karakterizohet me shpalljen e numrit të konsiderueshëm të zonave të mbrojtura. Arsyeja e këtij sukcesi është e lidhur me themelimin e Entit të Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës në vitin 1974 nga Kuvendi i Kosovës. Në

⁵⁵ Kushtetuta e Republikës së Kosovës

këtë periudhë janë vënë nën mbrojtje gjithsej 32 zona, prej të cilave duhet veçuar: "Bifurkacioni i Lumit Nerodime", Parku i parë Kombëtar "Mali Sharr" (1986), Burimi i Drinit të Bardhë me Shpellën dhe Ujëvarën në Radavc (1983) si dhe disa monumente të tjera të natyrës.

Periudha 1989-1999, sikur edhe në sferat tjera edhe në atë të mbrojtjes së natyrës kishte stagnim të plotë edhe sa i përket shpalljes së zonave të mbrojtura. Ishte periudha kur si pasojë e përjashtimit të ekspertëve shqiptar nga institucionet për mbrojtjen e natyrës por jo vetëm, nuk kemi as edhe një zonë të mbrojtur ose të propozuar për mbrojtje.

Periudha pas vitit 2000, karakterizon rithemelimin e institucioneve të Kosovës, duke përfshirë Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, respektivisht Institutin e Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës. Gjatë kësaj periudhe janë marrë nën mbrojtje ligjore mbi 2000 zona të ndryshme dhe janë propozuar për mbrojtje mbi 30 zona tjera. Në mesin e zonave të mbrojtura duhet veçuar: Parku Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" (2013), PK "Sharri" (i zgjeruar), Mali Pashtrik dhe Liqeni i Vërmicës, Ligatina e Hencit - Radevës etj. Ndërsa shumicën e zonave e përbëjnë monumentet e natyrës me karakter botanik, hidrologjik, gjeomorfologjik, speleologjik etj.




Figura 28. Numri i zonave të mbrojtura të natyrës 1950 – 2024

Zonat e mbrojtura të natyrës – Gjendja 2024

Numri i përgjithshëm i zonave të mbrojtura të natyrës në Kosovë (2024) është 260 të cilat përfshijnë sipërfaqe prej 126,112.2 ha ose 11.5 % e sipërfaqes së Kosovës.

Në kuadër të këtyre zonave hyjnë: 19 Rezervate Strikte të Natyrës (“Rezervati i Arnenit”, “Maja e Ropsit”, “Rusenica”, “Kamilja”, etj.), 2 Parqe Kombëtare (PK “Sharri”, PK “Bjeshkët e Nemuna”), 230 Monumente të Natyrës (“Burimi i Drinit të Bardhë me Shpellën e Radavcit”, “Shpella e Gadimës”, “Ujvarat e Mirushës”, “Gryka e Rugovës”, “Kanioni i Drinit të Bardhë të Ura e Fshajtë”, “Trungu i Rrapit në Marash” etj.), 1 Park i Natyrës (“Mali Pashtrik dhe Liqeni i Vërmicës”), 7 Peizazhe të Mbrojtura (“Shkugëza” “Germia” dhe “Pishat e Deçanit” etj.) dhe një(1) Zonë e Veçantë e Mbrojtur e Zogjve (“Ligatina e Hencit-Radeves”).

Sipërfaqen më të madhe të zonave të mbrojtura e përbëjnë Parqet Kombëtare: “Bjeshkët e Nemuna” dhe “Sharri”, Parku i natyrës “Mali Pashtrik dhe Liqeni i Vermicës”, Peizazhi i Mbrojtur “Germia”, MNRV “Ujëvarat e Mirushës” dhe MN “Lokaliteti i Boshtres në zonën e Goleshit” etj.

Tabela 22: Numri dhe sipërfaqja e Zonave të Mbrojtura 2024

Kat. e IUCN-së	Emërtimi	Nr.	Sipërfaqja/ha	Pjesë. ne siper. e pergjith. te ZM
I	Rezervatet Strikte të	19	10,882.96	7.7
II	Parqet Kombëtare	2	115,957	82.1
III	Monumentet Natyrore	230	6,180.90	4.4
V	Park Natyre	1	5,934	4.2
V	Peizazh i Mbrojtur	7	2,319.85	1.6
V	Zonë e Veçantë e Mbrojtur e Zoonave	1	109.5	0.08
	Totali	260	126122.75⁵⁶	100⁵⁷

Gjatë vitit 2024 nën mbrojtje paraprake ligjore është marrë zona “Guri i Hoxhës me Gryken e lumit të Perlepnicës”, në territorin e komunës së Ranilugut si Monumentit të natyrës me sipërfaqe të përgjithshme prej 30 ha, si zonë e cila disponon me vlera të karakterit; geomorfologjik (gryka dhe shkëmbinjtë gëlqeror-Guri i Hoxhës), hidrologjik (rrjedha e lumit, ujëvarat artificiale dhe burime uji), speleologjike (të konstatuara vetëm sipërfaqësisht) si dhe vlera të biodiversitetit, ndërsa në procedur drejt finalizimit është edhe vemja nën mbrojtje paraprake e zonës “Mali Mokna dhe Liqeni i Ujmanit” në territorin e komunës së Istogut dhe Zubin Potokut në kategorinë Park Natyre me sipërfaqe të përgjithshme prej rreth 25 mijë ha.

⁵⁶ Sqarim: kjo sipërfaqe e zonave të mbrojtura nuk përfshinë zonat e mbrojtura që gjenden në kuadër të Parqeve Kombëtare “Sharri” dhe “Bjeshkët e Nemuna”

⁵⁷ Sqarim: përqindja është nxjerr nga sipërfaqja e përgjithshme duke përfshirë edhe sipërfaqen e zonave të mbrojtura brenda parqeve kombëtare.

Gjithashti në procedurë për vënje nën mbrojtje nga vitet paraprake janë edhe mbi 30 monumente të natyrës në komunat: Pejë, Prizren, Kamenicë dhe Artanë.

Zonat e mbrojtur janë nën presion të vazhdueshëm nga ndërhyrjet njerëzore, të cilat shpeshherë cenojnë qëndrueshmërinë e zonave të mbrojtura. Rreziqet më të mëdha me të cilat përballen zonat e mbrojtura, në veçanti parqet kombëtare janë:

- ndërtimet dhe infrastruktura- ndërtimet, ndërtimet me karakter turistik apo ekonomike, rrugë, hidrocentrale etj;
- shfrytëzimi i tepërt i burimeve natyrore – prerja e pyjeve, gjuetia ilegale , mbledhja e bimëve të rralla;
- turizmi masiv i pakontrolluar – vizitorë të shumtë pa rregulla të qarta, që shkaktojnë mbeturina, zhurmë, zjarrvënie dhe dëmtim të biodiversitetit;
- ndryshimet klimatike – ngrohja globale që sjell zhdukjen e disa specieve, zhvendosjen e habitateve dhe rritjen e fenomeneve ekstreme (zjarre);
- mungesa e menaxhimit dhe kontrollit – mbrojtja vetëm “në letër” pa staf, pa fonde dhe pa plane efektive.

Pra, rreziku më i madh është kombinimi i presioneve njerëzore dhe ndryshimeve klimatike, që bashkë ndikojnë në degradimin e ekosistemeve dhe humbjen e vlerave natyrore dhe biodiversitetit.

Dy problemet më të mëdha me të cilat gjatë vitit 2024 janë ballafaquar zonat e mbrojtura sidomos ato me sipërfaqe të mëdha (posaçërisht parqet kombëtare) janë: ndërtimet dhe infrastruktura të cilat duhen trajtuar me shumë kujdes.

Zhvillimi me ndërtime dhe infrastrukturë në zonat e lartcekura duhet të jetë i qëndrueshëm dhe i kontrolluar, duke respektuar kuadrin ligjor për zonat e mbrojtura, për të ruajtur natyrën për brezat e sotëm dhe të ardhshëm. Fatkeqësisht, gjendja e tanishme sa i përket ndërtimeve dhe infrastrukturës në shumë zona të mbrojtura posaçërisht të parqeve kombëtare janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla përcillen me pasoja të shumta duke shkaktuar:

Degradimi i peizazhit natyror - prishja e peizazhit natyror ul vlerën estetike dhe rekreative të parkut. Rrezikon vlerat kulturore, historike ose gjeologjike që mund të jenë pjesë e parkut.

Fragmentimi i peizazheve natyrore - ndërtimet dhe infrastruktura krijojnë barriera fizike që e ndajnë natyrën në pjesë të vogla, duke e penguar lëvizjen e kafshëve dhe shpesh duke prishur ciklet natyrore. Për shembull, ndërtimi i rrugëve brenda një parku mund të ndërpresë migrimin e specieve ose të rrisë rrezikun e përplasjes së tyre me automjete.

Humbja e biodiversitetit- ndërtimet në parqet kombëtare shpesh shoqërohen me shkatërrimin e habitateve natyrore. Kjo sjell largimin ose zhdukjen e kafshëve dhe bimëve të rralla, duke dëmtuar biodiversitetin. Ndërhyrjet në zonat e mbrojtura, si ndërtimi i hoteleve, rrugëve apo qendrave turistike, ndikojnë drejtpërdrejt në jetën e shumë specieve që varen nga qetësia dhe integriteti i mjedisit të egër.

Ndotja dhe degradimi mjedisor - turizmi dhe ndërtimet shpesh shoqërohen me ndotje të ujërave, tokës dhe ajrit. Kanalizimet jo të rregulluara, ndotja akustike dhe ndriçimi artificial dëmtojnë jetën e egër. Mbeturinat e krijuara nga vizitorët apo ndërtimet industriale përreth parkut mund të kenë efekte afatgjata.

Rrezikimi i funksioneve ekologjike dhe klimatike - parqet kombëtare kanë një rol të rëndësishëm në ruajtjen e stabilitetit klimatik dhe ekologjik. Ato shërbejnë si “mushkëritë e gjelbra” të planetit, duke ndihmuar në filtrimin e ajrit dhe ruajtjen e ciklit të ujit. Kur ato dëmtohen e gjithë natyra përreth humbet një sistem mbrojtës të rëndësishëm.

Komercializimi i tepërt - ndërtimet shpesh promovohen si mjete për zhvillimin e turizmit, por ato mund të përfitojnë më shumë nga kapitali privat sesa nga komunitetet lokale. Rritja e aktivitetit komercial në parqet kombëtare shpesh sjell konflikte mes ruajtjes së natyrës dhe interesave ekonomike.

Me këtë rast, me qëllim të përmirësimit të gjendjes nevojitet angazhim dhe koordinim nga të gjitha institucionet relevante qendrore dhe lokale që të gjitha aktivitetet dhe intervenimet në

zonën e mbrojtura të jenë në harmoni me: Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës Nr. 03/L-233, dhe ligjet dhe dokumentet tjera strategjike për zonat e mbrojtura.

Dëmet nga zjarret - Zjarret pyjore paraqesin një nga sfidat e mëdha të institucioneve, sidomos gjatë periudhës së verës. Sipas analizave dhe statistikave të ndryshme mbi 99 % e zjarreve në pyje dhe toka pyjore shkaktohen nga faktori njeri, ndërsa vetëm 1 % e tyre nga shkaktarë të tjerë abiotik. Gjatë vitit 2024 (shih grafikun) si pasojë e periudhës me thatësira dhe nga pakujdesia e njerëzve, sipërfaqeve pyjore të përfshira nga zjarret ka treguar tendencë të konsiderueshme të rritjes, sidomos në raport me vitin paraprak.




Figura 29. Sipërfaqja e djegur e pyjeve në ha/vit

Investimi në monitorim, edukim, politika mbrojtëse dhe ndërgjegjësim publik është i domosdoshëm, në mënyrë që pyjet të mbeten një pasuri dhe trashëgimi për brezat e ardhshëm. Në këtë drejtim, Agjencia Pyjore e Kosovës në bashkëpunimin me

institucionet tjera të rendit, emergjencave dhe sigurisë kanë ndërmarrë disa hapa për parandalimin dhe zvogëlimin e paraqitjes dhe përhapjes së zjarreve në sipërfaqet pyjore dhe në tokat rreth pyjeve, duke trajnuar dhe certifikuar punëtorë për shuarje të zjarreve në pyje, duke angazhuar punëtorë sezonal për mbrojtje e pyjeve nga zjarret.

3.5.2. Biodiversiteti

Vendi ynë është i pasur në aspektin e biodiversitetit dhe për këtë luan rol vendimtar në stabilitetin mjedisor dhe shëndetin e përgjithshëm. Biodiversiteti është shumë i rëndësishëm jo vetëm për ruajtjen e ekuilibrit të ekosistemeve, por gjithashtu për mbështetjen e produktivitetit bujqësor dhe ekonominë lokale. Peizazhet e larmishme përfshijnë lloje të ndryshme bimore të rralla dhe endemike të cilat kontribuojnë në diversitetin gjenetik dhe qëndrueshmërinë e këtyre habitateve. Për më tepër, biodiversiteti është i lidhur thellësisht me trashëgiminë kulturore dhe traditat e popullit të saj, shumë prej të cilëve varen drejtpërdrejt nga këto burime natyrore për jetesën e tyre.

Ruajtja e këtij biodiversiteti është thelbësore për të siguruar zhvillim të qëndrueshëm dhe përshtatje ndaj ndryshimeve mjedisore, të tilla si ndryshimet klimatike. Ekosistemet e shëndetshme, duke përfshirë biodiversitetin e tyre, ofrojnë ujë të pastër, tokë pjellore, pllenim të bimëve, ajër të pastër, zbutjen e motit ekstrem dhe mbrojtje nga erozioni ose përmytjet. Shërbimet e ekosistemit që sjellin përfitime të shumëfishta ndahen në katër kategori: sigurimi i prodhimit të ushqimit dhe ujit; rregullatorë, kontrolli i klimës dhe sëmundjeve; mbështetëse, të tilla si ciklet e lëndëve ushqyese dhe prodhimi i oksigjenit; dhe kulturore, të tilla si përfitimet shpirtërore dhe rekreative. Megjithatë, përdorimi i paqëndrueshëm i burimeve natyrore në dekadat e fundit, i shtyrë nga tranzicioni socio-ekonomik, paraqet një kërcënim serioz për ekosistemet dhe biodiversitetin dhe këto shqetësime duhet të përfshihen në proceset e politikë bërjes dhe vendimmarrjes.

Gjendja e përgjithshme e florës - Edhe pse janë kryer hulumtime të vegetacionit nga autorë të ndryshëm vendor dhe ndërkombëtarë, ende nuk është bërë një inventar i plotë i florës dhe nuk dihet numri i saktë i taksonëve bimore. Sipas shënimeve të autorëve të ndryshëm, mendohet që në vendin tonë ka përafërsisht 2800-3000 lloje të florës vaskulare dhe deri më tani 1/3 e këtyre llojeve janë publikuar.⁵⁸

Vegjetacioni - Vegjetacioni i Kosovës klasifikohet në: 139 asociacione apo fitocenoza, 63 aleanca, 35 rende dhe 20 klasa, të cilat paraqesin ekosisteme karakteristike, të cilat janë gjithashtu habitate për shumë lloje shtazore. Vegjetacioni i livadheve të ultësirave klasifikohet në: 4 asociacione që i përkasin një aleance, një rendi dhe një klase. Ndërsa vegjetacioni i livadheve kodrinore subalpike dhe alpike klasifikohet në: 65 asociacione, 33 aleanca, 22 rende dhe 13 klasa.

Fauna - Në bazë të hulumtimeve të gjertanishme dhe shënimeve të literaturës janë prezente shumë lloje të egra të kurrizorëve, prej të cilave mund të përmendim: peshqit, ujëtokësorët, rrëshqitësit, shpezët dhe gjitarët. Pyjet e larta dhe ekosistemet malore ofrojnë kushte të volitshme për jetesën e popullatave të gjitarëve të mëdhenj si: Ariu i murrëm (*Ursus arctos*), Rrëqebulli (*Lynx lynx*), Kaprolli (*Capreolus capreolus*), Dhia e egër (*Rupicapra rupicapra*), pastaj të shumë llojeve të shpendëve grabitqare dhe këngëtare, mjaft të rëndësishme për ornitofaunën e Kosovës, Ballkanit dhe Europës. Shqiponja e maleve (*Aquila chrysaetos*), fajkoi thonjëbardhë (*Falco naummani*), pulegra (*Tetrao urogallus*) janë disa nga llojet më reprezentative të vendit, e të cilat kanë edhe status ndërkombëtar të mbrojtjes. Fauna përfaqësohet gati me të gjitha llojet që jetojnë në Gadishullin Ballkanik. Grupi më i përfaqësuar i gjitarëve për nga numri i llojeve janë brejtësit. Klasën e gjitarëve e përbëjnë insekte ngrënësit: Iriqi (*Erinaceus europaeus*), Urithi (*Talpa europae*), Rrëmihësi i rëndomtë (*Sorex araneus*) dhe brejtësit, Lepuri i fushës (*Lepus europaeus*), Miu bizam (*Ondatra zibethica*), Miu i fushës (*Arvicola terrestris*), Miu i

⁵⁸ Libri i Kuq i Florës Vaskulare, Prishtinë, 2013

shtëpisë (*Mus musculus*), Miu me vija (*Apodemus agrarius*), Miu i pyllit (*Apodemus sylvaticus*) Gjeri i madh (*Glis glis*) etj. Kurse prej mishngrënësve janë: Rrëqebulli (*Lynx lynx*), Ariu i murrëm (*Ursus arctos*), Ujku (*Canis lupus*), Dhelpra (*Canis vulpes*), Macja e egër (*Felis silvestris*) etj. Në grupin e jopërtypësve është: Derri i egër (*Sus scrofa*). Kurse ripërtypës janë: Kaprolli (*Capreolus capreolus*), Dhia e egër (*Rupicapra rupicapra*) etj. Lakuriqët (*Chiroptera*) janë shumë pak të studiuar. Në vendet ku janë vendosur kamerat janë fotografuar dhe regjistruar llojet e ndryshme të gjitarëve. Të dhënat për praninë e llojeve të faunës së egër reflektojnë gjendjen faktike në hulumtimet e diversitetit shtazor. Mirëpo, akoma ka mungesa thelbësore sa i përket të dhënave rreth popullatave për një numër të madh të llojeve shtazore, numrit të individëve, trendit të tyre dhe faktorëve që i kërcënojnë ato.

Aktivitet e realizuara për ruajtjen e faunës - Në kuadër të aktiviteteve për mbrojtjen e llojeve të rralla të faunës, Instituti i Natyrës në bashkëpunimi me Organizatën Wildlife-Albanian Photographers, KEDS-in dhe KESCO-në, ka realizuar aktivitetin për mbrojtjen e shpendëve. Si rezultat i bashkëpunimit dhe koordinimit është realizuar aktiviteti i përbashkët për vendosjen e platformave për shpendet folenizuese. Me këtë rast janë vendosur platformave për zogjtë folenizues në disa shtylla elektrike në rrethinën e komunës së Ranillugut. Platformat janë të dedikuara për llojin: Grifsha e detit (*Coracias garrullus*), dhe do të jenë strehë për te dhe gjithashtu do të shërbejnë si vend për folenizim, duke ndikuar kështu në rritjen e numrit të këtyre llojeve shumë të rëndësishme për ornifofaunën.

Ku lloj zogu shtrihet në një rajon të gjerë, duke filluar nga Evropa Perëndimore dhe Afrika Veriperëndimore e deri në nën kontinentin indian dhe më tej në bregun lindor të Azisë dhe poshtë në Azinë juglindore.

4. Ndikimet mjedisore në shëndetin e popullatës

4.1. Shëndeti publik – sëmundjet ambientale

Ndotja e mjedisit është një ndër faktorët kryesorë që ndikon në rendimin e shëndetit publik. Ndotja e ajrit nga shkarkimet e operatoreve ekonomik, transporti, djegiet nga ekonomit familjare, mbeturinat, bujqësia dhe ndotës tjerë është njëri ndër sektorët me kryesor me një risk të madh për shëndetin e popullatës. Pra, ndotja e ajrit nga emisionet ndotëse si PM2.5, PM10, NO₂ dhe SO₂ të cilat janë të zakonshme në qytetet e urbane dhe industrial, kanë një efekt të drejtpërdrejt të dëmshëm në sistemin respirator, kardiovaskular, gratë shtatzëna, fëmijët dhe personat me ndjeshmëri ndaj ndotjes.

Në raportin e fundit të OBSH mbi ndotjen e ajrit dhe ndikimet shëndetësore, konfirmohet se ndotja e ajrit vazhdon të jetë një nga kërcënimet kryesorë mjedisore dhe shëndetësore në të gjithë sferën globale. Ndotja e ajrit në ambientet e jashtëm dhe të brendshëm, shkaktojnë rreth 7 milionë vdekje të parakohshme çdo vit. Kjo ndotje është përgjegjëse për një numër të madh të sëmundjeve siç janë sëmundjet kardiovaskulare, goditjet në tru, sëmundjet kronike obstruktive të frymëmarrjes, kanceri i mushkërive dhe infeksionet akute të frymëmarrjes.⁵⁹

Në Kosovë institucionet përgjegjëse nuk kanë bërë vlerësim të ndikimit në shëndet nga shkalla e ndotjes së mjedisit, me përjashtim të projekteve të realizuar vite me parë dhe të mbështetur nga donatorët e jashtëm. Vlerësimi i ndikimit në shëndetin publik nga ndotësit mjedisor është nën përgjegjësin e MSH&IKSHPK.

Sëmundjet infektive vazhdojnë të jenë një sfidë e madhe për shëndetin publik, duke ndikuar drejtpërdrejt në cilësinë e jetës së popullsisë dhe në ngarkesën mbi sistemin shëndetësor. Analiza e të dhënave për vitet 2023 dhe 2024 ofron një pasqyrë të qartë mbi ecurinë e këtyre sëmundjeve, duke ndihmuar në vlerësimin e efikasitetit të tyre.

Gjatë vitit 2023 kemi patur nivele me të larta të këtyre sëmundjeve; Pneumonia/ARI, Influeca A, Helmimet me

⁵⁹ OBSH/ Ambient (outdoor) air pollution. (24 October 2024).

ushqim, Gastroenterokolitet, Pertussis, Infeksionet streptokoksike e grupit A.

Ndersa, për vitin 2024, kemi këtë shkallë me të lartë të sëmundjeve, si; Influenca A H3, RSV, Diare Akute, Rotavirus, Hepatiti akut B, Parotiti epidemik, Tularemia, Brucellosis, ËNV, HIV/AIDS, Echinococcus, Entameba Hystolitica.

Nëse merret si krahasim nga totali i sëmundjeve të shfaqura sipas listës së paraqitur, atëherë gjatë vitit 2024, kemi një përqindje me të vogël për 18.76%.

Tabela 23. Sëmundjet e shfaqura gjatë vitit 2023-2024⁶⁰

Sëmundja	2023 (Nr rasteve)	2023 (Incidencia/100.000)	2024 (Nr rasteve)	2024 (Incidencia/100.000)	Ndryshimi numërik	Ndryshimi (%)
COVID-19	2,153	120.81	1,735	97.36	-418	-19.4%
ITPR- Pneumonia/ ARI	16,950	951.12	17,646	990.17	+696	+4.1%
SARI	262	14.70	207	11.62	-55	-21.0%
ILI (Sëmundjet e ngjajshme me gripin)	129,315	7256.27	138,825	7789.90	+9,510	+7.36%
Influenca A	235	13.19	297	16.67	+62	+26.4%
Influenca AH1N1	47	2.64	0	0.00	-47	-100%
Influenca A H3	1	0.06	3	0.17	+2	+200%
Influenca B	179	10.04	40	2.24	-139	-77.7%
Influenca B/Victoria	29	1.63	1	0.06	-28	-96.6%
RSV	68	3.82	177	9.93	+109	+160.3%
Human Adenovirus	4	0.22	0	0.00	-4	-100%
Diarea akute	82,884	4650.88	108,077	6064.54	+25,193	+30.4%

⁶⁰ IKSHP/Buletini vjetor i sëmundjeve infektive, 2024

Variçela	10,999	617.19	6,536	366.76	-4,463	-40.6%
Sindromi meningjeal	232	13.02	155	8.70	-77	-33.2%
EHSV	2	0.11	2	0.11	0	0%
EHKK	0	0.00	1	0.06	+1	N/A
Kamptilobakter	1	0.06	0	0.00	-1	-100%
Helmime me ushqim	936	52.52	1,102	61.84	+166	+17.7%
Salmonella enteritidis	76	4.26	46	2.58	-30	-39.5%
Shigelloza	2	0.11	0	0.00	-2	-100%
Adenovirus	0	0.00	21	1.18	+21	N/A
Enterovirus	0	0.00	16	0.90	+16	N/A
Norovirus	0	0.00	3	0.17	+3	N/A
Clostridium difficile	2	0.11	0	0.00	-2	-100%
E.coli (O 157)	0	0.00	0	0.00	0	0%
E coli patogjene	2	0.11	4	0.22	+2	+100%
Rotavirus	73	4.10	93	5.22	+20	+27.4%
Gastroenterokolitet	398	22.33	764	42.87	+366	+91.96%
Hepatiti akut A	3	0.17	2	0.11	-1	-33.3%
Hepatiti akut B	37	2.08	40	2.24	+3	+8.1%
Hepatiti akut C	4	0.22	3	0.17	-1	-25%
Ethe tifoide	0	0.00	0	0.00	0	0%
Morbilli	1	0.06	1	0.06	0	0%
Parotiti epidemik	30	1.68	32	1.80	+2	+6.7%
Pertussis	2	0.11	209	11.73	+207	+10,350%
TBC	0	0.00	0	0.00	0	0%
Tularemia	4	0.22	10	0.56	+6	+150%
Brucellosis	33	1.85	55	3.09	+22	+66.7%
Leishmaniazë	7	0.39	1	0.06	-6	-85.7%
Leptospirosis	5	0.28	3	0.17	-2	-40%
Toxoplasmosis	8	0.45	6	0.34	-2	-25%

WNV	1	0.06	7	0.39	+6	+600%
Malarie	3	0.17	4	0.22	+1	+33.3%
Sëmundja Lyme	12	0.67	8	0.45	-4	-33.3%
TB	585	32.83	466	26.15	-119	-20.34%
HIV/AIDS	20	1.12	34	1.91	+14	+70%
IST	480	26.93	400	22.45	-80	-16.6%
Echinococcus	2	0.11	5	0.28	+3	+150%
Mpox	0	0.00	1	0.06	+1	N/A
Parazitoza	20	1.12	0	0.00	-20	-100%
Askariaza	7	0.39	0	0.00	-7	-100%
Giardiaza	46	2.58	30	1.68	-16	-34.8%
Entameba Hystolitica	1	0.06	2	0.00	+1	+100%
Clostridium difficile	2	0.11	0	0.00	-2	-100%
Infeksione streptokoke e grupit A	0	0.00	119	6.68	+119	N/A
Sëmundje tjera ngjitëse	178	9.99	223	12.51	+45	+25.3%
Totali	245,754	13790.02	277,412	15566.45	+31,658	+12.9%

4.2. Cilësia e ujit të pijes

Cilësia e ujit të pijes në Kosovë, sipas raporteve më të fundit, është në nivel të kënaqshëm për pjesën më të madhe të popullatës që furnizohet nga sistemet publike të ujësjellësit. Sipas raportit të fundit të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKSHPK), përputhshmëria me standardet e cilësisë së ujit të pijshëm ka arritur në 98.84% në vitin 2024, ndërsa trendi i përmirësimit ka vazhduar nga viti në vit. Kjo do të thotë se në pjesën më të madhe të vendit, uji që del nga rubinetet e qytetarëve është i sigurt për konsum, pasi monitorohet dhe kontrollohet rregullisht nga autoritetet përkatëse. Parametrat që kontrollohen përfshijnë analizat mikrobiologjike dhe fiziko-kimike, të cilat duhet të jenë brenda kufijve të përcaktuar nga legjislacioni vendor dhe direktivat europiane për ujin e pijshëm.

Uji i trajtuar në sistemet qendrore, si p.sh. në Prishtinë dhe Mitrovicë, përmbush të gjitha standardet e parapara dhe konsiderohet i shëndetshëm për konsum. Përpunimi dhe dezinfektimi i ujit bëhet në mënyrë të rregullt, ndërsa rezultatet laboratorike tregojnë se parametrat kimikë dhe bakteriologjikë janë brenda normave të lejuara.

Megjithatë, probleme të cilësisë janë evidentuar në disa zona rurale dhe në raste të veçanta, sidomos në komuna të caktuara si Klina apo disa fshatra të Deçanit, ku janë raportuar ndotje mikrobiologjike ose kimike për shkak të infrastrukturës së vjetër, ndotjes së burimeve ose mungesës së trajtimit adekuat të ujit⁶¹. Po ashtu, uji i puseve private, sidomos ai që nuk trajtohet, mund të jetë i rrezikshëm për konsum pa analizë paraprake, pasi shpeshherë nuk i nënshtrohet kontrollit të rregullt dhe mund të përmbajë ndotës ose mikroorganizma të dëmshëm.

Uji i ambalazhuar në Kosovë, sipas raportimeve dhe nga ajo çfarë shohim në terren, nuk është gjithmonë i sigurt dhe shpeshherë nuk përmbush standardet e kërkuara, prandaj rekomandohet që konsumatorët të jenë të kujdesshëm dhe të përdorin kryesisht ujin e trajtuar nga ujësjellësit publik.

Institucioni përgjegjës, si IKSHPK, ka rol kyç në monitorimin dhe garantimin e cilësisë së ujit të pijshëm, duke realizuar analiza të rregullta dhe duke ndërmarrë masa në rast të rrezikimit të cilësisë së ujit.

Synimi strategjik i Kosovës është që deri në vitin 2027 të rritet përputhshmëria e cilësisë së ujit në 99.5% dhe mbulueshmëria me ujë të sigurt të arrijë në 90% të popullatës.

Përfundimisht, uji i pijshëm nga ujësjellësit publik në Kosovë konsiderohet i sigurt dhe cilësor për konsum, ndërsa duhet pasur kujdes me ujin nga burime të pavarura, si puset, të cilat kërkojnë analizë të rregullt para përdorimit.

Siç paraqitet në tabelën 24, gjatë vitit 2024 është prezantuar norma e pajtueshmërisë (%) së analizave mikrobiologjike dhe

⁶¹ Rilindja Gjellbër (2024) Raport i cilësisë së ujërave sipërfaqësore në katër pellgjet lumore të Kosovës.

fiziko-kimike të ujit të pijshëm me standardet vendore të cilësisë për secilën nga Kompanitë Rajonale të Ujësjellësit (KRU) në Kosovë, duke dëshmuar një përmirësim të ndjeshëm në krahasim me vitin e kaluar.

Tabela 24. Norma (%) e pajtueshmëris së testeve bakteriologjike dhe fiziko-kimike me standardet vendore të cilësisë së ujit KRU-ve, 2024⁶²

Kompanitë Regjionale		Mikrobiologjike	Fiziko-Kimike	Mesatarja për KRU
1.	KRU - Prishtina	98.9%	99.5%	99.2%
2.	KRU - Hidroregjioni Jugor	100.0 %	100%	100.0%
3.	KRU - Hidrodrini	97.3%	94.8%	95.9%
4.	KRU - Mitrovica	99.5%	99.8%	99.7%
5.	KRU - Gjakova	100 %	100.0%	100.0%
6.	KRU - Bifurkacioni	95.8%	96.7%	96.3%
7.	KRU - Khidromorava	99.7%	99.0%	99.4%
KRU - Mesatarja e përgjithshme		98.9%	98.0%	98.84%

Mesatarja e përgjithshme për të gjitha KRU-të është shumë e lartë: 98.9% për parametrat mikrobiologjikë dhe 98.0% për ata fiziko-kimikë, me një mesatare të përgjithshme prej 98.84%. Kjo tregon se uji i shpërndarë nga sistemet publike është në përputhje pothuajse të plotë me standardet e kërkuara dhe është i sigurt për konsum në pjesën më të madhe të rasteve.

KRU Hidroregjioni Jugor dhe KRU Gjakova kanë arritur 100% pajtueshmëri në të dy parametrat në vitin 2024, çka tregon performancë të shkëlqyer. KRU - Prishtina, Mitrovica, KRU Hidromorava kanë vlera mbi 99%, që konsiderohen shumë të larta dhe tregojnë kontroll të mirë të cilësisë. KRU -

⁶² Niveli i shërbimeve të ofruara nga ofruesit e licencuar- Përputhshmëria me kushtet e licencës, ARRU 2024

Bifurkacioni dhe KRU - Hidrodrini kanë vlera pak më të ulëta, përkatësisht 96.3% dhe 95.9% në mesatare, duke sugjeruar se ka raste të izoluara kur uji nuk ka përmbushur plotësisht standardet, por gjithsesi niveli është i kënaqshëm.

Parametri mikrobiologjik është thelbësor për sigurinë shëndetësore, pasi ndotja bakteriale mund të shkaktojë sëmundje të menjëhershme. Vlerat mbi 95% tregojnë kontroll të mirë, por çdo devijim duhet të adresohet me masa të menjëhershme.

Parametri fiziko-kimik lidhet me përbërjen kimike të ujit (si nitratet, metalet, etj.). Vlerat mbi 94% të paraqitura në tabelë janë dukshëm shumë të mira, por kërkojnë monitorim të vazhdueshëm, sidomos në zonat ku ka devijime.

Të dhënat tregojnë një nivel shumë të lartë të sigurisë dhe cilësisë së ujit të pijshëm në të gjitha rajonet kryesore të Kosovës, me disa dallime të vogla që mund të lidhen me faktor lokal si infrastruktura, burimet e ujit, ose menaxhimi i rrjetit. Çdo devijim nga 100% duhet të shërbejë si sinjal për përmirësim të mëtejshëm, por përgjithësisht, konsumatorët mund të kenë besim në ujin e shpërndarë nga këto kompani.

Krahasuar me vitin e kaluar, cilësia e përgjithshme e ujit të pijshëm të ofruar nga Kompanitë Rajonale të Ujësjes në Kosovë ka shënuar përmirësim gjatë vitit 2024, duke u rritur nga një mesatare prej 96.6% në 98.84%, si rezultat i përmirësimeve të dukshme si në parametrat bakteriologjikë, ashtu edhe në ata fiziko-kimik.

4.3. Ndikimi i cilësisë së ajrit në shëndet

Ndotja e ajrit dëmton kualitetin e jetës të secilit person. Ndotja e ajrit dhe ekspozimi i trupit të njeriut varësisht nga gjendja shëndetësore mund të ndikoi në dëmtimin e funksionit të mushkërive, të infeksionet e organeve të frymëmarrjes, kancerin e mushkërive, shfaqje dhe rendim të astmës, ndjenjë të disharmonisë ndërmjet trupit dhe mjedisit etj.

Një pjesë e shoqërisë akoma jeton në kushte jo të mira socio-

ekonomike, e cila është një tregues se kjo pjesë mund të jetë me e prekur si rezultat i mungesës së mjeteve financiare për kujdesin shëndetësorë dhe jetesës në afërsi të vendeve me kualitet me të dobët të ajrit.

Vlerat referente për cilësinë e ajrit të përcaktura në legjislacionin nacional, në Direktvën e Be-së për Cilësi të Ajrit dhe nga OBSH janë prezantuar në tabelën në vijim.

Tabela 25. Normat referente nacionale, të BE dhe të OBSH për cilësinë e ajrit

Ndotësi	Vlerat limite	Udhëzimi Administrativ Nr.02/2011	Direktiva e BE për Cilësi të Ajrit 2015/1480	Udhëzimet e OBSH 2021
PM _{2.5}	Vjetore	25 µg/m ³	25 µg/m ³	5 µg/m ³
	Ditore (24 h)	-	-	15 µg/m ³
PM ₁₀	Vjetore	40 µg/m ³	40 µg/m ³	15 µg/m ³
	Ditore (24 h)	50 µg/m ³	50 µg/m ³	45 µg/m ³
O ₃	Piku i sezonit ⁶³	-	-	60 µg/m ³
	8-orëshe	120 µg/m ³	120 µg/m ³	120 µg/m ³
NO ₂	Vjetore	40 µg/m ³	40 µg/m ³	10 µg/m ³
	1 orëshe	200 µg/m ³	200 µg/m ³	200 µg/m ³
SO ₂	Ditore (24 h)	125 µg/m ³	125 µg/m ³	20 µg/m ³
	1 orëshe	350 µg/m ³	350 µg/m ³	-
CO	8-orëshe	10 mg/m ³	10 mg/m ³	10 mg/m ³

Gjatë vitit 2024, Agjencia e Mjedisit të Evropës (EEA) ka publikuar raportin “Cilësia e ajrit në Evropë 2024, Ndikimi në shëndet i ndotjes së ajrit”. Raporti i referohet edhe të dhënave të monitorimit të cilësisë së ajrit nga rrjeti nacional që menaxhohet nga IHMK, dhe ka bërë po ashtu edhe një vlerësim mbi ndikimin në shëndet nga ndotja e ajrit edhe për Kosovë.

Sipas raportit ekspozimi ndaj koncentrimit të PM_{2.5} ishte i

⁶³ Muaji i gjashtë radhazi i vitit me përqendrimin më të lartë të ozonit gjatë gjashtë muajve të fundit.

ndërlidhur me 2,370 vdekje të parakohshme, ndërsa ekspozimi ndaj koncentrimi të NO₂ ishte i ndërlidhur me 240 vdekje të parakohshme. Krahasuar me vlerësimin e vitit 2023, ka në rënie të koncentrimet vjetor të ndotësve PM_{2.5} dhe NO₂ dhe po ashtu edhe rënie të vdekjeve të ndërlidhura me këta ndotës.

Tabela 26: ndërlidhja e vdekjeve të parakohshme me nivelin e koncentrimet të ndotjes së ajrit⁶⁴

	Vlerësimi 2024			Vlerësimi 2023		
	Kosova	BE 27	Evropa Gjithsejtë	Kosova	BE 27	Evropa Gjithsejtë
Mesatarja vjetore µg/m ³ (PM _{2.5})	16.5	11.4	11.5	19.40	11.2	11.4
Vdekje të parakohshme (PM _{2.5})	2,370	239,000	269,000	3,059	237,810	274,673
Mesatarja vjetore µg/m ³ (NO ₂)	13.6	14.1	15.7	14.4	14.1	15.7
Vdekje të parakohshme (NO ₂)	240	48,000	66,000	264	48,555	64,312

⁶⁴ “Cilësia e ajrit në Evropë 2024, Ndikimi në shëndet i ndotjes së ajrit”, EEA 2024 (<https://www.eea.europa.eu/en/topics/in-depth/air-pollution/air-pollution-country-fact-sheets-2024/kosovo-air-pollution-country-fact-sheet-2024>)

5. Gjendja e mjedisve të rrezikuara

5.1. Gjendja mjedisore në zonën e veprimit të KEK-ut

Aspektet mjedisore përgjatë të gjithë zinxhirit të prodhimit të energjisë në KEK janë jashtëzakonisht të ndjeshme dhe komplekse për shkak të përmasave të mëdha të operacioneve. Ndotja nga pluhuri dhe emetimet e gazrave nga termocentralet, zënia e tokës bujqësore si rezultat i aktiviteteve minerare, ndotja akustike (zhurma), depozitimi i sasive të mëdha të hirit, përdorimi i vajrave teknologjikë dhe konsumi i konsiderueshëm i ujit për proceset teknologjike – që shpesh shoqërohet me ndotje të ujërave – e vendosin KEK-un ndër aktorët më të rëndësishëm dhe njëkohësisht më sfidues në aspektin mjedisor në vend. Një nder treguesit e operimit si; shfrytëzimi i thëngjillit dhe prodhimi i energjisë, shkarkimet e emisioneve ndotëse në ujëra janë ndër faktorët kryesorë se mjedisi në këtë zonë është nën presionin e vazhdueshëm nga ndotja.

Tabela 27. Treguesit kryesor të operimit të KEK-ut, gjatë vitit 2024⁶⁵

Treguesit	2023	2024
Prodhimi vjetor i energjisë elektrike nga `TC Kosova A`	2,290,512 (MW/h)	2,221,294 (MW/h)
Prodhimi vjetor i energjisë elektrike nga `TC Kosova B`	3,243,685 (MW/h)	3,957,078 (MW/h)
Harxhimi i përgjithshëm i linjtit	7,437,452 (t)	-
Sasia e përgjithshme e hirit të prodhuar	1,086,754 (t)	1,228,337 (t)
Konsumi i ujit të dekarbonizuar dhe të demineralizuar `TCA` dhe `TCB`	19,373,762 (m ³)	19,045,965 (m ³)

Gjatë veprimtarive të përditshme në hapësirat e termocentraleve, si dhe gjatë procesit të eksploatimit të qymyrit në DPQ dhe prodhimit të energjisë elektrike, gjenerohen sasi të ndryshme të mbeturinave. Këto mbetje përfshijnë jo vetëm

⁶⁵ Raport Vjetor për Gjendjen e Mjedisit në KEK, 2024

hedhurina që mbesin si rezultat i procesit prodhues, por edhe ato që krijohen si pasojë e renovimit të pajisjeve, intervenimeve për mirëmbajtje dhe riparimeve të defekteve teknike dhe teknologjike.

Tabela 28. Mbeturinat metalike, Aku bateri, vajra, yndyrë, gjatë vitit 2024

Termocentralet-2024	Mbeturinat metalike, Aku bateri, vajra, yndyrë, gjatë vitit 2024	Sasia
Materialet jashtë përdorimit në TCA	Aku- Bateri stacionare - Industriale	1,360.00 (kg)
	Aku- Bateri të automjeteve	900.00 (kg)
Materialet jashtë përdorimit në TC-B	Vajra të përdorura jashtë përdorimit	49,312 (lit.)
	Vajra Bifenile të plikloruara-PCB	20,000 (lit.)
	Mbeturina të ndryshme metalike	1,300 ton
	Aku- bateri stacionare industriale	5,025 kg
Vajrat jashtë përdorimit në DPQ	Vaj motori	1100 (lit.)
	Vaj motori	2770 (lit.)
	Vaj hidraulik	360 (lit.)
	Vaj ndërruesi	200 (lit.)
	Vaj hidraulik	3195 (lit.)
Yndyrë në DPQ	Yndyrë	360 (lit.)
Mbeturina metalike jashtë përdorimit në DPQ	Aku- Bateri të automjete të rënda	2,400.00 (kg)
	Aku- Bateri të veturave	600.00 (kg)
	Automjete motorike	335,000.00 kg

Referuar të dhënave nga tabela përkatëse, rezulton se në magazinat e TC-B janë grumbulluar sasi të konsiderueshme të vajrave të ndryshëm, të cilët janë nxjerrë nga pajisje dhe makineri të ndryshme. Këto vajra klasifikohen si të papërdorshëm dhe përbëjnë mbetje potencialisht të rrezikshme për mjedisin. Për shkak të natyrës së tyre dhe rrezikut që paraqesin për ambientin e punës dhe mjedisin e zonës, kërkohet me urgjencë ndërmarrja e hapave të nevojshëm për trajtimin e tyre në përputhje me standardet përkatëse të mbrojtjes së mjedisit.

Presioni mjedisor në këtë zonë vjen edhe nga shkarkimet e emisioneve ndotëse dhe grimcave të pluhurit.

Tabela 29. Emisionet vjetore në ajër për ndotësit SO₂, NO_x dhe pluhurin total nga `TCA` dhe `TCB` 2023-2024

TC	SO ₂ (t/vit)		NO _x (t/vit)		Pluhuri total (t/vit)	
	2023	2024	2023	2024	2023	2024
Totali	10,495 (t/vit)	11,712.2 (t/vit)	11,384.7 (t/vit)	16,852.29 (t/vit)	4,742.99 (t/vit)	5,605.32 (t/vit)

5.2. Gjendja mjedisore në zonën e veprimit të Feronikelit

Gjatë vitit 2024, fabrika e Feronikelit nuk ka qenë në funksion, që nënkupton se në periudhën janar - dhjetor të këtij viti nuk është realizuar asnjë aktivitet prodhues. Si rrjedhojë, nuk është kryer monitorimi i rregullt i parametrave kryesor mjedisor, përfshirë cilësinë e ajrit, ujit dhe tokës, dhe nuk janë ndërmarrë masa për minimizimin e ndikimit potencial në mjedis. Megjithatë, mbeten shqetësuese gjendja aktuale e deponive të kompanisë, veçanërisht ajo në deponinë e skories dhe në minierën e Gllavicës. Këto lokacione paraqesin rrezik të mundshëm për ndotje mjedisore dhe kërkojnë vëmendje të veçantë dhe ndërhyrje adekuate për të parandaluar dëmtimet e mëtejshme në mjedis dhe shëndetin publik.

5.3. Gjendja mjedisore në zonën e veprimit të Sharrcem

Në vitin 2024, kompania Sharrcem është rilicensuar për herë të dytë, pas plotësimit të të gjitha kushteve mjedisore për lejen e integruar, Parandalimi dhe Kontrolli i Integruar i Ndotjes (IPPC), e cila është lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Kjo leje, që do të mbetet në fuqi për 10 vitet e ardhshme, është një dëshmi e angazhimit të kompanisë Sharrcem për të respektuar dhe përmbushur standardet më të larta mjedisore, si dhe për të menaxhuar me përgjegjësi ndikimet në mjedis.

Emetimet në ajër – gjatë vitit 2024, emetimet e SO_x dhe NO_x nga Sharrcem kanë qenë brenda kufijve të lejuar, sipas lejes IPPC dhe rregulloreve të Bashkimit European. Në krahasim me vitin 2023, mesatarja e emetimeve të NO_x ka pësuar një rritje prej 24%, duke arritur në 422 mg/Nm³, ndërkohë që vlera e lejuar mbetet 500

mg/Nm³. Nga ana tjetër, mesatarja e emetimeve të SO_x është ulur me rreth 35%, duke arritur në 106 mg/Nm³, dhe mbetet nën kufirin e lejuar prej 200 mg/Nm³.

Menaxhimi i ujërave - Sharrcem ka bërë hapa të rëndësishëm në drejtim të menaxhimit të ujërave. Gjatë vitit 2024, Sharrcem ka realizuar investime të rëndësishme në sistemet e riciklimit të ujit dhe në përmirësimin e rrjetit ekzistues të ujit, duke çuar në një përdorim më efikas të ujit. Këto përmirësime janë shoqëruar me zhvillimin dhe implementimin e sistemeve të avancuara të menaxhimit të ujit, që përfshijnë instalimin e matësve të rinj për monitorim të zgjeruar.

Për më tepër, konsumi i ujit është ulur me rreth 50% krahasuar me vitin e 2023 falë investimeve në përmirësimin e infrastrukturës së rrjetit të ujit të fabrikës. Gjatë vitit 2024 është realizuar gjithashtu një studim fizibiliteti për trajtimin e ujërave sipërfaqësore.

Në të gjitha indikatorët mates, tregon një rënie të konsumit në vitin 2024 krahasuar me 2023. Konsumi total i ujit dhe ai specifik kanë pësuar ulje gati 50%, duke treguar përmirësime të mëdha në efikasitetin e përdorimit të ujit.

Shkarkimi i ujit nga impianti i trajtimit (WWTP) është ulur në krahasim me konsumin, që mund të tregojë se një pjesë e madhe e ujit të përdorur po trajtohet dhe riciklohet. Shkarkimi total i ujit nga WWTP ka pësuar ndryshime midis viteve 2023 dhe 2024, duke shënuar një ulje prej 6,000 m³. Në përgjithësi, ulja e shkarkimeve mund të konsiderohet një tregues pozitiv për përmirësimin e menaxhimit të ujit dhe për reduktimin e ndikimit mjedisor.

Tabela 30. ndryshimet e indikatorëve matës për vitet 2023-2024⁶⁶

Indikator	2023	2024	Ndryshimi
Konsumi total i ujit (1000 m ³ /vit)	107,000 m ³ /vit	54,000 m ³ /vit)	Ulje prej 53,000 m ³ /vit
Konsumi specifik i ujit për produktet e çimentos (l/t çimento)	154 l/t	78 l/t	Ulje prej 76l/t
Shkarkimi total i ujit nga WWTP (1000 m ³ /vit)	24,000 m ³	18,000 m ³	Ulje prej 6,000 m ³ /vit

Menaxhimi i mbeturinave - gjatë vitit 2024 ka një ulje të gjenerimit të disa kategorive të mbetjeve si scrap, mbetje nga demolimet dhe paleta të drurit. Këto ndryshime mund të tregojnë përmirësime në procese, riciklim dhe përdorim më efikas të materialeve. Megjithatë, disa kategori, si tullat për murim të furrës, kanë shënuar një rritje të konsiderueshme, kjo mund të lidhet me ndryshime në proceset e prodhimit, kërkesën për këtë material, ose mundësitë për riciklimin e tij.

Tabela 31. gjenerimi i mbeturinave sipas kategorive nga Sharcem për vitin 2024

Viti	Mbetje të përziera komunale (t/v)	Scrap (t/v)	Tulla për murim të furrës (t/v)	Thasë të shqyer të cem. (t/v)	Letër dhe karton (t/v)	Mbetje nga demoli met (t/v)	Paleta të drurit (m3/v)	Vajra të përdorur (t/v)
2023	59.8	211.8	274.0	22.7	2.7	506.8	30.8	0.3
2024	59.7	171.08	720.6	22.7	2.7	267.2	14.3	0.2

5.4. Format tjera të mjediseve të rrezikuara

Në Republikën e Kosovës ekzistojnë një numër i caktuar i minierave të zhvilluara (minierat kyçe), si dhe një numër i vendburimeve më parë të vlerësuara, por të pazhvilluara. Miniera të zhvilluara (kyçe) janë: miniera “Trepça” në Stantërg,

⁶⁶ Raporti Vjetor për Mjedisin, Sharcem - 2024

Hajvalia, Badofci, Kizhnica, Artana, Belloberda dhe Cërnaci, miniera këto që janë të vlerësuar me ndikim të madh në mjedis. Deponite e krijuara nga eksploatimi i minierave, prodhimit industrial dhe mbeturinave urbane paraqesin një ndër presionet me të larta me ndikim në mjedis. Eksploatimi i minierave kryesisht atyre të pasura me plumb, zink dhe metale tjera të rënda ka rezultuar në gjenerimin masiv të mbeturinave me prezencë dhe koncentrim të lartë të metaleve të rënda.

Këto mbeturina janë depozituar në lokacione të ndryshme që në disa zona paraqesin një rrezik potencial të kontaminimit të tokave bujqësore, burimeve ujore, rrjedhjeve të ujit, zonave të banueshme, etj. Këtyre deponive me potencial të rrezikshëm për mjedisin ju shtohen edhe ato të mbeturinave urbane të cilat operojnë pa i respektuar standardet sipas legjislacionit mjedisor.

Sasia e mbeturinave të rrezikshme nga koncentrimi i xeheve minerare në total është rreth 60 milion ton e deponuar në tetë deponi Kelmend Mitrovicë; Gornje Polje Zveçan; Zhitkoc Zveçan; Bostanishte Leposaviq; Gornji Kërnjin Leposaviq; Staro Jalovishte Kizhnicë; Badovc; dhe Mareci 1 & 2 Artanë. Kompleksi i minierave Artanë, Hajvali, Badovc, Kishnicë, shtrihet në pjesën lindore të vendit në një sipërfaqe rreth 400 km² dhe që përfshin territoret e disa komunave: Graçanicë (minierat Hajvalia, Badovci, Kizhnica dhe flotacioni në Kizhnicë), Artanës, (miniera Artana dhe fushat mineral mbajtëse Përroi i Thartë dhe Kaltrina) dhe Podujevës (miniera në hapje “Çuka e Batllavës”). Minierat Cërnac dhe Belo Bërd shtrihen në pjesën veriore të Kosovës, kurse flotacioni i përbashkët i këtyre minierave është i vendosur në Leposaviq.⁶⁷ I gjithë ky territor në një formë të renduar apo të lehtë është në presionin e shkarkimeve të emisioneve ndotëse me theks të veçantë me metale të rënda.

⁶⁷ *Kadastr i mbeturinave të rrezikshme dhe kimikateve në Kosovë, KIWER Consulting - Kosovo Institute for Water and Environmental Research, 2020.*

Presionit në mjedis i kontribon vend depozitimi i mbeturinave të rrezikshme të cilat gjenden në 17 vende të ndryshme , në të cilën janë gjeneruar dhe trasheguar nga sektoret e ndryshëm. Edhe pse disa prej ketyre monitorohen nga MMPHI, FSK dhe KFOR, këto mbeturina paraqesin një burim ndotës me rrezikshme të lartë për mjedisin dhe shëndetin e qytetareve. Që nga viti 1999 e deri me sot, mbeturina e rrezikshme tani të lokalizuara nuk kanë gjetur zgjidhje të asgjesimit apo trajtimit të tyre.

Një problematikë mjedisore janë edhe deponitë ilegale të mbeturinave në të cilën nga raportet e dërguara nga 30 komunat e Kosovës për vitin 2024 janë gjithësejt 458. Ky numër është edhe me i madh me faktin se 8 komuna tjera nuk kanë raportuar për ekzistimin e deponive ilegale në territorin e tyre. Deponitë ilegale të mbeturinave janë të identifikuara në lokacione të ndryshme, si afër vendbanimeve, lumenjeve, natyrë, afër rrugës etj.

6. Zbatimi i strategjisë, planit të veprimit dhe planeve sanuese për mjedis

6.1. Zbatimi i strategjive dhe planeve mjedisore

Tabela 32: Niveli i zbatimit të strategjive dhe planeve të veprimit për sektorin e mjedisit për vitin 2024

Strategjia/Plani	Periudha e vlefshmërisë	Statusi i dokumentit	Niveli i zbatimit
Strategjia për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Zhvillimin e Qëndrueshëm Pjesë e strategjisë janë edhe Strategjia për Cilësinë e Ajrit dhe Strategjia për Biodiversitetin.	2023-2033	Në proces të hartimit	Në proces të hartimit - rishikimit
Strategjia për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave në Kosovë	2024-2035	Aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës	Zbatohet në vazhdimësi
Plani i Veprimit për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave në Kosovë	2024-2026	Aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës	Zbatohet në vazhdimësi
Strategjia dhe Plani Veprimit për Ndryshimet Klimatike për Kosovën	2018-2027	Aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës Vendimi, Nr. 05/90, datë 19.02.2019	Zbatimi në vazhdimësi
Rishikimi i Strategjisë Shtetërore e Ujërave të Kosovës - rishikimi për periudhën 2023-2027	2023-2027	Aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës	Zbatimi në vazhdimësi

Plani i veprimit për ujërat	2023-2025	Aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës	Zbatimi në vazhdimësi
Plani Nacional Për Energji dhe Klimë i Republikës së Kosovës (Drafti i parë)	2023-2025	Në proces të hartimit	Në proces të hartimit
Plani Hapësinor i Kosovës - Strategjia për Zhvillimin Hapësinor të Kosovës (Rishikimi i planit 2010-2020+)	2023-2028	Në proces të rishikimit	Në proces të rishikimit
Plani Hapësinor për Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna"	2023-2033	Miraturuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Publikuar në Gazetën Zyrtare me datë 05.07.2023	Në fazën fillestare
Plani Menaxhues për Parkun Kombëtar "Sharri"	2015-2024 (në proces të rishikimit)	Aprovuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	Pjesërisht

6.2. Zbatimi i planeve lokale për mjedis

Tabela 33: Planet mjedisore në nivel lokal 2024

Komuna	Plani Lokal i Veprimt në Mjedis	Plani Lokal i Veprimt për Mbeturina	Plani Lokal i Veprimt për Biodiversitet	Plani Lokal i Veprimt për Cilësi të Ajrit	Plani Lokal i Mobilitetit
Deçan	+	+	-	-	-
Dragash					
Drenas	+	+	-	+	+
Fushë Kosovë	-	+	-	+	+
Ferizaj	+	+	-	-	Draft
Gjakovë	+	+	+	Draft	-
Gjilan					
Gracanicë					
Hani i Elezit	+	+	-	+	-
Istog					
Junik	-	-	-	-	-
Kaçanik					
Kamenicë	Draft	+	-	-	-
Klinë	Draft	+	-	Draft	-
Kllokot					
Lipjan	Draft	+	-	-	-
Malishevë					
Mamushë					
Mitrovicë e Jugut	+	+	-	-	+
Novobërdë					
Obiliq	Draft	+	-	+	-
Partesh					
Pejë					
Podujevë					
Prishtinë					
Prizren					
Rahovec	+	+	+	+	+
Ranillug	Draft	+	-	-	-
Shtërpce					

Shtime	+	+	+	-	-
Skënderaj					
Therandë					
Viti	+	+	Draft	-	+
Vushtrri	+	+	-	-	Draft
Mitrovicë e Veriut					
Zubin Potok					
Zveçan					
Leposaviq	-	-	-	-	-

7. Masat e ndërmarra për mbrojtjen e mjedisit, sukseset nga masat e ndërmarra dhe efektin e tyre në zhvillimin ekonomik

7.1. Hartimi i legjislacionit mejdisor shtetëror

Me qëllim të mbrojtjes së mjedisit dhe promovimit të zhvillimit të qëndrueshëm, Kuvendi i Kosovës, Qeveria me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) dhe Ministrinë e Ekonomisë (ME), gjatë vitit 2024 kanë miratuar sërë ligjesh dhe aktesh nënligjore të cilat synojnë të forcojnë kornizën ligjore për mbrojtjen e mjedisit në Kosovë.

Ky legjislacion është hartuar me qëllim të ruajtjes dhe menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore, mbrojtjes së biodiversitetit, përmirësimit të cilësisë së ajrit dhe ujit, reduktimit të ndotjes dhe nxitjes së përdorimit të energjisë së ripërtëritshme. Në veçanti, këto masa kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në cilësinë e jetës së qytetarëve, duke reduktuar ndotjen dhe duke kontribuar në mbrojtjen e shëndetit publik.

Përmes pesë ligjeve të miratuara nga Kuvendi i Kosovës, janë vendosur standarde të reja në fusha kyçe të mbrojtjes së mjedisit, duke përfshirë promovimin e energjisë së ripërtëritshme, performancën energjetike të ndërtesave, ndryshimet klimatike dhe menaxhimin e rrugëve në përputhje me parimet e zhvillimit

të qëndrueshëm. Në këtë drejtim, Ligji për Ndryshime Klimatike synon të krijojë një bazë të fortë ligjore për reduktimin e ndotjes dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, ndërsa Ligji për Promovimin e Përdorimit të Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë inkurajon investimet në burime alternative dhe të pastra të energjisë.

Për më tepër, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës ka nxjerrë gjashtë udhëzime administrative që adresojnë çështje të rëndësishme si kontrolli i ndotjes industriale, përcaktimi i standardeve të cilësisë së ajrit dhe mbikëqyrja e rregullsisë teknike të automjeteve për të reduktuar ndikimin e tyre në ndotjen e mjedisit. Këto udhëzime ndihmojnë në zbatimin e standardeve mjedisore në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare.

Nga ana tjetër, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ka ndërmarrë masa për të rregulluar menaxhimin e pyjeve, përdorimin e plehrave artificiale dhe ruajtjen e biodiversitetit, duke vendosur udhëzime për vlerësimin dhe kompensimin e kafshëve të asgjësuara për shkak të sëmundjeve infektive. Këto masa janë të rëndësishme për të ruajtur ekosistemet natyrore dhe për të siguruar përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore.

Ministria e Ekonomisë ka kontribuar me një udhëzim administrativ që rregullon procesin e ofertimit konkurrues për dhënie të mbështetjes për energjinë e ripërtëritshme, duke synuar të krijojë kushte të favorshme për investime në këtë sektor dhe të promovojë një ekonomi më të pastër dhe të qëndrueshëm.

Ky legjislacion është një hap i rëndësishëm drejt përmbushjes së standardeve mjedisore dhe përafrimit me legjislacionin evropian, duke përmirësuar cilësinë e jetës për qytetarët e Kosovës dhe duke krijuar një bazë të fortë për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik.

Përmes këtyre masave, Kosova synon të reduktojë ndikimet negative të ndotjes, të mbrojë burimet natyrore dhe të nxisë një ekonomi të gjelbër që garanton mirëqenien e brezave të ardhshëm.

Tabela 34: Ligjet në fushën e mjedisit të aprovuara nga Kuvendi i Kosovës gjatë vitit 2024

Emri i ligjit	Data e publikimit
Ligji Nr. 08/1-283 për Harmonizimin e Ligjeve të Veçanta me Ligjin Nr. 05/1-087 për Kundërvajtje	26.12.2024
Ligji Nr. 08/1-242 për Performancën Energjetike të Ndërtesave	12.06.2024
Ligji Nr. 08/1-258 për Promovimin e Përdorimit të Burimeve të Ripërtërishme të Energjisë	02.05.2024
Ligji Nr. 08/1-250 për Ndryshime Klimatike	05.01.2024
Ligji Nr.08/1-275 për Rrugët	20.11.2024

Tabela 35: Udhëzimet administrative të nxjerra nga MMPHI

Emri i udhëzimit administrativ	Data e publikimit
Udhëzim Administrativ (MMPHI) Nr. 18 /2024 për Formën, Përmbajtjen dhe Mënyrën e Plotësimit të Aplikacionit për Leje Mjedisore të Integruar	16.12.2024
Udhëzim Administrativ (MMPHI) Nr.17/2024 për caktimin e Vlerës së Tarifës për Shërbimet Lidhur me Procesin e Parandalimit dhe Kontrollit të Integruar të Ndotjes	28.10.2024
Udhëzim Administrativ(MMPHI) Nr. 16 /2024 për Vlerat Kufitare, Vlerat e Synuara, Pragjet e Alarmit për Arsenin, Kadmiumin, Merkurin, Nikelin dhe Nidrokarburet Aromatike Policiklike në Ajër	02.10.2024
Udhëzim Administrativ(MMPHI) Nr.01/2024 për Kontrollin e Rregullsisë Teknike të Automjeteve në Rrugë	07.03.2024
Udhëzim Administrativ MMPHI Nr.03/2024 për Kriteret për Zgjedhjen e Lokacionit të Deponive si dhe Kushtet Teknike Sipas Destinimit të Tyre	05.03.2024
Udhëzim Administrativ MMPHI Nr.02/2024 për Përcaktimin e Kushteve, Kriteve dhe Procedurave për Lëshimin e Lejes për Import, Eksport dhe Kalim Tranzit të Mbeturinave	01.03.2024

Tabela 36: Udhëzimet Administrative të nxjerra nga Ministria e Bujqesisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Emri i udhëzimit administrativ	Data e publikimit
Udhëzim Administrativ (MBPZHR)-Nr. 13/2024 për vlerësimin dhe kompensimin e kafshëve të asgjësuarra për shkak të sëmundjeve infektive	27.08.2024
Udhëzim Administrativ (MBPZHR)-Nr.24/2024 për ndryshimin dhe plotësimin e udhëzimit administrativ Nr.16/2013 për riprodhimin e kafshëve të fermës	15.08.2024
Udhëzim Administrativ (MBPZHR)-Nr.23/2024 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) - Nr.02/2004 për Caktimin e Kushteve për Licencimin e Importuesve, për Tregtimin dhe deponimin e Plehrave Artificiale	15.08.2024
Udhëzim Administrativ (MBPZHR) - Nr. 08/2024 për Ruajtjen e Pyjeve, Përgjegjësitë dhe Obligimet e rojes së pyllit	11.04.2024
Udhëzim Administrativ(MBPZHR) - Nr. 07/2024 për Sistemin Informativ për Pyjet e Kosovës	21.03.2024

Tabela 37: Udhëzime administrative - Ministria e Ekonomisë

Emri i udhëzimit administrativ	Data e publikimit
Udhëzim Administrativ Nr. 01/2024 për Procesin e Ofertimit Konkurrues për Dhënieën e Mbështetjes për Energji të Ripërtëritshme	17.12.2024

7.2. Inspektimi dhe kontrolli i zbatimit të ligjit

Inspektimi dhe kontrolli i zbatimit të ligjit

Në kuadër të zbatimit të legjislacionit mjedisor në fushën e mjedisit, ujërave, natyrës, planifikimit hapësinorë dhe ndërtimit, në nivel qendror Inspektorati i Mjedisit, Ujërave, Natyrës, Planifikimit Hapësinorë dhe Ndërtimit / Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës, sipas detyrës zyrtare, në vitin 2024 ka realizuar: 649 mbikëqyrje të inspektimit me procesverbal, 164 vendime, 247 gjoba kundërvajtës.

Tabela 38: Inspektimet dhe procedurat tjera ligjore

Lloji i aktivitetit inspektues në fushën e mbrojtjes së mjedisit	Numri i aktiviteteve 2023	Numri i aktiviteteve 2024
Mbikëqyrje inspektimi me procesverbal	355	388
Vendime	141	100
Gjoha kundërvajtëse	153	113
Lloji i aktivitetit inspektues në fushën e mbrojtjes së ujërave	Numri i aktiviteteve 2023	Numri i aktiviteteve 2024
Mbikëqyrje inspektimi me procesverbal	240	199
Vendime	91	57
Gjoha a kundërvajtëse	133	124
Lloji i aktivitetit inspektues në fushën e mbrojtjes së natyrës	Numri i aktiviteteve 2023	Numri i aktiviteteve 2024
Mbikëqyrje inspektimi me procesverbal	30	22
Vendime	1	3
Gjoha kundërvajtësi	12	10
Lloji i aktivitetit inspektues në fushën e planifikimit hapësinor dhe ndërtimit	Numri i aktiviteteve 2023	Numri i aktiviteteve 2024
Mbikëqyrje inspektimi me procesverbal	49	40
Vendime	9	4
Gjoha kundërvajtëse	8	0

Gjatë vitit 2024, për dëmet e shkaktuara në resurset natyrore, Drejtoritë e Parqeve Kombëtare Sharri dhe Beshkët e Nemuna, kanë parashtruar në Gjykatat dhe Prokuroritë Themelore gjithsej 87 lëndë me pretendimin se është shkelur ligjit penal, ai kundërvajtës dhe dëm material institucionit, nga to 85 kallëzime dhe 2 kërkesa për fillimin e procedurës kundërvajtëse. Vlera totale e dëmit të pretenduar është 183,114.80 euro.

Tabela 39: Kallëzimet penale në prokuroritë themelore për dëmet në resurset natyrore në PK 2023 – 2024

Lloji i aktivitetit	Numri i lëndëve 2023	Shuma e dëmit	Numri i lëndëve 2024	Shuma e dëmit
Kallëzime penale në Prokurorinë Themelore në Ferizaj	50	166,613.00 €	43	107,351.40 €
Kallëzime penale në Prokurorinë Themelore në Prizren	22	30,755.50 €	23	24,056.00€
Kallëzime penale në Prokurorinë Themelore në Pejë	516	1,589,447.65 €	19	50,380.40 €
Kërkesa për fillimin e procedurës kundërvajtëse në Gjykatën Themelore në Prizren	4	10,000.00 €	2	1.327.00 €
Kërkesa për fillimin e procedurës kundërvajtëse në Gjykatën Themelore në Ferizaj	1	1,071.00 €	-	-

Kurse në nivel lokal nga 38 komunat e Republikës së Kosovës, sa i përket zbatimit të legjislacionit mjedisor në fushën e mjedisit, ujërave, natyrës, planifikimit hapësinor dhe ndërtimit, kanë raportuar vetëm 15 komuna.

Nga komunat te cilat kanë raportuar për vitin 2024, në nivel lokal janë realizuar 1512 mbikëqyrje inspektimi me procesverbal, 988 asistime në inspektime, 102 vendime; 95 gjoba mandatore; 41 gjoba administrative; 499 rekomandime, urdhëresa dhe vërejtje; si dhe 1 inicim në gjykatë.

Tabela 40: Inspektimet dhe procedurat tjera ligjore në nivel lokal 2024

Aktivitetet inspektimit për vitin 2024	Inspekti me procesverbal	Asistime në inspektime	Vendi me	Gjoha mandatore	Gjoha administrative	Rekomandi me urdhëresa dhe vërejtje	Inicime në Gjykata
Deçan	55	76	21	6	-	55	-
Dragash							
Drenas	122	170	1	14	0	97	0
Fushë Kosovë	27	41	-	2	-	27	-
Ferizaj	443	-	25	25	25	234	-
Gjakovë							
Gjilan							
Gracanicë							
Hani i Elezit	38	10	1	0	0	5	0
Istog							
Junik	15	11	-	-	8	1	-
Kaçanik							
Kamenicë	43	152	14	18	-	4	-
Klinë	73	73	-	10	-	-	1
Kllokot							
Lipjan	129	-	-	12	-	-	-
Malishevë							
Mamushë							
Mitrovicë e Jugut	402	-	4	-	6	-	-
Novobërdë							
Obiliq							
Partesh							
Pejë							
Podujevë							
Prishtinë							
Prizren							
Rahovec	93	140	30	16	2	15	-
Ranillug	4	1	-	2	-	3	-
Shtërpce							
Shtime	40	-	5	5	-	-	-
Skënderaj							
Therandë							
Viti	28	314	1	5	0	13	0
Vushtrri							
Mitrovicë e Veriut							
Zubin Potok							
Zveçan							
Leposaviq	-	-	-	-	-	-	-
Gjithsej	1512	988	102	115	41	499	

7.3. Lejedhënia

Leje- dhënia nga MMPHI

Sipas të dhënave nga MMPHI, gjatë vitit 2024 janë realizuar aktivitete në të gjitha fushat përkatëse. Bazuar në autorizimet e legjislacionin mjedisor gjatë vitit 2024 janë lëshuar 110 pëlqime mjedisore për VNM, 7 pëlqime mjedisore për VSM, 82 leje mjedisore, 5 leje të ineguara, 1 leje për tregëtarë dhe ndërmjetës për mbeturina të parrezikshme, 22 pëlqime ujore, 21 leje ujore për shfrytëzim, dhe 20 leje ujore për shkarkim.

Të dhëna më të detajuara për aktivitetet e leje - dhënies në sektorin e mjedisit, mbeturinave, dhe të ujërave janë prezantuar në tabelën pasuese.

Tabela 41: Aktivitetet për leje-dhënie gjatë vitit 2023 – 2024

Aktivitetet për Pëlqime Mjedisore	2023	2024
Kërkesa të pranuar për Pëlqime Mjedisore VNM	127	164
Kërkesa të aprovuara për Pëlqime Mjedisore VNM	29	110
Kërkesa të refuzuara për Pëlqime Mjedisore VNM	7	9
Kërkesa të pranuar për Pëlqime Mjedisore VSM	13	7
Kërkesa të aprovuara për Pëlqime Mjedisore VSM	4	7
Kërkesa të refuzuara për Pëlqime Mjedisore VSM	1	0
Aktivitetet për Leje Mjedisore	2023	2024
Kërkesa të pranuar për Leje Mjedisore	171	177
Kërkesa të aprovuara për Leje Mjedisore	108	82
Kërkesa të refuzuara për Leje Mjedisore	45	15
Përfundim të procedurave administrative	60	89
Në procedurë	-	-
Aktivitetet për Leje të Integuara Mjedisore	2023	2024
Kërkesa të pranuar për Leje të Integuara Mjedisore	-	1
Kërkesa të aprovuara për Leje të Integuara Mjedisore	-	5

Kërkesa të refuzuara për Leje të Integruara Mjedisore	-	6
Në procedurë	-	1
Aktivitetet për Autorizime Mjedisore	2023	2024
Kërkesa të pranuar për Autorizime Mjedisore	3	4
Kërkesa të aprovuara për Autorizime Mjedisore	-	1
Kërkesa të refuzuara për Autorizime Mjedisore	-	6
Në procedurë	3	-
Aktivitetet e leje- dhënieve në fushën e mbeturinave	2023	2024
Kërkesa për leje për tregëtarë dhe ndërmjetës për mbeturina të parrezikshme	7	2
Dhënia e lejes për tregëtarë dhe ndërmjetës për mbeturina të parrezikshme	6	1
Refuzim i lejes për tregëtarë dhe ndërmjetës për mbeturina të parrezikshme	1	1
Aktivitetet për leje-dhënie në fushën e ujërave	2023	2024
Kushte Ujore	0	5
Pëlqime Ujore	25	22
Leje Ujore për shfrytëzim	56	21
Leje Ujore për shkarkim	53	20
Vazhdime të Lejeve Ujore	10	1

8. Mënyra e menaxhimit të resurseve natyrore dhe mbrojtja e mjedisit

8.1. Shfrytëzimi i resurseve ujore

Shpenzuesit më të mëdhenj të resurseve ujore janë operatorët e mëdha industriale, si `KEK-u`, `NewCoFeronikli`, `Sharrcem-i`, etj. NewCoFeronikli nuk ka pasur aktivitete prodhuese në vitin 2024, rrjedhimisht nuk ka pasur monitorim të gjendjes së mjedisit, prandaj dhe nuk ka raport vjetor për gjendjen e mjedisit

për vitin 2024. Pjesa më e madhe e tyre furnizohen me ujë nga liqenet akumuluese sipërfaqësore.

Tabela 42. Shfrytëzimi i ujit 2023-2024 nga ndërmarrjet e mëdha industriale⁶⁸

Shfrytëzuesit	Sasia e shpenzuar e ujit (m ³ /vit) 2023	Sasia e shpenzuar e ujit (m ³ /vit) 2024
Korporata Energjetike e Kosovës – KEK	16097678*	18042349
Neë Co FERRONIKEL	1552307	54537
SHARRCEM	107467	/
Gjithsej	17757452	18096886

Sa i përket shfrytëzimit të ujërave për pije dhe amvisëri, operojnë shtatë kompani regjionale të ujit (KRU) të licencuara nga Autoriteti Rregullativ i Shërbimeve të Ujit (ARRU), që ofrojnë këto shërbime, si dhe janë 32 komuna që përfitojnë nga shërbimet e këtyre kompanive. Prodhimi total i ujit të distribuuar nga kompanitë regjionale për vitin 2024 ka qenë 198,710,307 m³, krahasuar me vitin 2023 ka qenë 183,413,83 m³ më e lartë. Vlen të ceket se nga viti 2023 është përfshirë edhe pjesa veriore e vendit.

Sqarim: Shfrytëzimi i ujit në Korporaten Energjetike të Kosovës për procesin e prodhimit të energjisë elektike, konkretisht procesin e ftohjes, përdoret uji i dekarbonizuar për të mënjanuar procesin e korrozionit.

8.2. Shfrytëzimi i resurseve pyjore

Sipas vlerësimeve, raporteve dhe analizave të përgatitura nga Agjencia Pyjore e Kosovës, si dhe nga organet tjera kompetente, konstatohet se gjendja në zonat pyjore është e qëndrueshme.

⁶⁸ Raportet vjetor për gjendjen e mjedisit, New Co Feronikeli

Sipas të dhënave nga inventarizimi i kombëtar i pyjeve, pyjet mbulojnë rreth 481.000 hektarë apo 44.7 % e sipërfaqes totale të Kosovës.

Nga kjo sipërfaqe e përgjithshme e pyjeve dhe tokave pyjore, 295 200 hektare janë pyje në pronësi shtetërore dhe 180 800 hektar pyje në pronësi private. Pyjet e Kosovës janë burim i ofrimit të lëndës drunore që përdoren për ngrohje, industri dhe veprimtari tjera.

Gjatë vitit 2024 APK nuk ka pasur pyllëzime të realizuara nga buxheti i APK-se (për shkak të dështimit të tenderit, ku nuk ka pasur operatorë ekonomik të interesuar), por përmes organizatës CNVP janë pyllëzuar 0.95 ha.

Sipas të dhënave nga Agjencia e Pyjeve të Kosovës gjithsej 91759.7 m³ masë drusore janë shfrytëzuar nga pyjet shtetërore dhe private gjatë vitit 2024, (të dhënat në tabelën e mëposhtme). Gjatë vitit 2024 nga Drejtoratet Koordinuese Regjionale të APK-ës është konfiskuar masa drusore në volumn prej 1194.18 m³, nga e cila 125.51 m³ dru teknik dhe 1068.67 m³ dru zjarri.

Prerjet ilegale dhe veprimet tjera ilegale në pyje dhe toka pyjore mbeten ndër sfidat kryesore të sektorit të pylltarisë dhe në përgjithësi të menaxhimit të pyjeve.

Tabela 43: Sasia e masës drunore (m³) e shfrytëzuar sipas Drejtorive Koordinuese Regjionale të APK-se dhe sektorëve për vitin 2024

Nr. rendor	DR të APK	Pyje shtetërore (m ³)	Pyje private (m ³)
1	Prishtinë	0	9694.10
2	Mitrovicë	80.50	32230.90
3	Pejë	3053.71	2911.55
4	Prizren	1918	1795
5	Ferizaj	5546.69	1893.02
6	Gjilan	4394.48	24301.30
7	DMKE	3606.15	334.42
Gjithsej		18.599.53	73160.17

Sa i perket shfrytëzimit të produkteve pyjore jo drunore, duke përfshirë bimet mjekesore dhe aromatike, lidhur me sasinë e grumbulluar, sipërfaqen, dhe sasinë e eksportit të tyre, ju lutem që të kontaktoni MBPZHR-ne, përkatësisht Departamentin e Analizave Ekonomike dhe Statistikave Bujqësore dhe të dhënat nga Raporti i Gjellbër i MBPZHR-se.

8.3. Shfrytëzimi i resurseve minerare

Bazuar në të dhënat zyrtare të pranuar nga Komisioni për Miniera dhe Minerale për vitin 2024, rezulton se shfrytëzimi i resurseve minerare në Republikën e Kosovës ka qenë i pranishëm dhe aktiv në disa kategori të lëndëve të para, të cilat ndahen sipas karakterit të tyre në: minerale metalike, minerale energjetike, si dhe minerale industriale dhe ndërtimore. Ky aktivitet përbën një segment të rëndësishëm të zhvillimit ekonomik dhe paraqet një indikator me rëndësi për vlerësimin e përdorimit të burimeve natyrore.

8.3.1. Lëndët minerale metalike

Gjatë vitit 2024, në mesin e lëndëve minerale metalike, vendin kryesor e zë xeheja e plumbit dhe zinkut (Pb-Zn) me një sasi të raportuar prej 170,042.48 tonësh, duke e bërë këtë lëndë ndër më të shfrytëzuarat dhe ekonomikisht më të rëndësishmet në vend. Po ashtu, është raportuar shfrytëzimi i një sasive më të kufizuar të xeheve së nikelit dhe kobaltit (Ni-Co) me 370.55 tonë, ndërsa për xeheve të kromit (Cr_2O_3) nuk është raportuar aktivitet shfrytëzues gjatë këtij viti.

8.3.2. Lëndët minerale energjetike

Shfrytëzimi i lignitit (thëngjillit të butë) mbetet shtylla kryesore e furnizimit energjetik në Kosovë. Për vitin 2024, sasia e përgjithshme e lignitit të shfrytëzuar ka arritur në 8,106,057.00 tonë, duke e vendosur këtë burim si më të rëndësishmin në aspektin e energjisë vendore dhe njëkohësisht si aktivitet me peshë të madhe në bilancin e përdorimit të resurseve natyrore.

8.3.3. Lëndët minerale industriale dhe ndërtimore

Në këtë kategori është evidentuar një aktivitet i gjerë ekonomik, me nivele të larta shfrytëzimi të lëndëve të para për ndërtim dhe industri përpunuese:

- **Guri Gëlqeror:** 6,552,562.00 m³
- **Argjilë** 684,097.65 tonë
- **Andesit:** 240,438.34 m³
- **Marl:** 159,576.70 m³
- **Basalt:** 24,748.11 m³
- **Diabazi:** 31,205.02 m³
- **Rërë dhe zhavorr:** 17,834.01 m³

Tabela 44. Lëndet minerale industriale dhe ndërtimore

Lënda minerale	Njesia	2024
Andesite	m ³	240,438.34
Basalt	m ³	24,748.11
Argjila	t	684,097.65
Guri Gëlqeror	m ³	6,552,562.00
Marl	m ³	159,576.70
Rërë dhe zhavor	m ³	17,834.01
Diabaz	m ³	31,205.02

Sasia e lartë e shfrytëzimit të gëlqerorës dhe argjilës dëshmon për kërkesën e vazhdueshme për materiale ndërtimore, ndërsa shfrytëzimi i andesitit, marl-it dhe materialeve të tjera përbën një indikator të rëndësishëm për sektorin e ndërtimit dhe infrastrukturës.




Figura 30: Metalet

9. Analiza për funksionimin e institucioneve, autoriteteve dhe subjekteve të tjerë për mbrojtjen e mjedisit

9.1. Rregullore (ZKM) nr. 08/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës - riorganizimi

Rregullorja (ZKM) me Nr.08/2024 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI) është një hap i rëndësishëm drejt krijimit të një strukture më efikase dhe të përqendruar në mbrojtjen e mjedisit. Kjo rregullore synon të krijojë një bazë të fortë për funksionimin e institucioneve përgjegjëse për mjedisin, duke përcaktuar qartë përgjegjësitë e departamenteve dhe divizioneve për të siguruar menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, mbikëqyrjen e ndotësve dhe zbatimin e politikave mjedisore.

Funksionet kryesore të rregullores përfshijnë:

Rritjen e transparencës dhe llogaridhënies në administratën publike për çështjet mjedisore.

Përmirësimin e efikasitetit të institucioneve duke krijuar divizione të specializuara për fusha të ndryshme të mbrojtjes së mjedisit.

Sigurimin e një zbatimi më rigoroz të legjislacionit dhe politikave të BE-së për mjedisin dhe planifikimin hapësinor.

Rritjen e kapaciteteve për inspektim dhe monitorim, duke siguruar një mbikëqyrje më të mirë të ndotësve dhe zhvillimeve urbane.

Me këtë rregullore, synohet të forcohet qasja proaktive ndaj problemeve mjedisore, duke vendosur theks të veçantë në menaxhimin e mbeturinave, mbrojtjen e resurseve ujore dhe biodiversitetin.

Rregullorja e re sjell riorganizim dhe zgjerim të disa departamenteve kyçe në MMPHI, të cilat do të mbikëqyrin fushat më kritike të mjedisit dhe infrastrukturës. Departamentet që do të forcohen me divizione të reja për të përmbushur më mirë misionin e tyre janë:

1. Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Ujërave (DMMU)
2. Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit
3. Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore (ARPL)

Këto departamente do të kenë një rol kyç në implementimin e politikave mjedisore dhe zhvillimin e qëndrueshëm në Kosovë, duke u mbështetur në divizionet e reja të specializuara.

Divizionet e reja janë krijuar për të adresuar problematika specifike mjedisore dhe për të përmirësuar efikasitetin e zbatimit të strategjive për mbrojtjen e mjedisit dhe natyrës.

Miratimi i kësaj rregullore përfaqëson një hap të rëndësishëm për përmirësimin e menaxhimit të mjedisit në Kosovë. Ndikimi i divizioneve të reja do të jetë i madh nëse ato funksionalizohen plotësisht me zyrtarët e duhur dhe me financim adekuat.

Nëse këto struktura mbështeten si duhet:

Do të kemi një mbikëqyrje më të mirë të ndotjes industriale, duke zvogëluar ndotjen e ajrit dhe ujërave.

Do të sigurohet menaxhim më i qëndrueshëm i burimeve ujore, duke parandaluar ndotjen dhe shfrytëzimin e tepërt.

Do të përmirësohet menaxhimi i mbeturinave, duke inkurajuar riciklimin dhe reduktimin e ndotjes.

Do të ruhet biodiversiteti dhe zonat e mbrojtura, duke siguruar mbikëqyrje më të mirë të ekosistemeve natyrore.

Do të përmirësohet planifikimi urban, duke parandaluar ndërtimet e paligjshme dhe zhvillimet e pakontrolluara.

Nëse kjo strukturë zbatohet me sukses, Kosova do të bëjë hapa të mëdhenj përpara në mbrojtjen e mjedisit dhe përafrimin me standardet evropiane për zhvillim të qëndrueshëm. Ky është një investim për të ardhmen, një garanci për një mjedis më të pastër dhe një ekonomi më të gjelbër për gjeneratat e ardhshme.

9.2. Drafti i Rregullores për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Agjencinë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës / AMMK

Drafti i Rregullores për Organizimin e brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Agjencinë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK) është në procedurën finale të miratimit dhe presim që ajo të aprovohet nga Qeveria e Kosovës. Kjo rregullore është një hap i rëndësishëm drejt forcimit të kapaciteteve të AMMK-së për të përmbushur detyrat e saj ligjore dhe për të përmirësuar mbrojtjen e mjedisit, ruajtjen e natyrës dhe menaxhimin e burimeve natyrore. Divizionet e reja të përfshira në këtë rregullore do të kontribuojnë ndjeshëm në monitorimin, vlerësimin dhe raportimin e gjendjes së mjedisit dhe natyrës, si dhe në përmirësimin e menaxhimit të zonave të mbrojtura.

Në këtë kuadër, janë shtuar disa divizione të reja në kuader të departamenteve që do të luajnë një rol kyç në përmbushjen e objektivave për mbrojtjen e natyrës dhe mjedisit, përmirësimin

e mbikëqyrjes dhe për zbatimin e politikave të qëndrueshme mjedisore. Nëse këto struktura funksionalizohen plotësisht dhe mbështeten me numrin e duhur të zyrtarëve, ato do të sjellin përfitime të jashtëzakonshme për natyrën, mjedisin dhe ekonominë e Kosovës.

Për të forcuar mbikëqyrjen dhe për të mundësuar një qasje më të efektshme për mbrojtjen e natyrës dhe mjedisit, rregullorja përfshinë departamente dhe divizione të reja, të cilat janë të specializuara për fusha të ndryshme. Këto departamente dhe divizione janë si më poshtë:

Departamenti i Vlerësimit të Gjendjes së Mjedisit dhe Çështjeve Ligjore

Divizioni i Inventarit të Emisioneve në Ajër dhe Regjistrin të Shkarkimeve në Mjedis: Ky divizion do të fokusohet në monitorimin e emisioneve të gazrave dhe ndotësve të tjerë në ajër, si dhe regjistrimin e shkarkimeve në mjedis. Kjo është thelbësore për të kontrolluar dhe reduktuar ndikimin e ndotësve industrial dhe për të siguruar që ato të përmbushin standardet e përcaktuara për mbrojtjen e ajrit dhe mjedisit.

Divizioni i Çështjeve Ligjore: ky division do të ofroj mbështetje ligjore në hartimin e dokumenteve strategjike dhe legjislativë, identifikon problemet në zbatimin e akteve normative, ofron këshilla dhe rekomandime ligjore, shqyrton kërkesat dhe ankesat e palëve, harton akte administrative dhe inicijon procedura penale e kundërvajtëse ndaj degraduesve të mjedisit në zonat e mbrojtura.

Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës

Divizioni i Zonave të Mbrojtura: ky divizion do të menaxhoj zonat e mbrojtura të Kosovës, duke siguruar mbikëqyrje të rreptë për të parandaluar ndërhyrjet e paligjshme dhe për të ruajtur biodiversitetin e këtyre zonave.

Divizioni i Biodiversitetit dhe Natyrës 2000: ky divizion ka për detyrë të monitoroj dhe ruajë biodiversitetin e Kosovës dhe të siguroj implementimin e direktivave dhe kërkesave të BE-së për zonat Natyrës 2000.

Divizioni i Gjeotrashigimisë: do të merret me ruajtjen e trashëgimisë natyrore dhe menaxhimin e resurseve natyrore të

veçanta, duke identifikuar dhe mbrojtur sitet gjeologjike me rëndësi të veçantë.

Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës

Divizioni i Meteorologjisë dhe Klimës: ky divizion do të monitoroj ndryshimet klimatike dhe do të zhvilloj modele të avancuara të klimës për të ndihmuar në parashikimin e efekteve të ndryshimeve klimatike në Kosovë.

Divizioni i Hidrologjisë: do të monitoroj dhe menaxhoj burimet ujore të Kosovës dhe do të zbatoj politika për ruajtjen e cilësisë së ujërave.

Divizioni i Monitorimit të Ajrit: ky divizion do të fokusohet në monitorimin e cilësisë së ajrit, për të zbatuar strategji për uljen e ndotjes dhe përmirësimin e kushteve të ajrit për qytetarët.

Divizioni i Monitorimit të Cilësisë së Ujit dhe Dheut: do të monitoroj cilësinë e ujërave dhe tokës, duke siguruar që burimet natyrore të përdoren në mënyrë të qëndrueshme dhe pa dëmtuar mjedisin.

Departamenti i Administrimit të Parkut Kombëtar "Sharri"

Divizioni i Pylltarisë dhe Shërbimeve Profesionale: ky divizion do të mbikëqyrë pyjet e Parkut Kombëtar "Sharri", duke siguruar që ato të mbrohen dhe menaxhohen në mënyrë të qëndrueshme.

Divizioni i Mbikëqyrjes dhe Kontrollit: ky divizion do të siguroj mbikëqyrjen dhe kontrollin e aktiviteteve në Parkun Kombëtar "Sharri", për të parandaluar aktivitetet ilegale dhe për të mbrojtur biodiversitetin.

Departamenti i Administrimit të Monumenteve Natyrore më Rëndësi të Veçantë

Divizioni i Monumentit të Natyrës më Rëndësi të Veçantë "Ujëvarat e Mirushës": ky divizion do të fokusohet në mbrojtjen e një prej monumenteve natyrore më të rëndësishme të Kosovës, duke siguruar ruajtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të zonës.

Beneficionet për mjedisin, natyrën dhe Kosovën nëse funksionalizohen sektorët dhe shtohen Stafi

Nëse këto departamente dhe divizione funksionalizohen me numrin e duhur të zyrtarëve dhe burimeve të mjaftueshme, ato

do të sjellin përfitime të konsiderueshme për mjedisin dhe natyrën e Kosovës:

Mbrojtja e Zonave të Mbrojtura dhe Biodiversitetit: divizionet e reja, të tilla si Divizioni i Zonave të Mbrojtura dhe Divizioni i Biodiversitetit dhe Natyrës 2000, do të forcojnë mbikëqyrjen dhe menaxhimin e zonave të mbrojtura, duke parandaluar shkatërrimin e habitateve dhe duke ruajtur biodiversitetin e pasur të Kosovës.

Monitorimi i Ndryshimeve Klimatike dhe Ndotjes: divizionet si Divizioni i Meteorologjisë dhe Klimës dhe Divizioni i Monitorimit të Ajrit do të ofrojnë informacion të detajuar për ndryshimet klimatike dhe ndotjen e ajrit, duke mundësuar zhvillimin e politikave për përballimin e këtyre sfidave.

Përmirësimi i Cilësisë së Ujit dhe Tokës: monitorimi i vazhdueshëm i cilësisë së ujit dhe tokës do të siguroj që burimet natyrore të menaxhohen në mënyrë të qëndrueshme dhe pa ndotje, duke mbrojtur shëndetin publik dhe ekosistemet.

Rritja e Qasjes ndaj Menaxhimit të Resurseve Natyrore: këto divizione do të kontribuojnë në menaxhimin më të mirë të resurseve ujore, pyjore dhe natyrore, duke e bërë Kosovën një shembull të qëndrueshmërisë për rajonin.

Zhvillimi i Qëndrueshëm i Turizmit Ekologjik: përmes mbrojtjes së zonave natyrore dhe monumenteve natyrore si "Ujëvarat e Mirushës", do të inkurajohet turizmi ekologjik, duke ndihmuar në zhvillimin ekonomik dhe promovimin e Kosovës si një destinacion turistik të gjelbër.

Në përfundim, nëse këto struktura funksionalizohen dhe mbështeten me burimet e nevojshme, ato do të ndihmojnë në forcimin e kapaciteteve të Kosovës për mbrojtjen e mjedisit dhe menaxhimin e natyrës, duke kontribuar në ruajtjen e pasurive natyrore dhe përmirësimin e cilësisë së jetës për qytetarët e Kosovës, në të kundërtën do mbesin në letër si Rregullorja e vitit 2017.

9.3. Bashkëpunimi me Agjencinë e Mjedisit të Europes / EIONET

Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK) ka zhvilluar një bashkëpunim të ngushtë me Agjencinë Evropiane për Mjedis (EEA) që nga viti 2010. Ky bashkëpunim i mundëson Kosovës statusin e shtetit bashkëpunues të EEA dhe ndihmon vendin në përmirësimin e menaxhimit të mjedisit dhe në përmbushjen e standardeve evropiane.

Fillimisht një nga iniciativat kryesore të këtij bashkëpunimi ka qenë implementimi i projektit të binjakëzimit të BE-së, "Mbështetje për Sektorin e Mjedisit në Kosovë", pastaj janë realizuar projekte të shumta nën Instrumentin për Asistencën para Anëtarësimit (IPA). Qëllim i këtyre projekteve është përmirësimi i kapaciteteve të AMMK-së dhe institucioneve të tjera relevante në fushën e monitorimit të mjedisit dhe raportimit për EEA, duke mundësuar:

- Konsolidimin e kapaciteteve administrative në AMMK dhe departamentet përkatëse të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) në çështje ligjore, institucionale dhe teknike të monitorimit të mjedisit.
- Përmirësimin e kapaciteteve të AMMK-së për të përmbushur kërkesat e raportimit për EEA për treguesit e prioritetit të rrjedhës së të dhënave (ajër, ujë, zona të mbojtura, mitigimi dhe adaptimi ndaj ndryshimeve klimatike).
- Hartimin e një strategjie për ngritjen e vetëdijesimit publik dhe zhvillimin e materialeve përkatëse.
- Krijimin e një menaxhimi modern të të dhënave, përfshirë zhvillimin e një baze të dhënash.

Duke qenë shtet bashkëpunues i EEA, Kosova është bërë anëtare e Rrjetit Evropian për Informin dhe Vëzhgim Mjedisor EIONET. Ky rrjet është një nga rrjetet më të rëndësishme për menaxhimin e mjedisit në Evropë dhe kontribuon në arritjen e qëllimeve për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Këto qëllime realizohet duke shkëmbyer informacionet dhe praktikatat më të mira në nivel evropian, duke ofruar trajnime dhe mundësi për

përmirësimin e kapaciteteve të administratave mjedisore kombëtare. gjithashtu duke ndihmuar vendet pjesëmarrëse të përmbushin angazhimet e tyre ndaj politikave dhe ligjeve të BE-së për mjedisin.

Sot, Kosova ka të zhvilluar edhe rrjetin e saj vendor EIONET me afërsisht 40 anëtar, ekspert nga 9 institucione të ndryshme vendore që bashkëpunojnë me qëllim të përmirësimit të mbledhjes dhe shpërndarjes së informacionit për mjedisin, si dhe përforcimin e kapaciteteve për të mbajtur standarde të larta të mbikëqyrjes mjedisore dhe raportimit të të dhënave.

Shembulli i përformacës së Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës në rrjedhën e të dhënave në Rrjetin Evropian për Monitorim dhe Vëzhgim EIONET, ku edhe gjatë vitit 2024, për të katërtin vit me radhe janë përmbushur 100% të obligimeve për raportim (figura 33).




Figura 31: Përformanca e AMMK 2016-2024 në kuadër të EIONET⁶⁹

⁶⁹ <https://www.eea.europa.eu/en/analysis/publications/eionet-core-dataflows-2024>

Ky angazhim ndihmon në përmirësimin e transparencës, llogaridhënies dhe zhvillimit të qëndrueshëm në vend, gjithashtu luan një rol të rëndësishëm në mbështetje të integritit të Kosovës në strukturat evropiane dhe në përmbushjen e angazhimeve vendore ndaj politikave të BE-së për mjedisin.

Për më tepër, AMMK ka marrë pjesë në aktivitete të tjera që synojnë përmirësimin e menaxhimit të mjedisit dhe përputhjen me standardet evropiane, siç është pjesëmarrja në konferenca dhe punëtori ndërkombëtare, si dhe zhvillimi i strategjive dhe raporteve të përbashkëta me EEA. Përmes këtyre bashkëpunimeve dhe nismave, EEA dhe Kosova synojnë të forcojnë qeverisjen mjedisore dhe të kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm në rajon.

9.4. Zyrtarët për mjedis dhe inspektorët mjedisorë në nivel lokal

Organizimi institucional i resurseve humane në nivel komunal për fushën e mjedisit përfaqëson një hallkë thelbësore për zbatimin efektiv të politikave mjedisore në Kosovë. Komunat, si bartëse të shumë kompetencave ligjore dhe operacionale në menaxhimin e mbeturinave, ruajtjen e cilësisë së ajrit dhe mbrojtjen e burimeve natyrore, janë përgjegjëse për implementimin e legjislacionit horizontal dhe sektorial të mjedisit. Në këtë kuadër, prania e strukturave të përhershme dhe me kapacitete profesionale adekuate është themel për një menaxhim të qëndrueshëm të mjedisit. Kjo analizë synon të ofrojë një pasqyrë të detajuar, krahasimore dhe përmbajtësore mbi gjendjen aktuale të organizimit të resurseve humane në sektorin e mjedisit në nivel komunal.

Nga gjithsej 38 komuna, vetëm 17 prej tyre kanë dërguar të dhëna, që përfaqëson 44.74% të totalit. Pjesëmarrja e ulët reflekton mangësi në kapacitete administrative, mungesë të vetëdijes për rëndësinë e raportimit dhe ndoshta mungesë të stafit të përkushtuar për mjedisin edhe në nivel më bazik. Kjo

përbën sfidë të dyfishtë: jo vetëm që kemi mungesë të stafit të specializuar, por edhe mungesë të transparencës dhe bashkëpunimit me nivelin qendror për zhvillim të politikave publike.

Pavarësisht përpjekjeve që kemi bërë nëpërmjet Asociacionit të Komunave të Kosovës, kryetareve të komunave respektive dhe dërgimit të emailave në drejtoritë e urbanizmit apo kontaktet e pranuar nga Kolegjiumi i AKK nuk kemi pranuar asnjë të dhënë nga 21 komuna që për ne paraqet gjendje shumë shqetësuese, çfarë bëjnë për mjedisin komunat që nuk kanë gatishmëri as për të plotësuar një formular të thjeshtë.

Komunat që kanë dorëzuar të dhëna: Klina, Kamenica, Mitrovica e Jugut, Ferizaj, Deçan, Shtime, Rahovec, Lipjan, Ranillug, Gjakovë, Hani i Elezit, Drenas, Junik, Vushtrri, Fushë Kosovë, Viti dhe Obiliq.

Komunat që nuk kanë dorëzuar të dhëna: Dragash, Gjilan, Graçanicë, Istog, Kaçanik, Klllokot, Leposaviq, Malishevë, Mamushë, Mitrovica e Veriut, Novobërdë, Partesh, Pejë, Podujevë, Prishtinë, Prizren, Skenderaj, Suharekë, Zubin Potok dhe Zveçan.

Mosraportimi i këtyre komunave ndikon drejtpërdrejt në pamundësinë për të krijuar një hartë të plotë të kapaciteteve ekzistuese dhe për të zhvilluar politika të harmonizuara. Në të njëjtën kohë, refuzimi ose paaftësia për të dhënë informacion zbulon boshllëqe në sistemin e menaxhimit të mjedisit dhe e vë në pikëpyetje gatishmërinë e këtyre njësive për të përmbushur objektivat kombëtare dhe ndërkombëtare për mjedisin.

Struktura organizative dhe pozicionimi i stafit

Drejtoritë apo sektorë të posaçëm për mjedis: nga 17 komuna, vetëm 11 kanë sektorë ose drejtori të posaçme për mjedis. Në shumë raste, sektori i mjedisit është pjesë e Drejtorisë së Urbanizmit ose Shërbimeve Publike. Kjo nënkupton se trajtimi i çështjeve mjedisore nuk ka pavarësi menaxheriale apo

buxhetore, gjë që kufizon kapacitetin për planifikim afatgjatë dhe zbatim efektiv. Komunat si Mitrovica e Jugut, Obiliqi dhe Gjakova dallohen për strukturë më të avancuar, ku ekzistojnë drejtori të dedikuara me sektorë funksionalë për ajër, mbeturina dhe planifikim mjedisor.

Inspektorë të mjedisit: kjo pozitë është më e përhapura ndër komunat që kanë raportuar. Vetëm një komunë është në procedurë rekrutimi, ndërsa të tjerat kanë të paktën një inspektor të emëruar. Komuna si Gjakova dhe Drenasi kanë nga dy inspektorë, përfshirë edhe kontrata për shërbime të veçanta. Megjithatë, mungojnë tërësisht inspektorët e specializuar për fushat specifike si ndotja e ujit, ajrit apo menaxhimi i kimikateve të rrezikshme.

Zyrtarë për mjedis: në 13 komuna janë të emëruar zyrtarë për mjedis, të pozicionuar zakonisht në kuadër të Drejtorisë së Urbanizmit ose të Mjedisit. Në mungesë të sektorëve për ajër apo ndotje të tjera, këta zyrtarë janë përgjegjës për hartimin e planeve, raportimin mjedisor dhe implementimin e detyrimeve ligjore. Për shkak të ngarkesës funksionale dhe mungesës së asistentëve teknikë, efikasiteti i tyre është shpesh i kufizuar.

Zyrtarë për mbeturina: vetëm në 9 komuna janë të emëruar zyrtarë për mbeturina. Në shumicën e rasteve, kjo detyrë i takon zyrtarëve për mjedis ose udhëheqësve të sektorëve të shërbimeve publike. Ky është një indikator serioz i mungesës së vëmendjes strukturore për menaxhimin e mbeturinave, në kundërshtim me kërkesat e standardeve të BE-së për ndarje funksionale dhe përgjegjësi të qarta në këtë sektor.

Zyrtarë për ajër dhe fusha të tjera: vetëm Obiliqi ka zyrtarë të certifikuar për cilësinë e ajrit. Komuna të tjera e mbulojnë këtë detyrë përmes stafit të përgjithshëm për mjedis. Kjo tregon një mungesë të thellë të kapaciteteve teknike për monitorimin dhe analizimin e ndotësve atmosferikë, pavarësisht nga rritja e ndotjes urbane dhe obligimet për raportim ndërkombëtar.

Rekrutimet gjatë vitit 2024: nga 17 komuna që kanë raportuar, vetëm 4 kanë realizuar rekrutime të reja gjatë vitit 2024, kryesisht për inspektorë. Kjo dëshmon një mosprioritizim të sektorit të mjedisit në politikat e burimeve njerëzore të nivelit lokal, pavarësisht sfidave mjedisore të pranishme.

Analiza e strukturës ekzistuese të resurseve njerëzore për mjedisin në nivel komunal konfirmon nevojën për ndërhyrje të menjëhershme në disa dimensione: ligjor, institucional dhe buxhetor. Pavarësisht ekzistencës së disa strukturave institucionale për mjedis në komunat që kanë raportuar, boshllëqet në burime humane, ndarjen e roleve, mungesën e planifikimit dhe mosrekrutimin e kuadrove tregojnë se mjedisi nuk po trajtohet si prioritet real. Institucionet qendrore duhet të nxisin dhe monitorojnë performancën komunale, të ofrojnë mbështetje teknike dhe financiare për ristrukturim dhe të garantojnë që mjedisi të trajtohet me seriozitetin që kërkon legjislacioni dhe realiteti ekologjik në vend.

Iniciativa për vlerësimin e zbatimit të UA 07/2023 për qeset plastike

Në kuadër të bashkëpunimit mes GIZ-it gjerman dhe Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), konkretisht AMMK-së ka filluar zbatimi i një iniciative për zhvillimin e Raportit të Vlerësimit mbi arritjen e objektivave për reduktimin e përdorimit të qeseve plastike, siç parashihet me nenin 42 të Udhëzimit Administrativ (UA) nr. 07/2023.

Kjo nismë do të analizojë periudhën janar–dhjetor 2024 dhe do të vlerësojë:

- Zbatimin e masave teknike të përcaktuara në nenet 6 dhe 8 të UA 07/2023.
- Mbështetjen e ofruar apo të planifikuar sipas nenit 45 mbi instrumentet ekonomike.
- Ndikimet mjedisore, sociale dhe ekonomike të zbatimit të politikës.

Aktivitetet përfshijnë rishikimin e kuadrit ligjor, mbledhjen e të dhënave nga institucionet kyçe dhe palët e interesuara, fokus-

grupe me prodhues, tregtarë dhe inspektorë, anketime të konsumatorëve, vizita në terren në komuna të ndryshme dhe analiza të trendeve krahasuese me vitin bazë 2022.

Rezultatet e këtij procesi do të shërbejnë për hartimin e rekomandimeve politike që synojnë përmirësimin e zbatimit të UA 07/2023 dhe avancimin e reformave në menaxhimin e integruar të mbeturinave, në përputhje me praktikat më të mira të BE-së.

10. Financimi i sistemit për mbrojtjen e mjedisit

10.1. Financimi i mjedisit me projekte kapitale në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Mbrojtja e mjedisit është faktor me rëndësi që ndikon drejtpërdrejtë në shëndetin dhe mirëqenien tonë. Rritja e vazhdueshme buxhetit nga Qeveria e Kosovës për sektorin e mbrojtjes së mjedisit është një faktor që tregon përkushtimin për të përmirësuar gjendjen mjedisore.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës për vitin 2024 ka pasur rritje, duke shpenzuar 223,168,016.00 € në krahasim me 177,860,044.00 € investime në projekte të reja dhe ekzistuese gjatë vitit paraprak, bazuar në Kornizën Afatmesme për Shpenzime me burim financimi nga Buxheti i Kosovës.

Totali i buxhetit për vitin 2024 ka qenë 265,445,995.00 €, krahasuar me 213,484,838.00 € në vitin 2023.

Siç mund të vërehet në tabelën e mëposhtme, gjatë dy viteve të fundit si Ministri ka një trend të rritjes në total buxhetit.

Tabela 45: Buxheti i MMPHI për 2023-2024

Linjat buxhetore	2023	2024
Paga dhe medijtje	4.083.931.00 €	5,212.521.00
Mallra dhe shërbime	29.415.559.00 €	34,940,148.00
Subvencione dhe transfere	1.643.814.00 €	1,643,814.00
Shpenzime kapitale	177.860.044.00 €	223,168,016.00
Shpenzime komunale	481,490.00 €	481,490.00
Buxheti total	213.484.838.00 €	265,445,995.00

Projektet mjedisore të mbështetura nga buxheti i MMPHI për dallim nga projektet me donatorë, sidomos pjesa e investimeve të reja gjatë vitit 2024 janë të koncentruara në fushën e ujërave. Implementimi i projekteve nga viti 2023 ka vazhduar, me një

fokus të veçantë në ndërtimin dhe rregullimin e shtretërve të lumenjëve, ndërtimin e digave dhe sistemet e alarmeve për digat ekzistuese. Gjithashtu, ka vazhduar investimi në menaxhimin e integruar të resurseve ujore, ndërsa mbështetja për ndërtimin e deponive komunale dhe skema mbështetëse për mbeturina ka pësuar një reduktim.

Pjesë e projekteve mjedisore janë edhe ato projekte të cilat janë financuar nga buxheti i Kosovës nëpërmjet MMPHI-së dhe implementohen nga komunat përmes memorandumeve përkatëse. Buxheti i përgjithshëm për projektet kapitale mjedisore të mbështetura nga buxheti për MMPHI 2023-2024 për vitin 2023 ka qenë 9,888,994.00 €, ndërsa për vitin 2024 është 4,545,762.9 €. Kjo përfaqëson një ulje prej 5,343,231.10 €, ose një zbritje prej rreth 54% në krahasim me vitin e kaluar.

Buxheti për projektet mjedisore për vitin 2024 është zvogëluar ndjeshëm, me fokus të ndryshuar nga projekte të mëdha infrastrukturore drejtë pastrimit të lumenjëve, digjitalizimit dhe përmirësimit të infrastrukturës laboratorike.

Ndërsa disa projekte të rëndësishme janë vazhdimësi nga viti 2023, një pjesë e madhe e investimeve në menaxhimin e mbeturinave, ujësjellësit dhe rregullimin e lumenjëve nuk janë përfshirë në buxhetin e vitit 2024.

Ky ndryshim mund të ketë implikime për zhvillimin mjedisor, veçanërisht në menaxhimin e mbeturinave dhe mbrojtjen e burimeve ujore, pasi fondet për këto kategori janë reduktuar ndjeshëm.

Një listë e disa prej këtyre projekteve kapitale me rëndësi në fushën e mjedisit dhe ujërave është prezantuar në tabelën 46.

Tabela 46: Projektet kapitale mjedisore të mbështetura nga buxheti për MMPHI 2023-2024

Nr.	Emri i Projektit	Buxheti 2023	Buxheti 2024
1	Ndërtimi i deponise komunale në regjionin e Pejës	2,000,000.00 €	

2	Skema mbështetëse për mbeturina në Kosovë(Furnzim me Kontenjer)	2,000,000.00 €	396,666.75
3	Regullimi i shtratit të lumit Sitnica në Vushtrri	200,000.00 €	
4	Rregullimi i shtratit të lumit Drenica në Drenas	78,994.00 €	
5	Ndërtimi i sisitemit të ujësjellësit në fshatin Orllan – Podujevë	100,000.00 €	
6	Ndërtimi i kanalizimit të ujërave të zeza në fshatrat Novosellë, Radac, Jabllanicë e Madhe, Dubovë e Madhe dhe Ozdrim	100,000.00 €	
7	Ndërtimi i kanalizimit të ujërave të zeza qe lidh fshatrat Pllaçicë – Bubl / komuna e Malishevës	10,000.00 €	
8	Menaxhimi i integruar i resurseve ujore në Kosovë (kontributi i MMPHI)	650,000.00 €	
9	Ndërtimi i digave	1,500,000.00 €	
10	Sistemi i alarmeve për digat ekzisuese	500,000,00 €	
11	Badimetria (Matja e volumit të ujit), analiza e sendimentëve për 6 Digat	300,000,00 €	
12	Ndërtimi i shtratit të lumit Lumbardhi në Pejë	400,000.00 €	
13	Rregullimi i shtratit të lumit Shtime	500,000.00 €	
14	Rregullimi i rrjetit të ujësjellësit në komunën e Fushë Kosovës në Lagjen 028 dhe 029 - Bardhi i Madh dhe Fshatin Sllatinë e Madhe	1,500,000.00 €	
15	Rregullimi i shtratit të lumit Sazli ne Ferizaj	50,000.00 €	
16	Riparimi dhe servisimi i pajisjeve te laboratorit te IHMK-se		45,700.00
17	Shenhezimi dhe digjitalizimi i zonave te mbrojtura te natyres		12,354.20
18	Përditesimi i regjistrit(kadastrit), te mbeturinave te rrezikshme dhe kemikateve si dhe trajnimi i operatoreeve për plotësimin e të dhënave		18,188.88

19	Mirëmbajtja dhe Servisimi i pajisjeve të rrjetit hidrometrik të ujërave nëntokësore dhe sipërfaqësor	1,716,608.00	
20	Furnizimi i laboratorit të IHMK-së me pajisje dhe material shpenzues për monitorimin e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, sipas programit të monitorimit dhe kërkesave të Inspektoratit mjedisor		64,000.00
21	Ndertimi i digave - hartimi i projektit kryesor për ndertimin e diges së Kuqicës - Drenicës		9,965.00
22	Rregullimi i Infrastrukturas për aktivizimin edhe digjitalizimin e laurave në dy qarqet Kombëtare		16,394.60
Buxheti total			4,545,762.9

Projektet kapitale mjedisore për komunat të mbështetura nga buxheti i shtetit 2024 tregojnë një shpërndarje të fondeve në disa fusha kryesore të investimeve mjedisore nëpër komuna të ndryshme të Kosovës, ku si prioritete kryesore të investimeve janë:

- Menaxhimi i ujërave - Projekte të shumta janë të përqendruara në ndërtimin e kanalizimeve, ujësjellësve dhe kolektorëve për grumbullimin e ujërave të zeza;
- Rregullimi i shtratit të lumenjve -Këto projekte synojnë të minimizojnë rreziqet e përmbytjeve dhe të përmirësojnë cilësinë e ujit;
- Zhvillimi i zonave të gjelbra dhe parqeve - Shumë komuna kanë ndarë buxhet për krijimin ose përmirësimin e hapësirave të gjelbra dhe rekreative;
- Menaxhimi i mbeturinave - Disa komuna kanë paraparë projekte për ndërtimin e deponive, vendosjen e kontenjerëve, si dhe menaxhimin e mbeturinave;
- Turizmi dhe zhvillimi urban - Projekte për ngritjen e infrastrukturës turistike.

10.2. Financimi i mjedisit me projekte kapitale në nivelin lokal

Ky buxhet total prej 22.73 milionë € për vitin 2024 tregon një përkushtim të institucioneve për përmirësimin e infrastrukturës mjedisore dhe qëndrueshmërisë ekologjike në komunat e Kosovës. Megjithatë, disa komuna kanë marrë fonde shumë më të vogla, duke ngritur pyetje mbi barazinë e shpërndarjes së buxhetit dhe prioritetet e vendosura.

Komunat me buxhetin më të lartë: Prishtina (2.33 milionë €), Dragashi (2.68 milionë €), Prizreni (5.21 milionë €), Peja (1.96 milionë €), Gjakova (1.27 milionë €).

Komunat me buxhet më të vogël: Ranillug (14,525 €), Kllokoti (62,992 €), Zveçani (75,000 €), Hani i Elezit (102,824 €) të paraqitura në shtojcën X - projektet kapitale mjedisore për komunat të mbështetura nga buxheti i shtetit 2024.

Një pasqyrë e detajuar e projekteve dhe investimeve në sektorin e mjedisit të realizuara nga komunat është prezantuar në shtojcën 6.

10.4. Financimi i mjedisit me projekte nga donatorët

Mbështetja nga donatorët nuk ka munguar as gjatë vitit 2024, ku kanë filluar së implementuari disa projekte të reja dhe njëkohësisht kanë vazhduar së implementuari edhe projektet nga vitet paraprake.

Në tabelën vijuese janë prezantuar të dhëna për disa nga projektet më të mëdha të mbështetura nga donatorët për sektorin e ujërave dhe mjedisit. Nga tabela mund të konkludohet se fusha e ujit ka qenë prioriteti më i madh i investimeve në Republikën e Kosovës, pasuar nga ajri dhe mbeturinat.

Tabela 47: Projektet me donatorë në sektorin e mjedisit dhe ujërave 2024

Nr.	Emri i Projektit	Donatori	Vlera e projektit	Periudha e implementimit
1	"Programi për cilësinë e ajrit për vendet e Ballkanit" (projekt rajonal)	SIDA dhe UNICEF	Fondi i projektit për të gjitha vendet e Ballkanit	Shtator 2022 Dhjetor 2024

2	Projekti "Zhvillimi i kapaciteteve për kontrollin e ndotjes së ajrit" Faza 2	JICA- Qeveria Japoneze	Rreth 3.000.000.00 €	2021- 2026
3	EU4Green: Mbështetje për zbatimin e Agjendës së Gjelbër për Ballkanin Perëndimor (IPA II)	Burimi: BE, Qeveria e Austriisë Shuma:	11,000,000 €	2024-2025
4	Nxitja dhe levimi i mundësive për sigurinë e ujit (FLOËS)	ËBIF, IDA	1,000,000 € 25,100,000 € (Kredi)	2021-2025
5	Diga e Firajës	ËBIF	1.8 M EUR	2022 2024
6	Menaxhimi i Integruar i Resurseve Ujore në Kosovë	Burimi: Qeveria e Zvicrës	24,000,000	2024-2031
7	Menaxhimi i Integruar i Resurseve Ujore në Kosovë (IËRM- K)	SDC- Qeveria Zvicerane	8.7 M CHF + 1.5 M EUR bashkëfinancim	2020-2031
8	Ngritja e kapaciteteve për përdorimin e të dhënave mjedisore. Projekt i bashkëpunimit në mes të AMMK dhe Agjencisë së Mbrojtjes së Mjedisit të Suedisë	SIDA	2.262.400.00 SEK (Krona Suedeze)	2022-2025
9	Nxitja dhe levimi i mundësive për sigurinë e ujit (FLOËS)	ËBIF, IDA	1,000,000 € 25,100,000 € (Kredi)	2021-2025
10	Hartat e Rrezikshmërisë	ËBIF,	25,100,000 €	2022-2024

	dhe Hartat e Rrezikut nga Përmbytjet	EIB & CEB	Donacion dhe kredi	
11	Menaxhimi i integruar i resurseve ujore në Kosovë - Faza 1	Qeveria e Zvicrës	7,700,000	2024-2027
12	Diga e Firajës	BE/WBIF	1,800,000 €	2024
13	Pjesëmarrja në punën dhe programin e Agjencisë Evropiane të Mjedisit (projekt regional)	EU-IPA	BE IPA - Fondi IPA	2019-2022 Pritet vazhdimi 2023-2027
14	Zhvillimi i kapaciteteve për kontrollin e ndotjes së ajrit në Republikën e Kosovës - Faza II	Qeveria e Japonisë	2,800,000.00€	2024-2026
15	EU4Green	BE dhe ADA	BE 10.000.000.00 € ADA 1.000.000.00 €	2022-2025
16	PËRSHTATJA - Zgjidhje të bazuara në natyrë për komunitetet e qëndrueshme të Ballkanit Perëndimor	Qeveria e Suedisë	2,480,202.00 €	2026
17	Hartat e Rrezikshmërisë dhe Hartat e Rrezikut nga Përmbytjet	BE/WBIF	2,500,000.00 €	2024
18	Zhvillimi institucional për modernizimin e menaxhimit të mbeturinave në Kosovë	BE/IPA	3,000,000.00 €	2024

11. Rekomandimet

Cilësia e ajrit dhe emetimet në ajër

- Institucionet përgjegjëse, veçanërisht inspektoratet në nivel qendror dhe lokal, të kryejnë monitorim të vazhdueshëm të operatorëve ndotës, për të siguruar respektimin e standardeve për emisionet ndotëse në ajër.
- Komunitatet të hartojnë dhe zbatojnë planet lokale për mbrojtjen e ajrit nga ndotja, në përputhje me gjendjen specifike në territori të tyre.
- Operatorët ndotës që ende nuk janë të pajisur me leje mjedisore, duhet të pajisen në afatin më të shkurtër të mundshëm.
- Të reduktohet sa më shumë përdorimi i lëndëve djegëse fosile në ekonomitë familjare, shkolla, institucione parashkollore dhe te operatorët ekonomik.
- Të zgjerohet sistemi i kogjenerimit të ngrohtores së qytetit të Prishtinës, por edhe të aplikohet në qytete të tjera të Kosovës.
- Qendrat e kontrollit teknik të automjeteve të jenë më rigorozë në verifikimin e normave të lejuara të shkarkimeve të gazrave ndotës. •
- Të promovohet dhe përdoret më shumë transporti urban publik, duke reduktuar përdorimin individual të veturave.
- Të ndalohet në mënyrë të rreptë djegia e mbeturinave në çdo formë, përveç rasteve të lejuara me autorizim të veçantë.
- Të rritet numri i sipërfaqeve të gjelbra në zonat urbane dhe në hapësirat e degraduara.
- Të rriten investimet në sektorin e ajrit, me përkrahje të veçantë nga buxheti i Kosovës.
- Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKSHPK) të realizojë vlerësime të rregullta vjetore për ndikimin e ndotjes së ajrit në shëndetin publik, duke u mbështetur në të dhënat e monitorimit të cilësisë së ajrit.

Uji

- **Zgjerim i kapaciteteve të trajtimit të ujërave të zeza** – aktualisht vetëm 11% e ujërave trajtohen, duhet rritur ndjeshëm kjo shifër.
- **Forcim i monitorimit** – disa lumenj kryesorë (p.sh. Prishtevka, Graçanka) paraqesin ndotje të rëndë; nevojitet rritet më i gjerë i matjes dhe inspektim aktiv, përfshirë raportimin e vazhdueshëm të parametrave kyç si azoti total dhe fosfori në të gjitha impiantet, për një pasqyrë më të qartë dhe për vendimmarrje efektive.
- Zbatimi i masave për parandalimin e ndotjes nga burimet bujqësore, përmes promovimit të praktikave të qëndrueshme bujqësore dhe kufizimit të përdorimit të plehrave kimik.
- Përmirësimi i kapaciteteve të institucioneve publike në menaxhimin e burimeve ujore, duke përfshirë trajnime teknike, bashkëpunim ndërinstytucional dhe forcim të mbikëqyrjes ligjore.
- Zhvillimi i planeve afatgjata për mbrojtjen e pellgjeve ujore, me fokus në Drinin e Bardhë, Ibër dhe Lepenc, për të parandaluar degradimin e shtretërve të lumenjve dhe për të siguruar burime të qëndrueshme ujore për të ardhmen.

Toka/dheu

Krijimi i sistemit kombëtar për monitorimin e tokës – aktualisht nuk ka një sistem permanent.

- Të përgatitet harta e vlerës së tokës në nivel nacional;
- Të bëhet monitorimi i përhershëm i tokave të shfrytëzueshëm;
- Të implementohet në mënyrë rigoroze infrastrukturë ligjore për tokat;
- Të ndërpritet shfrytëzimi dhe kthimi i destinimit të tokave pa kriter ligjor;
- Të hulumtohet dhe vlerësohet intenziteti dhe trendi i humbjes së tokave nga ndërtimi, erozioni dhe degradimi;
- Të ndalohet shkarkimet e emisioneve ndotëse në tokë nga operatorët ekonomik, agrobizneset; minierat, deponit e

mbeturinave urbane dhe industrial, ekonomit familjare etj, pa u bërë para trajtimi i tyre;

- Të ndërpritet degradimi fizik i tokave bujqësore dhe atyre të shfrytëzueshëm;
- **Promovimi i bujqësisë së qëndrueshme** – përdorimi i kontrolluar i plehrave kimike/pesticideve dhe zgjerimi i tokave të ujitura me standarde të larta.

Mbeturinat

- Zgjerimi i mbulimit me shërbime të grumbullimit të mbeturinave në të gjitha zonat urbane dhe rurale. Kjo përfshin ndërtimin e infrastrukturës adekuate, si pika grumbullimi dhe mjete transporti për vendbanimet e shpërndara.
- Investimi në ndarjen në burim dhe riciklimin, duke filluar me projekte pilot në komunat më të mëdha, dhe zgjerimin e tyre me baza të qëndrueshme. Vendosija e kontejnerëve të ndarë për kategori të ndryshme mbeturinash dhe vetëdijesimi i qytetarëve janë thelbësore.
- Përmirësimi dhe ndërtimi i infrastrukturës për trajtimin dhe deponimin, përfshirë: zgjerimi i kapaciteteve të deponisë Mirash; mbyllja graduale e deponive të pakontrolluara; ndërtimi i stacioneve për transferim dhe impianteve për kompostim e përpunim.
- Fuqizimi i Sistemit Informativ të Menaxhimit të Mbeturinave të Rrezikshme, si ato spitalore, industriale dhe elektronike, përmes krijimit të kapaciteteve të dedikuara për trajtim dhe deponim sipas standardeve.
- Forcimi i inspektimit dhe zbatimit të ligjeve, përfshirë sanksione për ndotësit dhe kontroll të rreptë të deponive ilegale. Duhet përmirësuar koordinimi ndërmjet inspektoratit mjedisor, komunave dhe ndërmarrjeve rajonale.
- Fuqizimi i kapaciteteve të ndërmarrjeve rajonale, përmes trajnimeve, rritjes së stafit profesional dhe sigurimit të fondeve për funksionim dhe mirëmbajtje.

- Angazhimi i qytetarëve dhe sektorit privat në sistemin e menaxhimit, përmes fushatave të vetëdijesimit dhe stimulimit financiar për ndarjen në burim apo riciklim.
- Sigurimi i financimit të qëndrueshëm, përmes mekanizmave buxhetorë, фондеве ndërkombëtare dhe partneriteteve publiko-private, për të mbështetur investimet afatgjata në këtë sektor.
- Integrimi i objektivave të ekonomisë qarkore në politikat kombëtare dhe lokale, në përputhje me standardet evropiane dhe të BE-së.

Mbrojtja e natyres dhe biodiversiteti

Forcimi i mbrojtjes ligjore dhe institucionale:

- Zbatimi strikt i Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës (Nr. 03/L-233) dhe harmonizimi me direktivat e BE-së.
- Rritja e kapaciteteve të Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit për monitorim dhe menaxhim aktiv.
- Hartimi dhe zbatimi i planeve menaxhuese për secilën zonë të mbrojtur.

Menaxhimi i qëndrueshëm i zonave të mbrojtura

- Kontroll më i rreptë mbi ndërtimet dhe infrastrukturën, duke ndaluar çdo ndërhyrje që cenon biodiversitetin dhe peizazhin natyror.
- Vendosja e kufizimeve për turizmin masiv dhe orientimi drejt turizmit të qëndrueshëm dhe edukativ.
- Rikuperimi i zonave të degraduara përmes ripyllëzimit, restaurimit të habitateve dhe kontrollit të erozionit.

Parandalimi i zjarreve dhe presioneve antropogjene

- Investime në sisteme të avancuara të monitorimit dhe alarmimit të hershëm për zjarret pyjore.
- Trajnime dhe mobilizim i ekipeve vullnetare lokale për reagim të shpejtë ndaj zjarreve.
- Fuqizimi i fushatave kundër prerjes ilegale të pyjeve dhe gjuetisë së paligjshme.

Shkencë dhe edukim

- Krijimi i një inventari kombëtar të florës dhe faunës me të dhëna të detajuara për speciet, popullatat dhe habitatet.
- Nxitja e hulumtimeve shkencore dhe përfshirja e universiteteve dhe instituteve në monitorimin e biodiversitetit.
- Edukimi dhe ndërgjegjësimi i publikut, sidomos i të rinjve, për rëndësinë e ruajtjes së natyrës dhe shërbimeve të ekosistemeve.

Financim dhe përfshirje komunitare

- Krijimi i fondeve të dedikuara për zonat e mbrojtura, përmes buxhetit të shtetit dhe donatorëve ndërkombëtarë.
- Përfshirja e komuniteteve lokale në menaxhimin e zonave, duke krijuar përfitime ekonomike për ta përmes turizmit të qëndrueshëm dhe produkteve tradicionale.
- Promovimi i modeleve të bashkëmenaxhimit mes institucioneve publike dhe private.

Ndikimet mjedisore në shëndetin e popullatës

Përmirësimi i monitorimit dhe raportimit:

- Zhvillimi i një sistemi të integruar kombëtar për monitorimin e ndotjes së ajrit, ujit dhe tokës, i lidhur me indikatorë shëndetësorë.
- Raportim periodik i rregullt nga MSH dhe IKSHPK mbi ndikimet shëndetësore të ndotjes.

Reduktimi i ndotjes së ajrit:

- Investime në transport publik të pastër (autobusë elektrike, rrjet i biçikletave) dhe nxitja e automjeteve me standarde Euro më të larta.
- Modernizimi i industrisë dhe ndalimi gradual i përdorimit të thëngjillit për ngrohje familjare.
- Fushata vetëdijësuese për zvogëlimin e djegies së drunjve dhe mbeturinave.

Shëndeti publik dhe sëmundjet infektive:

- Rritja e kapaciteteve laboratorike për diagnostikim të shpejtë të infeksioneve virale dhe bakteriale.

- Program i posaçëm për kontrollin e pertussis, brucellozës dhe HIV/AIDS, duke rritur vaksinimin dhe ndërgjegjësimin publik.
- Forcimi i survejancës epidemiologjike dhe krijimi i bazës së të dhënave të hapur mbi sëmundjet ambientale.

Cilësia e ujit të pijshëm:

- Investime për modernizimin e rrjetit të ujësjellësit në zonat rurale dhe fshatra me infrastrukturë të amortizuar.
- Kontrole të detyrueshme për pusët private dhe ujin e ambalazhuar para daljes në treg.
- Arritja e objektivit strategjik deri në vitin 2027: 99.5% cilësi e ujit dhe 90% mbulim të popullatës me ujë të sigurt.

Integrimi i shëndetit me politikat mjedisore:

- Zbatimi i parimit “shëndeti në të gjitha politikat”, duke lidhur vendimmarrjen mjedisore me ndikimin e saj në shëndet.
- Hartimi i një Strategjie Kombëtare për Shëndetin dhe Mjedisin, në përputhje me standardet e BE-së dhe OBSH-së.
- Përfshirja e komunitetit dhe OJQ-ve në monitorimin qytetar për ndotjen dhe shëndetin publik.

Gjendja e mjedisve të rrezikuara

Menaxhimi i ndotjes nga KEK-u:

- Investime urgjente në pajisje për filtrimin e gazrave dhe pluhurit (sisteme elektrostatische dhe desulfurizimi);
- Menaxhim i sigurt i hirit dhe mbetjeve të rrezikshme përmes deponive të kontrolluara dhe riciklimit të mundshëm; dhe
- Monitorim i përditshëm i cilësisë së ajrit dhe publikimi i të dhënave në kohë reale.

Trajtimi i mbetjeve të rrezikshme:

- Implementim i sistemeve për mbledhjen dhe trajtimin e vajrave të përdorur dhe baterive në përputhje me standardet e BE-së; dhe

- Ndërtimi i një impianti kombëtar për trajtimin dhe asgjësimin e mbeturinave të rrezikshme.

Deponitë e Feronikelit dhe minierave:

- Hartim i një plani rehabilitues për deponitë e skories dhe xeheroreve të braktisura;
- Stabilizim i zonave të kontaminuara dhe monitorim i ujërave nëntokësore dhe sipërfaqësore; dhe
- Aktivizim i fondeve të veçanta për rehabilitimin e mjedisit minerar.

Mbështetje për praktikatat e mira industriale:

- Nxitje e industrive për të aplikuar teknologji të pastra dhe për të përmbushur standardet IPPC; dhe
- Përforsim i kontrollit dhe inspektimit të rregullt nga autoritetet mjedisore;
- Deponitë ilegale të mbeturinave;
- Fushata kombëtare për mbylljen dhe rehabilitimin e deponive ilegale;
- Vendosja e kamerave dhe patrullave inspektuese në zonat e prekura; dhe
- Ndërgjegjësim i qytetarëve dhe bizneseve për rëndësinë e menaxhimit të mbeturinave.

Forcimi institucional:

- Rritje e kapaciteteve teknike dhe financiare të institucioneve mjedisore për monitorim dhe zbatim të ligjeve; dhe
- Krijimi i partneriteteve publike-private për investime në infrastrukturë mjedisore.

Zbatimi i këtyre masave do të mundësonte reduktimin gradual të ndotjes, përmirësimin e cilësisë së ajrit, ujit dhe tokës, si dhe mbrojtjen e shëndetit publik.

Zbatimi i strategjisë, planit të veprimit dhe planeve sanuese për mjedis

Finalizimi i dokumenteve strategjike në process:

- Përshpejtimi i miratimit të Strategjisë për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Zhvillimin e Qëndrueshëm dhe Planit Nacional për Energji dhe Klimë; dhe
- Përfshirja e objektivave të matshme, afateve kohore dhe mekanizmave të monitorimit.

Fuqizimi i kapaciteteve komunale:

- Mbështetje për komunat që nuk kanë plane mjedisore përmes fondeve qendrore dhe asistencës teknike; dhe
- Trajnime për zyrtarët lokalë mbi hartimin dhe zbatimin e planeve të veprimit.

Përcaktimi i burimeve financiare të qëndrueshme:

- Ndërlidhja e planeve strategjike me buxhetet vjetore dhe fondet donator; dhe
- Krijimi i një fondi të dedikuar për zbatimin e planeve mjedisore në nivel lokal.

Masat e ndërmarra për mbrojtjen e mjedisit, sukseset nga masat e ndërmarra dhe efektin e tyre në zhvillimin ekonomik

- Forcimi i zbatimit të legjislacionit – ndërkohë që korniza ligjore është përmirësuar ndjeshëm, nevojitet një mekanizëm më i fuqishëm për të siguruar zbatimin efektiv të saj, përmes inspektimeve më të shpeshta dhe ndëshkimeve të rrepta ndaj shkelësve.
- Përfshirja e të gjitha komunave – vetëm 15 nga 38 komuna kanë raportuar për inspektimet mjedisore. Rekomandohet ngritja e kapaciteteve komunale dhe krijimi i një mekanizmi të detyrueshëm raportimi për të gjitha komunat.
- Digjitalizimi i procesit të lejdhënies – procedurat për dhënien e lejeve dhe pëlqimeve mjedisore shpesh janë të gjata dhe komplekse. Nevojitet një sistem i integruar digjital që do të shkurtojë kohën e shqyrtimit dhe do të rrisë transparencën.
- Bashkëpunimi ndërinstytucional – forcimi i koordinimit mes MMPHI, MBPZHR, ME dhe institucioneve të tjera për zbatimin e strategjive dhe planeve të veprimit, në mënyrë që legjislacioni të mos mbetet vetëm në letër.

- Edukim dhe ndërgjegjësim – promovimi i fushatave të edukimit për qytetarët dhe bizneset mbi rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit dhe respektimit të ligjeve, duke përfshirë mekanizma stimulues për praktikat e gjelbra.
- Përmirësimi i monitorimit dhe raportimit – rekomandohet rritja e transparencës në raportimin publik të të dhënave mjedisore (inspektime, leje, gjoba), duke krijuar një platformë online për qasje të hapur nga qytetarët dhe organizatat e shoqërisë civile.
- Investime në energjinë e pastër – të forcohet mbështetja financiare dhe ligjore për investime në energjinë e ripërtëritshme, duke siguruar një tranzicion gradual drejt një ekonomie të gjelbër dhe të qëndrueshme.

Mënyra e menaxhimit të resurseve natyrore dhe mbrojtjen e mjedisit

- Menaxhim më efikas i ujërave industriale dhe të pijshëm – Duhet të forcohet monitorimi i përdorimit të ujërave nga operatorët e mëdhenjë dhe të zbatohen teknologji kursyese në industri, si dhe të investohet në përmirësimin e rrjetit të shpërndarjes së ujit për të reduktuar humbjet.
- Parandalimi i dëmeve në pyje – Nevojitet rritje e buxhetit për pyllëzime dhe mirëmbajtje, krijimi i një sistemi modern për parandalimin e zjarreve pyjore dhe angazhimi i komuniteteve lokale në mbrojtjen e pyjeve.
- Lufta kundër prerjeve ilegale – Rekomandohet forcimi i kontroleve në terren, shtimi i inspektorëve pyjorë dhe përdorimi i teknologjive të monitorimit (dronë, GIS) për të ndaluar aktivitetet ilegale.
- Diversifikimi i burimeve energjetike – Edhe pse ligniti mbetet burim kryesor, duhet të investohet në energji të ripërtëritshme për të reduktuar varësinë nga thëngjilli dhe ndikimin negativ në mjedis.
- Shfrytëzim i qëndrueshëm i mineraleve ndërtimore – Rekomandohet përcaktimi i kuotave të shfrytëzimit dhe rehabilitimi i zonave të prekura nga gërmimet për të minimizuar dëmet mjedisore.

- Rritja e transparencës – Të krijohet një platformë publike online ku raportohen në mënyrë të rregullt të dhënat mbi shfrytëzimin e ujit, pyjeve dhe mineraleve, duke siguruar qasje për qytetarët dhe organizatat e shoqërisë civile.
- Bashkëpunimi ndërinstytucional – Duhet forcuar koordinimi mes Ministrisë së Mjedisit, Agjencisë së Pyjeve, Komisionit për Miniera dhe Minerale dhe komunave për të siguruar menaxhim më të integruar të resurseve natyrore.

Financimi i sistemit për mbrojtjen e mjedisit

- Rritja e buxhetit për projektet kapitale mjedisore:
Sigurimi i një përqindjeje të qëndrueshme të buxhetit të shtetit për projekte specifike mjedisore, veçanërisht për menaxhimin e mbeturinave, ajrin dhe biodiversitetin, të cilat aktualisht janë nënfinancuar.
- Shpërndarje më e balancuar e fondeve ndërmjet komunave:
Përcaktimi i kriterëve të qarta për ndarjen e buxhetit komunal mbi bazën e popullsisë, shkallës së ndotjes dhe nevojave urgjente mjedisore, për të shmangur pabarazitë e theksuara.
- Diversifikimi i burimeve të financimit
Krijimi i mekanizmave për të tërhequr investime private, partneritete publiko-private dhe fonde të gjelbra ndërkombëtare, duke ulur varësinë vetëm nga buxheti qendror dhe donatorët.
- Forcimi i bashkëpunimit me donatorët ndërkombëtarë
Negocimi i projekteve më afatgjata dhe integruese me BE, SIDA, GIZ, JICA etj., duke i orientuar ato në prioritetet strategjike të Kosovës dhe jo vetëm në ndërhyrje të fragmentuara.
- Rritja e transparencës dhe llogaridhënies financiare
Publikimi në web aplikacionin mjedisor i raporteve të rregullta mbi shpenzimet dhe rezultatet e projekteve mjedisore, për të rritur besueshmërinë dhe efikasitetin e fondeve.
- Fokus në projekte afatgjata dhe të qëndrueshme

Shmangia e financimit të shpërndarë në shumë projekte të vogla, duke u përqendruar në programe të mëdha integrale për menaxhimin e ujërave, riciklimin e mbeturinave dhe energjinë e pastër.

- Krijimi i një fondi të posaçëm për mjedisin
Themelimi i një Fondi Kombëtar për Mjedisin, që do të financohet nga taksat mjedisore, gjobat për ndotje dhe kontributet e donatorëve, për të siguruar qëndrueshmëri financiare.

12. Referencat

1. European Union Office in Kosovo (2016) 'Construction of first wastewater treatment plant in Kosovo: an EU pilot project.
2. Swiss State Secretariat for Economic Affairs (SECO) (2013) Wastewater Treatment Plant Project Gjakova Kosovo: Institutional Feasibility Study.
3. State Secretariat for Economic Affairs (SECO) (2014) Wastewater Treatment Project Peja, Kosovo: Complementary Feasibility Study. 17 September 2014. Bern: SECO.
4. US Environmental Protection Agency (EPA), 2022. Total Suspended Solids (TSS) in Water Samples.
5. Smith, J. and Brown, K., 2019. 'Monitoring of suspended solids in wastewater treatment plants.' *Journal of Environmental Engineering*,
